Rruga e Arbërit

Gëzuar Vitin e Ri 2015!

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 12 (104). DHJETOR 2014. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

AKTUALITET

600 vende pune, 25 milionë USD investime

Nga **HYSEN LIKDISHA** - FAQE 10

INTERVISTË

Monika Stafa: Vizita në Dibër, një peng i heshtur

Nga **SASHENKA NDREKA** - FAQE 13

HISTORI

Mbi emërtesat Dibër e Epër dhe Dibër e Poshtme

Nga **MOISI MURRA** - FAQE 12

SPORT

- Korabi i rekordeve!
- 100 mijë euro për sportin në Bulqizë

SPECIALE NE FAQET 11,20-21

SHQIPËRI-KINË: FIRMOSET MEMORANDUMI

"Rruga e Arbrit, fruti i parë i një epoke të re"



Ja ku janë shkelur standardet e ndërtimit

FAQE 4-5

■ Pas Samitit të Beogradit rriten shpresat për fillimin e rrugës së Arbrit në segmentin Tiranë - Ura e Vashës. ■ Opozita shpreh skepticizëm për marrëveshjen, ndërsa qeveria thekson se në fillim të vitit nisin punimet. ■ Kryeministri e cilësoi këtë marrëveshje si finalizimin e përpjekjes 1-vjeçare për gjetjen e një formule inovative për financimin e Rrugës së Arbrit. ■ Rama: Projekti i parë i kësaj epoke të re bashkëpunimi mes dy vendeve do të jetë Rruga e Arbrit, e cila do të nisë vitin e ardhshëm. ■ Minierat, turizmi, bujqësia, industria e ushqimit dhe pasuritë hidrike në zonat ku kalon rruga kthehen në mundësi për rritjen ekonomike vendore, me kontribut final në ekonominë kombëtare. ■ Rruga e Arbrit do të shërbejë për të lidhur ekonomitë e tre rajoneve: rajonit bregdetar, rajonit malor të Bulqizës, Klosit, Dibrës e viseve të Sharrit dhe rajonit kontinental: Kërçovës, Gostivarit, Tetovës dhe Shkupit. ■ Financimi i rrugës së Arbrit, diçka më shumë sesa një projekt ■ Kina, Shqipëria dhe një marrëveshje fitimtarë për të dyja palët ■ Vizioni i Kryeministrit për rrugën e Arbrit, garanci për një vepër moderne të infrastukturës ■ Marrëveshja e arritur, një lajm i gëzuar ■ Dibra shpreson, por peticioni vazhdon ■ Dritë në tunelin e Qafës së Buallit, punimet vazhdojnë. ■ Haxhinasto: Rruga e Arbrit, tuneli i Qafë Buallit po ndërtohet me standarde ■ Deputetët e Dibrës ndajnë këndvështrime të kundërta. ■ Keta: Rruga e Arbërit, një premtim i pambajtur i qeverisë ■ Manja: Rruga e Arbrit është kartolina me e bukur për Dibrën.

Raport special, komente dhe opinione nga ANDI BALLA, BEN ANDONI, BASHKIM LLESHI, SKËNDER MINXHOZI, ILJAZ KACA, GËZIM ALPION, ULSI MANJA, ROLAND KETA, HYSEN UKA, HYSEN LIKDISHA, BUJAR KAROSHI - Faqe 2-9

cyan magenta yelloë black 1

“Projekti i parë i kësaj epoke të re bashkëpunimi mes dy vendeve do të jetë Rruga e Arbrit, e cila do të nisë vitin e ardhshëm. Minierat, turizmi, bujqësia, industria e ushqimit dhe pasuritë hidrike në zonat ku kalon rruga kthehen në mundësi për rritjen ekonomike vendore, me kontribut final në ekonominë kombëtare. Rruga e Arbrit do të shërbejë për të lidhur ekonomitë e tre rajoneve: rajonit bregdetar, rajonit malor të Bulqizës, Klosit, Dibrës e viseve të Sharrit dhe rajonit kontinental: Kërçovës, Gostivarit, Tetovës dhe Shkupit. Kryeministri e cilësoi këtë marrëveshje si finalizimin e përpjekjes 1-vjeçare për gjetjen e një formule inovative për financimin e Rrugës së Arbrit”.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 12 (104). 1 - 31 Dhjetor 2014

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Kontribuan për këtë numër:
Hysen LIKDISHA
Sashenka NDREKA
Andi BALLA
Bashkim LLESHI
Ben ANDONI
Defrim METHASANI
Esmeralda BICA
Femi SUFAJ
Gëzim ALPION
Hasan PASHA
Hysen UKA
Iljaz KACA
Ilmi DERVISHI
Mevlud BUCI
Moisi MURRA
Monika STAFA
Sakip CAMI
Skënder MINXHOZI
Sulejman TOMÇINI
Afrim KAROSHI

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

FIRMOSET MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT MES SHQIPËRISË DHE KINËS

Rama: Rruga e Arbrit, fruti i parë i një epoke të re

Nga **BUJAR KAROSHI**



“Mos prisni që unë sot të flas për Rrugën e Arbrit. Ai është një investim që meriton një vizitë të posaçme”, mësohet t’u ketë thënë Kryeministri Rama pushtetarëve lokalë të Bulqizë, sapo ai ka zbritur në qytetin e minatorëve për inspektimin e punimeve të hapjes së thellësisë së minierës dhe disa investimeve në infrastrukturë dhe shkolla.

Më 16 dhjetor Kryeministri Shqipërisë Edi Rama njoftoi përmes Facebook-ut nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit me Chinese Exim Bank. “U nënshkrua mbrëmë memorandumi i bashkëpunimit me Chinese Exim Bank për hapjen e një kantieri projektesh në Shqipëri me financime kineze. Projekti i parë që do të çelë siparin e një epoke të re bashkëpunimi mes Shqipërise e Kinës do të jetë Rruga e Arbërit, e cila do të nise vitin e ardhshëm”, shkroi ai ne faqen zyrtare ne FB.

Lajmi u mirëprit nga qytetarët, të cilët gjetjen e financimeve e kishin quajtur si një nga punët më të vështira të qeverisë në këtë kohë të vështirë për investime.

Deputeti i Dibrës Ulsi Manja shkroi në faqen e tij në FB se “Rruga e Arbërit është kartolina me e bukur për Dibrën dhe Dibranët për Festat e Fundvitit. Një ëndërr e vjetër tashmë realitet. Faleminderit z. Rama për fjalën e mbajtur, dibranët i respektojnë përjetë burrat e fjalës së mbajtur.” “Edhe njëherë faleminderit në emër të të gjithë Dibranëve, mbylli statusin e tij në FB deputeti i Dibrës.

Ndërkohë, ky lajm nuk kaloi edhe pa kritika e dyshime. Kryetari i PD, Lulzim Basha, shkroi në faqen e tij në FB se “Rruga e Arbrit ka nisur prej vitesh, por njësoj si Bulevardi dhe Lumi i Tiranës, njësoj si autostrada Elbasan -Tiranë dhe si dhjetëra vepra të tjera publike është bllokuar, vonuar dhe zvarritur nga njeriu që nuk i duron dot veprat e mëdha. Më pas, simpatizantë të kësaj partie postuan në rrjetet sociale deklarimin e ish kryeministrit Berisha, se ai e kishte lënë të gatshme firmosjen e marrëveshjes me kinezët, kështu që Rama nuk kishte bërë ndonjë gjë të re.

Në Ditarin e Këshillit të Ministrave të datës 19 dhjetor 2014, u botua lajmi me titullin “Infrastruktura Europiane: Nis vitin e ardhshëm ndërtimi i Rrugës së Arbrit”. “Të mërkurën u nënshkrua memorandumi i bashkëpunimit me Chinese Exim Bank për hapjen e një kantieri projektesh në Shqipëri me financime nga pala kineze, shkruhet të Ditarin e Këshillit të Ministrave. Projekti i parë i kësaj epoke të re bashkëpunimi mes dy vendeve do të jetë Rruga e Arbrit, e cila do të nisë vitin e ardhshëm. Minierat, turizmi, bujqësia, industria e ushqimit dhe pasuritë hidrike në zonat ku kalon rruga kthehen në mundësi për rritjen ekonomike vendore, me kontribut final në ekonominë kombëtare. Rruga e Arbrit do të shërbejë për të lidhur ekonomitë e tre rajoneve: rajonit bregdetar, rajonit malor të Bulqizës, Klosit, Dibrës e viseve të Sharrit dhe rajonit kontinental: Kërçovës, Gostivarit, Tetovës dhe Shkupit. Kryeministri e cilësoi këtë marrëveshje si finalizimin e përpjekjes 1-vjeçare për gjetjen e një formule inovative për financimin e Rrugës së Arbrit. Një sërë projektesh të tjera pritet të finalizohen me palën kineze për infrastrukturën, zonat industriale si dhe në mbështetjen e mëtejshme të rilindjes së bujqësisë përmes një financimi të ndjeshëm për rehabilitimin e gjithë sistemit të ujitjes e kullimit. Kryeministri kinez Li Keqiang shprehu dëshirën për rritjen e importeve bujqësore nga Shqipëria si dhe investimeve të kompanive kineze në prodhimin e energjisë dhe zhvillimin e infrastrukturës”.

Ndërkohë, agjencia kineze e lajmeve Xinhuanet në versionin e gjuhës angleze shkruante se Kryeministri “Li foli shumë për miqësinë tradicionale midis Shqipërisë dhe Kinës në takimin e tij me kryeministrin Shqiptar, Edi Rama... Li i tha Ramës që Kina është gati të luajë një rol aktiv në ndërtimin e autostradave, hekurudhave dhe porteve në Shqipëri, por gjithashtu të promovojë edhe kompani Kineze në fushat e bujqësisë, turizmit, parqeve ekonomike dhe punës në miniera.” Gjithashtu, Xihuanet thekson fjalën e Kryeministrit Rama se “Shqipëria i mirëpret investimet e Kinës dhe do të thellojë bashkëpunimin në ekonomi, tregti, agrikulturë, ndërtim dhe arsim”.

Ndërsa ditët kaluan, përveç optimizmit për nënshkrimin e marrëveshjes, u kërkua nga media dhe qytetarë më shumë informacion për marrëveshjen.

“Nuk ka një marrëveshje të shkruar për Rrugën e Arbrit, tha një burim pranë qeverisë, por ka një memorandum bashkëpunimi dhe ky memorandum do të fillojë të konkretizohet që në fillim të vitit 2015 me Rrugën e Arbrit”. “Bashkëpunimi me qeverinë kineze do të jete afatgjatë, thotë burimi, dhe është i hapur për investime në infrastrukturë, industri dhe bujqësi.”

Gjatë konferencës me rastin e 65 vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve mes Kinës dhe Shqipërisë, Ministrit i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, z. Arben Ahmetaj pati deklaruar: “Unë dua të përmend një shkëmbim thëniesh midis palëve që, në qoftë se Kina mendon për pesë vjet ose 100 vjet, ne jemi të detyruar të mendojmë për katër vjet, në kuptimin e të treguarit të qytetarëve të rezultateve ekonomike. Kjo do të thotë se detyra jonë është që t’i përgjigjemi interesit të investimeve kineze në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe konkrete, dhe me një ambicie që investimet kineze në fund të këtij mandati të jenë nga më të konsiderueshmet dhe të jenë vënë në funksion duke ofruar zhvillim ekonomik, qoftë për investimet kineze, qoftë për ekonominë shqiptare”.

Zërave kritikë lidhur me transparencën e marrëveshjes, burimi pranë qeverisë tha se kjo do të behët në kohën e duhur, kur marrëveshja konkrete të finalizohet. Lidhur me dyshimet se financimet kineze në Shqipëri do të kenë impakte negative lidhur me të ardhmen e Shqipërisë në Bashkimin Europian, burimi citon thënien e Kryeministrit Edi Rama në Beograd se “Shqipëria nuk jep garanci sovrane, por ofron dhe vë në dispozicion çdo instrument të mundshëm për një bashkëpunim ekonomiko-financiar që do të sillte zhvillim ekonomik të vendit dhe rajonit”.

“Shuma prej 10 miliardë $ është kredi e butë me interesa shumë të ulëta. Shqipëria zë një vend të veçantë në paketë, për vende të ndryshme nuk është se ka limite pasi pakeja është zgjeruar edhe me 30 miliardë $ të tjerë, tha Ministri Ahmetaj gjatë një emisioni për Top Channel. “E theksoj që brenda kësaj shume nuk ka limite, sa më shumë projekte arrijmë të ofrojmë, aq më shumë financime mund të tërheqim. E rëndësishme është që Shqipërisë nuk i është kërkuar që të afrojë garanci sovrane për fondet që do të arrijë të tërheqë. Përkundrazi, do të ketë instrumentë inovativë në mënyrë që të tërheqim sa më shumë financime projektesh. Një nga instrumentet do të jetë pjesëmarrja publike-private midis kompanive kineze me shtetin shqiptar. Një nga projektet me më shumë mundësi që të jetë në këtë instrument është Rruga e Arbrit, Parku Industrial i Spitallës dhe më tej edhe autostrada Adriatiko-Joniane”, shpjegoi Ahmetaj.

Pavarësisht raportimeve kontradiktore nga mediat dhe rrjetet sociale, lajmi për gjetjen e burimeve të financimit duket se është pritur me shumë gëzim nga qindra qytetare që mbështesin dy forcat kryesore politike.

Jashtë debatit politik të ditës, rajoni i Dibrës në dy shtetet, me ndërtimin e Rrugës së Arbërit, pret të çlirojë energji të pashtershme ekonomike e sociale. Rruga do t’i japë Dibrës frymëmarrjen e pritur, zhvillim industrial e bujqësor, komunikim dhe popullim, për ta rikthyer këtë zonë të harruar për afro një shekull në qendrën e trojeve shqiptare.

Segmenti Tiranë- Ura e Vashës pritet të përfundojë brenda 18 muajve nga dita e parë e nisjes së punimeve.

kryesore

Editorial i gazetës TIRANA TIMES: **Duket se projekti i parë që do të marrë investime kineze – dhe ndoshta edhe zbatimi direkt – do të jetë një rrugë e rëndësishme në malet e Shqipërisë lindore – rrugë që njihet lokalisht si Rruga e Arbrit.**

Kina, Shqipëria dhe një marrëveshje fitimtarë për të dyja palët



Nga **ANDI BALLA**

Kina po hedh hapin për të siguruar një burim të ri financimi dhe investimi për disa vende në rajonin, duke përfshirë edhe Shqipërinë, dhe lëvizja është pozitive për të gjitha palët e përfshira – vendet vetë, Kinën dhe Bashkimin Europian – dhe këtë të fundit të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor po synojnë ti bashkohen dikur në të ardhmen.

Kina solli së bashku 16 udhëheqës qeverish nga Europa Qendrore dhe Juglindore kësaj jave si pjesë e një prirje për të rritur praninë e saj ekonomike dhe ndikimin në rajon, duke investuar në projekte infrastrukturore kyçe.

Duket se ka 10 miliardë $ fonde të gatshme për t'u investuar në rajon. Edhe nëse Shqipëria përfiton një sasi të vogël prej kësaj shume, do të jetë një burim i mirëpritur financimi për qeverinë e tanishme të varfër në fonde, qeveri e cila nuk ka fare fonde të caktuara për projekte të reja në infrastrukturë.

Duket se projekti i parë që do të marrë investime kineze – dhe ndoshta edhe zbatimi direkt – do të jetë një rrugë e rëndësishme në malet e Shqipërisë lindore – rrugë që njihet lokalisht si Rruga e Arbrit. Kur të mbarojë, do të jetë projekti i dytë për nga rëndësia i këtij lloji, pas Rrugës së Kombit që tani lidh Shqipërinë me Kosovën. Rruga e re shkurton largësinë mes Tiranës dhe Shkupit me rreth 100 km, dhe krijon mundësi për Portin e Durrësit të jetë i hapur për një treg krejtësisht të ri, që shkon deri në Sofje. Këtë fakt e citoi për Tirana Times një grup lobistësh të kësaj rruge nga rajoni i Dibrës. Gjithashtu rruga do të rigjallërojë një rajon të pasur minerar dhe agrokulturor, që aktualisht është një nga zonat më të varfra e më të izoluara të Shqipërisë.

> Çdo qeveri ka rënë dakord që Rruga e Arbrit duhej ndërtuar, por asnjë prej tyre nuk ka qenë në gjendje të gjejë paratë e duhura për rrugën – rreth $250 milionë – derisa Kinezët u futën në lojë, duke negociuar së pari me qeverinë e shkuar, dhe duke e vulosur marrëveshjen me qeverinë e tanishme, pas disa bisedimeve të tjera. Marrëveshja e plotë nuk është arritur akoma, por pjesa e financimit – pjesa që do të sigurojë Banka Kineze Exim, bankë e qeverisë Kineze, për zhvillimin e projektit – duket se është siguruar.

Çdo qeveri ka rënë dakord që Rruga e Arbrit duhej ndërtuar, por asnjë prej tyre nuk ka qenë në gjendje të gjejë paratë e duhura për rrugën – rreth $250 milionë – derisa Kinezët u futën në lojë, duke negociuar së pari me qeverinë e shkuar, dhe duke e vulosur marrëveshjen me qeverinë e tanishme, pas disa bisedimeve të tjera. Marrëveshja e plotë nuk është arritur akoma, por pjesa e financimit – pjesa që do të sigurojë Banka Kineze Exim, bankë e qeverisë Kineze, për zhvillimin e projektit – duket se është siguruar. Pjesa tjetër e detajeve janë ngelen të paqarta.

Megjithëse një vend i vogël dhe largësisë gjeografike nga Kina, ne Kine ka një grup të fortë admiruesish të Shqipërisë, kryesisht mbi të 40-tat, thonë disa që janë të familjarizuar me Kinën. Ky afrimitet i ka rrënjët në lidhjen e fortë të Shqipërisë komuniste të kohës me Kinën, pasi ndarjes me Bashkimin Sovietik.

Është një grup miqësor ndaj Shqipërisë ne Kine, që duket se nuk është përdorur mjaftueshëm për lidhje më të forta me Kinën, gjë që mund të ndryshojë në të ardhmen nëse projektet e propozuara do të përparojnë.

Për Kinën përfitimet janë gjithashtu të qarta. Ajo financon rezervat valutore në projekte që sigurojnë fitime financiare, e lehtëson tregtinë me një zonë më të gjerë, dhe sigurisht, ka të ngjarë të gjejë më shumë vullnet të mirë politik për të ardhmen.

Kina është gjithashtu një bast i sigurt për rajonin sepse largësia gjeografike dhe mungesa e lidhjeve të ngushta kulturore ose fetare shmang shumë nga rreziqet që investitorë të tjerë të mundshëm si Rusia sjellin në ekuacion.

Disa Europianë kanë shprehur parehatinë e tyre me këtë zgjerim ekonomik kinez në Ballkan, por në fund të fundit, investimet në fjalë janë me fitim edhe për BE-në gjithashtu.

Përveçse rritjes së tregtisë me tregun kinez, rrugët, hekurudhat dhe portet që po ndërtohen me ndihmën e Kinës, do të lidhin në fund të fundit më mirë rajonin me pjesën tjetër të Europës dhe përtej – diçka të cilën BE-ja e nxit dhe përfiton.

Më tej, ndryshe nga shumë vende të fuqishme të lindjes me interesa në rajon, Kina është në vijim e qartë me qëndrimin e saj ndaj Ballkanit dhe BE-së. "Kina mbështet Bashkimin Europian, proceset e integrimit Europian dhe një Euro të fortë", tha kryeministri kinez në takimin më të fundit me udhëheqësit rajonale të mbajtur në Beograd.

**Shkrimi origjinal është në gjuhën angleze.*
Përktheu: **AFRIM KAROSHI**

Financimi i rrugës së Arbrit, diçka më shumë sesa një projekt

Memorandumi i firmosur të hënën (16 dhjetor 2014) mes bankës kineze "Exim Bank" dhe qeverisë shqiptare me shumë gjasë se do t'i hapë rrugë dhënies me koncesion të një segmenti të caktuar të Rrugës së Arbrit. Ky duket se ka qenë kushti kryesor i palës kineze për të marrë përsipër financimin e këtij projekti të shumëdebatuar.

Vetë qeveria shqiptare është treguar shumë e rezervuar lidhur me detajet e këtij memorandumi që ka marrë firmën si të ministrit të Financave, Shkëlqim Cani dhe atij të Transporteve, Edmond Haxhinasto.

Zëdhënësja e Ministrisë së Transporteve e kontaktuar nga "ResPublica" është shprehur se nuk është e autorizuar për të dhënë asnjë informacion pa mbërritur më parë në Tiranë shefi i saj Haxhinasto, ndërsa zv/ministri Ylli Manjani i kontaktuar nga mediat është shprehur se nuk kishte dijeni për çfarë bëhej fjalë dhe se ai nuk është marrë fare me këtë çështje.

Burime nga Ministria e Financave thanë për "ResPublica" se autoriteti i kontraktuar për këtë vepër publike do të jetë Ministria e Transporteve dhe forma e kontratës do të jetë e partneritetit publik privat, çka nënkupton dhënien me koncesion të pjesës së tunelit të Qafë Murrizit, i cili kërkon investime të mëdha. Në këtë rrugë aktualisht janë duke u kryer punime nga Autoriteti Kombëtar i Rrugëve që ka mbuluar rreth 2 km të investimit.

Sipas të njëjtave burime, do të jetë Banka kineze "Exim Bank" që do të nënshkruaje me kompanitë e interesuara kushtet e financimit. Nga Ministria e Transporteve mësohet se studimi i fizibilitetit për segmentin që do të jepet me koncesion është gati nga qeveria e kaluar dhe se tani pritet vetëm vendimi i Këshillit të Ministrave që do të formalizojë dhënien me koncesion të një segmenti të kësaj rruge, në mënyrë që Ministria e Transporteve si autoriteti kontraktues bashkë me Komisionin e Koncesioneve të hapë garën për kompaninë fituese.

Po sipas të njëjtave burime, miratimi i kontratës koncesionare pas shpalljes së fituesit nuk do të kalojë në procedurë parlamentare pasi ndryshimet e bëra në ligjin për koncesionet i lejojnë Ministrisë së Transporteve miratimin e kontratave për nivele të caktuara financimi.

Financimi nga "Exim Bank" mendohet të jetë në shifrat e 200-300 milionë dollarëve që nevojiten për ndërtimin e tunelit të Qafë Murrizit dhe të një ure përgjatë këtij segmenti.


MIQËSI BUJARE

Memorandumi me palën kineze, përveç interesit ekonomik të qeverisë shqiptare, fton për një koment të natyrës politlke. Depërtimi i Kinës në Europë është një proces që po shoqërohet me shqetësim nga Brukseli. Mjafton të sjellim këtu në vëmendje faktin, se edhe dje(datë 15 dhjetor)" media gjermane, "Deutsche Welle" i kushtonte një editorial Samitit të Beogradit, duke vlerësuar se kjo prani në rritje e Kinës në Europën Lindore është shqetësuese. Eksperti gjerman Frank Sieren, pasi bën një prezantim të investime e të mëdha kineze në rajon, shton faktin se "5 nga 16 vendet pjesëmarrëse në takim, nuk janë anëtarë të BE-së". Mes tyre është edhe Shqipëria dhe pikërisht për këtë arsye, këto vende vijnë në vështrim të posaçëm. Më tej, i njëjti ekspert përfundon se: "Frika po rritet se investimet e Pekinit do t'i sigurojnë mundësinë e influencës politike dhe në finale do ta ndajnë Europën". Natyrisht Shqipëria është një pikë në këto lëvizje, por është pozicioni që i jep asaj disa mundësi. Marrëveshja që përmbylli qeveria shqiptare për Rrugën e Arbrit, është bërë me një bankë që zotërohet nga shteti kinez dhe që është e vetmja që ka të drejtën për të dhënë kredi koncesionare. Ka edhe dy momente që e vendosin qeverinë e Edi Ramës në pozitat e një pale të interesuar për investimet kineze. Së pari është hapja e institutit "Konfuci" ku mori pjesë vetë kryeministri dhe së dyti janë tratativat për t'u dhënë kinezëve me koncesion portin e Shëngjinit. Më tej akoma, vizita e kryeministrit Edi Rama në Kinë, u sponsorizua nga ambasada kineze, që i vuri në dispizicion Edi Ramës edhe çarter. Së fundmi, që ndoshta është më e rëndësishmja, është leximi i vazhdueshëm i raporteve të dikurshme si një bazë e qëndrueshme për një miqësi që forcohet nga interesat. Një gjë të ngjashme kanë bërë edhe vendet fqinje, që shohin te investimet kineze, atë "Plan Marshall" që nuk erdhi nga Perëndimi. Kështu nëse i hedhim një sy përmbajtjes së Protokollit të Bashkëpunimit Shqipëri-Gjermani, do të vëmë re një sërë klauzolash shtrënguese që e vënë palën shqiptare përballë detyrimeve që lidhen me disa standarde. Marrëveshjet me Kinën nuk kanë nga këto "shqetësime". Në një editorial të vetin, Arben Rrozhani, kryeredaktori i gazetës "Shekulli, gazetë që zotërohet nga deputeti socialist Koço Kokëdhima, një promovues i investimeve kineze në Shqipërinë e pas Berishës, shkruante ndër të tjera për një element të memorandumit që duhet marrë në konsideratë: "Për herë të parë në historinë e marrëveshjeve të Shqipërisë me investitorët e huaj, nuk kërkuan as garancinë sovrane të shtetit shqiptar", shkruan Rrozhani që e quan Kinën "ekonomia e parë në botë". Nuk ka asgjë të keqe te pragmatizmi, por mbetet e paqartë sesi do të realizohet ky bashkëpunim ekonomik, duke shmangur kthimin e vendit në atë që eksperti gjerman, Frank Sieren e quante Porta e Pekinit në Europë, e ku përfshihet i gjithë rajoni. Aq më tepër kur klasa politike ka dështuar në thithjen e investimeve të qenësishme nga BE-ja, që sikurse u kërkua edhe në Konferencën e Berlinit, i kushtëzon ato me bashkëpunim rajonal, me standarde ligjore dhe me një klimë që i ka lënë pas sherret dhe rivalitetin në mikrokozmosin ballkanik.

(respublica.al)

Rruga e Arbërit nr. 104

vëzhgim



Në foto: Pamje e Qafë Buallit.
Në VL të dampës (shënuar me rreth)pozicioni ku duhet të fillonte hapja e tunelit.
Foto Bashkim Lleshi, nëntor 2006

Shpresojmë që kinezët të ndërtojnë një autostradë me standarde. Urojmë që fatin e Tunelit të Qafë Buallit të mos e pësojë Tuneli i Qafë Murrizës

Ja ku **janë shkelur standardet** në ndërtimin **e rrugës së Arbrit**

"E presim me entuziazëm edhe marrëveshjen e fundit në parim, Memorandumin e Bashkëpunimit midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj Kineze, që u nënshkrua më 16 dhjetor 2014 në Tiranë, ku Banka "CHINESE EXIM BANK" do të financojë disa projekte në vendin tonë, e në radhë të parë projektin për përfundimin e Rrugës së Arbërit. Më së fundi po na ngjallet shpresa, që edhe Rruga e shumëpërfolur e Dibrës, Rruga e Arbërit, rruga më e shkurtër që pret Shqipërinë nga perëndimi në lindje, rruga e dibranëve këndej e matanë kufirit, rruga e të gjithë shqiptarëve, rruga që afron Tiranën 100 km me Shkupin po vihet në rrugën e zgjidhjes përfundimtare, për t'ju përgjigjur standardeve të rrugëve europiane."

Nga **BASHKIM LLESHI**

Kaluan mbi 10 vjet nga përfundimi e miratimi i Studimit të Fizibilitetit dhe rruga e shumë premtuar nga politikanët në të gjitha zgjedhjet vendore e parlamentare nga viti 2005 e deri në fund të vitit 2014 nuk arriti të vihet në rrugën e drejtë të zgjidhjes përfundimtare. Vonesat në ndërtimin e kësaj rruge, këto tre vitet e fundit (2011-2013), shumë politikanë edhe të lartë në biseda e takime të ndryshme dhe në media janë munduar ti justifikojnë, jo me neglizhencat e papërgjegjshmërinë e tyre për sigurimin e fondeve, por me ndonjë arsye gjoja gjeologjike e hidrogjeologjike, të sugjeruara nga ndonjë specialist jo kompetent e servil i pushtetit.

Në gusht të vitit 2013 një grup pune i shoqatave "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe "Nisma Dibrane" kryen vrojtime nga Ura e Vashës deri në Tiranë dhe konstatuan se: "Gjatë gjithë aksit që përshkon Rruga e Arbërit, pothuajse vetëm traseja e hapur nga Tuneli i shkurtër në afërsi të Zall Dajtit deri tek ish Uzina e Artilerisë në afërsi të Urës së vjetër të Brarit dhe një pjesë e trasesë në luginën e Planit të Bardhë e mbi Urën e Vashës, mund të quhen trase të Rrugës së Arbërit, ndërsa në pjesët e tjera kemi ose rikonstruksion të rrugës ekzistuese ose shmangje nga aksi i Rrugës së Arbërit." (Bujar Karoshi, Gazeta "Rruga e Arbërit" gusht 2013) Shmangja më e madhe është ajo ku po hapet Tuneli i Qaf Buallit e cila është trajtuar që në vitin 2008 e në vazhdim. (Bashkim Lleshi 2008, 2013)

Në studimin e fizibilitetit për Qafën e Buallit është argumentuar hapja e këtij tuneli me gjatësi 850m. Me dalje nga ana e Bulqizës në lartësinë 800m, rreth 5m. mbi nivelin maksimal të Dambës se Fabrikës së pasurimit të kromit Bulqizë, në pjesën veri lindore të kësaj dambe. Në këtë studim theksohet se: "Tuneli i Qafë Buallit kalon nëpër shkëmbinj të fortë e të qëndrueshëm ultrabazikë me karakteristika fiziko-mekanike shumë të mira".(Bashkim Lleshi 2003, 2008).

Ky konkluzion është arritur nga vrojtimet sipërfaqësore në zonën e Qafës së Buallit dhe nga shpimet e kryera nga Gjeologjia e Bulqizës ngjitur me Qafën e Buallit në pjesën veriore të saj. Theksojmë se në të njëjtat formacione gjeologjike janë hapur 12 km. tunel (dy tunele paralel nga 6 km. secili) nga Shëngjuni në drejtim të Bulqizës (Traverbangu Klos-Bulqizë) e me mijëra ml. tunele që lidhin vendburimin e Bulqizës me atë të Batrës, apo se në shkëmbinj të tillë ultrabazikë është hapur tuneli i Kalimashit në rrugën e Kombit. Arsye gjeologo-inxhinierike që vështirësojnë hapjen e këtij tuneli nuk ka patur.

Në korrik të vitit 2009 filloi puna për ndërtimin e segmentit Bulqizë-Ura e Vashës, me afat të kryerjes për 20 muaj, deri në mars të vitit 2011. Në intervistën që ka marrë gazetari Bujar Karoshi në shkurt të vitit 2009 në "Infra Trans Projekt L.t.d.", thuhet : "...Në kryqëzimin e shëtitores që lidh qytetin e ri dhe qytetin e vjetër të Bulqizës, parashikohet ndërtimi i një mbikalimi, i cili nuk do ta ndërpresë lëvizjen në aksin e Rrugës së Arbërit. Me një tunel në Qafën e Buallit 847 metra, ajo del në luginën e Planit të Bardhë, duke vazhduar deri te Ura e Vashës. Mbi Urën e Vashës parashikohet ndërtimi i një ure, por detajet teknike të saj janë në përgatitje e sipër, paralelisht me hartimin e projektit teknik për segmentin Ura e Vashës-Qafa e Murrizës." Në vazhdim jo vetëm se nuk u zbatua asnjë afat për ndërtimin e këtij segmenti, por me tunelin e Qafës së Buallit, janë tallur projektuesit dhe zbatuesit e projektit. Nuk dihet gjithashtu që tunelin e projektuar prej 847 ml., aq sa ishte parashikuar në Studimin e Fizibilitetit, kush e reduktoi në 460 ml, duke e ngritur në lartësi dhe duke krijuar një kthesë të fortë në hyrje të tunelit nga Bulqiza. Në fund të tremujorit mujorit të parë të vitit 2011, kur duhet të kishte mbaruar tuneli, ai nuk kishte filluar akoma, bile nga ndonjë diletant rrugësh u arrit deri në absurditetin se nuk ka nevojë të hapet ky tunel, se mund t'a hapim në formë huseku e më pas t'a mbulojmë, etj., etj., kur për hapjen e këtij tuneli si pjesë përbërëse e Rrugës së Arbërit ka një miratim të Këshillit Kombëtar të Rrugëve që në gusht të vitit 2004. Po të mos parashikohej tuneli nuk kishte nevojë të kalohej traseja e rrugës përball Bulqizës, për të bërë shpenzime të tepërta, sepse varianti më i mirë për të kaluar Qafën e Buallit nga sipërfaqja ishte vetëm rruga ekzistuese.

Gjatë kohës që vazhdonin projektet e zbatimit në vitet 2008 e 2009 filloi me shpejtësi të zgjerohet damba e fabrikës së pasurimit të kromit në ekstremin veri lindor të saj, pikërisht në pozicionin ku do të kalonte rruga dhe do të hapej gryka e tunelit. Ndoshta ngritja e panevojshme e trasesë së rrugës mbi varrezat e qytetit të Bulqizës mund të ketë lidhje edhe me zgjerimin e dambës, pikërisht në vendin ku do të fillonte të hapej tuneli i Qafë Buallit.

Si rregull para se të përpilohet projekti teknik i hapjes së tunelit duhet të kryhet studimi gjeologo-inxhinierik i zonës ku do të hapet tuneli, nëpërmjet të cilit caktohet aksi i hapjes së tunelit, duke përcaktuar koordinatat e lartësitë e grykave të hyrjes dhe daljes së tij. Kryerja e këtij studimi presupozon edhe punime shpimi gjatë aksit të tunelit ku merren kampione për përcaktimin e vetive fiziko-mekanike të shkëmbinjve. Në rast se ekziston një studim i tillë i cili në vepra të tilla është domosdoshmëri për t'u kryer, si ka mundësi që tuneli të vendoset në pozicionin më të keq të mundshëm, aty ku kalon prishja e madhe tektonike nga lugina e Planit të Bardhë në Qaf Buall dhe vazhdon në luginën e Vajkalit deri në Fushë Bulqizë që ndan masivin ultrabazik të Bulqizës në dy pjesë, në atë veriore dhe jugore. Për çudi grykat e hyrjes dhe daljes së tunelit janë vendosur në aksin e kësaj prishje tektonike, ku shkëmbinjtë janë plotësisht të shkatërruar. Asnjë specialist i fushës së gjeologjisë, e jo më i gjeologjisë inxhinierike, edhe sikur të mos ketë fare eksperiencë, nuk mund të caktojë, jo me studim, por edhe pa studim, vendosjen e aksit të tunelit aty ku kanë filluar përgatitjet për hapjen e grykave të këtij tuneli.

Nga kompania që ka marrë përsipër hapjen e tunelit, duke mos arritur të krijonin një ball tuneli të qëndrueshëm, u vazhduan grykat e hyrjes në të dy anët në formë useku nga niveli i tunelit deri në sipërfaqe, për mbi 200m në të dy anët dhe në pamundësi për të vazhduar nga ana teknike, ndoshta edhe financiare, punimet u ndërprenë për gati mbi 2 vite. Gjatë kësaj periudhe janë thirrur specialistë me eksperiencë në fushën e minierave që kanë drejtuar punimet për hapjen e Traverbankut të Klosit dhe janë tërhequr, nuk e kanë marrë përsipër drejtimin teknik për hapjen e këtij tuneli aty ku është vendosur, jo se nuk ka asnjë mundësi teknike për t'u hapur, por për t'u hapur aty ku është vendosur duhet përdorur teknologji e metoda speciale (me ngrirje) ose me paraecëse, duke rritur në masë të ndjeshme shpenzimet për kryerjen e 1ml. tuneli.

Meqenëse hapja e këtij tuneli dhe fillimi i punimeve në objektet e tjera u ndërprenë për një kohë të gjatë, drejtuesit e dy shoqatave të "Lidhjes së Intelektualëve Dibranë" dhe "Nismës Dibrane", në mars të vitit 2014, i dërgojnë një relacion Ministrit të Transportit e Infrastrukturës, dhe 6 deputetëve të Dibrës, ku propozojnë : "...që për objektet e rëndësishmë të kësaj rruge si, tunelet e Qaf Buallit e Qaf Murrizës dhe Urën e Vashës, të rishikohen e përmirësohen projektet e zbatimit, duke bërë edhe krahasimet me projektet e hartuara..." (Nuri Abdiu, Bujar Karoshi, 2014) Për këtë relacion, as nuk u dha ndonjë përgjigje dhe as nuk u thirr ndonjë specialist për ndonjë konsultim.

Për çudi, në fillim të tetorit të këtij viti, menjëherë pas vizitës së Kryeministrit Rama në Kinë më 11 shtator, kur u dha sihariqi se Rruga e arbrit do jepej me koncension dhe për objektet që nuk ishin filluar u sugjerua se duhet të kryhen përmirësime që në fazën e projektimit, filloi me shpejtësi hapja e tunelit të Qaf Buallit në vendin ku nuk duhet të vazhdonte hapja e tij. Në muajin janar thuhet se do të mbarojë, por ashtu si segmenti Dalje e Bulqizës-Ura e Çerenecit edhe ky tunel do të ngelet si njollë e zezë që po prish cilësinë e kësaj rruge dhe mundësitë për ndërhyrje e përmirësim, sidomos për tunelin janë të pamundura.

Segmenti nga Dalja e Bulqizës në drejtim të Tunelit të Qaf Buallit, nga nënkalimi tek rruga që lidh qytetin e vjetër të Bulqizës me të riun në vend që të shkonte drejt, në pjesën e poshtme të ish parkut automobilistik dhe të Varrezave të qytetit të Bulqizës, në fushë, e të dilte në pjesën veri lindore të Dambës së Fabrikës së Pasurimit, pësoi një ngritje duke krijuar një usek të panevojshëm i cili gjatë dimrit është problematik nga akulli e dëbora. U shtuan mijëra m3 volume në mes të fushës pa patur asnjë problem gjeologo-inxhinierik për ta bërë këtë ngritje dhe që nuk ka çuar në ndonjë përmirësim të cilësisë së rrugës, por përkundrazi e ka prishur cilësinë e saj. Puna e bërë deri tani në segmentin Bulqizë–Ura e Çerenecit dhe dalje e Bulqizës Tuneli i Qafë Buallit është e vështirë të korrigjohet. Megjithatë, marrja në koncension nga kinezët, ka zgjuar një shpresë të komunitetit dibran dhe intelektualëve dibranë, që aty ku ka mundësi të ndërhyhet për ndonjë përmirësim edhe në segmentin Dalje e Bulqizës (qyteti i ri)-Ura e Çerenecit, për t'a vazhduar trasenë e rrugës në drejtim të Dragunit, përball pishave, në pozicionin që ishte parashikuar në Studimin e Fizibilitetit, apo vazhdimin nga Ura e Qytetit deri në Zall Sopot gjatë shtratit të lumit Zalli i Bulqizës. Këto përmirësime do të bënin që edhe ky aks i ndërtuar jashtë çdo standardi t'u përgjigjej



Pamje e trasesë së rrugës mbi Urën e Vashës. Foto B.Lleshi gusht 2013

kryesore



Vargmali në veri të Qaf Murrizës që do të kalohet me tunel. Foto B.Lleshi, 31 gusht 2013

kërkesave të një rruge me standarde të kohës.

Në intervistën që i ka dhënë inxhinieri shqiptar Shefki Aliti, gazetës "Rruga e Arbërit" në shtator të vitit 2013, tërheq vëmendjen se, Rruga e Arbërit po ndërtohet larg standardeve europiane. Ai thekson se: "Pjesa që është ndërtuar në Shqipëri është paraparë me lëvizje maksimale të shpejtësisë me 80 km/orë, ndërsa Federata Europiane e Autostradave me seli në Brukselnuk pranon standarde të ndërtimit të autostradave me shpejtësi nën 120 km/orë... Kjo nuk është një autostradë që lidh dy shtete e më tej por një rrugë lokale." (Shefki Aliti, shtator 2013)

Për vazhdimin më tej të ndërtimit të kësaj rruge, dy nyjet kryesore ku nuk ka filluar ndërtimi i tyre, për të cilat duhet të ndërhyhet në projektet e zbatimit, në drejtim të përmirësimit të cilësisë së rrugës janë: Nyja problematike e Urës së Vashës e Tunelit të Gurit të Bardhë dhe Tuneli i Murrizës.

NYJA PROBLEMATIKE E URËS SË VASHËS DHE TUNELIT TË GURIT TË BARDHË

Për Urën e Vashës, propozimi fillestar në Skicëide (Bashkim Lleshi prill 2003) dhe në Studimin e Fizibilitetit ka qenë që ajo të ndërtohet në pjesën ku lugina e lumit është më e ngushtë, pra mbi Urën e Vjetër me harqe të Vashës. Vazhdimi i mëtejshëm i rrugës në drejtim të Gurit të Bardhë do të ishte në shpatin e përroit të Dishit deri në vendin ku bashkohen dy përrenjt që zbresin nga fshati Guri i Bardhë, për të vazhduar me tunelin e Gurit të Bardhë, poshtë Petralbës me gjatësi rreh 870m. ose poshtë lagjes Laskaj (sipas Skic Idesë) me gjatësi 1500m. (Bashkim Lleshi 2003)

Në të dy rastet tuneli do të dilte në përroin e Mashnorit për të vazhduar sipas rrjedhjes së përroit në drejtim të Murrizës, duke shmangur kalimin në sipërfaqe të rrugës në nyjën shumë problematike poshtë fshatit Shkallë ku fillon zbritjen përroi i Mashnorit. Në prag të miratimit të Studimit te Fizibilitetit, pozicioni i kësaj ure ndryshoi, u zbrit poshtë urës së vjetër të Vashës, aty ku edhe lugina e lumit është më e gjerë, duke ndryshuar edhe pozicionin e tunelit të Gurit të Bardhë, mbi fshatin Fshat. Zgjatja e rrugës më poshtë u justifikua me pretendimin për t'ju afruar më afër Klosit, sikur kjo rrugë po bëhej vetëm për t'u lidhur vetëm me Klosin. Megjithëse janë bërë debate për këtë problem qysh në vitin 2008,(Bashkim Lleshi, maj,gusht 2008) projektet teknike të zbatimit vazhduan në të njëjtën linjë, ura u projektua më e gjatë dhe më e lartë duke rritur koston e saj.

Në një intervistë dhënë Gazetës Rruga e Arbërit nr. 9(41) shtator 2009, Dr.Ing. Faruk Kaba jep detajet e projektit nga Bulqiza në Tiranë të Rrugës së Arbërit, ku për Urën e Vashës shkruan: "...Vështirësia tjetër më e madhe është kapërcimi i luginës së Matit me urë, pranë urës së vjetër të Vashës... Ura është zgjedhur më gjatësi rreth 300m. me tre hapsira, ku hapsira më e madhe është 140m....lartësia e urës është rreth 133m..." (Faruk Kaba, Tiranë shtator 2009)

Duke e parë në vend këtë nyje problematike, mendojmë se nuk është vonë që për hir të rëndësisë që ka ndërtimi me cilësi i kësaj rruge, të diskutohet dhe të krahasohen edhe ekonomikisht variantet e kalimit të rrugës nga Ura e Vashës deri në përroin e Mashnorit. Traseja e hapur poshtë pozicionit të Urës së vjetër të Vashës të vazhdohet për të lidhur Klosin me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit, ndërsa pozicioni i Urës së Vashës të spostohet aty ku lugina e lumit është më e ngushtë, pra mbi Urën e vjetër të Vashës, duke ngushtuar hapësirat, rrjedhimisht duke zvogëluar gjatësinë e Urës, rrjedhimisht edhe shpenzimet për ndërtimin e saj.

Vazhdimi i rrugës për gjatë përroit të Mashnorit deri tek gryka e tunelit të Murrizës nga ana e Matit, nuk është problematik, sepse kjo është një luginë me formacione gjeologjike të qëndrueshme, pa rrëzime të shpateve, pra me shpate të qëndrueshme e të qeta. Mirë është që rruga të kalojë në shpatin verior të luginës që gjatë dimrit të rrihet më shumë nga dielli, meqenëse lartësitë ku do kalojë rruga në këtë pjesë do të jenë nga 700 deri në 820m.

TUNELI MURRIZËS

Në intervistën dhënë Gazetës Rruga e Arbërit nr. 9(41) shtator 2009, Dr.Ing. Faruk Kaba për tunelin e Murrizës shkruan : "... Sidoqoftë ka qenë e nevojshme të kapërcehet Qafa e Murrizës me një tunel 3,5 km. të gjatë... Tuneli është projektuar të kalojë në kuotën 800-820m. Tuneli fillon në shtëpitë e sipërme të fshatit Murrizë, nga krahu i Tiranës dhe del në grykën e lumit të Mashnorit, pranë shtëpive të fshatit Xibër, poshtë shkollës së këtij fshati, në kuotë rreth 820m. mbi nivelin e detit...Vetëm tuneli i Murrizit kushton rreth 90 milion euro. Vështirësia e tij shtohet po të kemi parasysh kushtet gjeologjike ku kalon ky tunel, të cilat janë nga më të dobtat. Për të përcaktuar pozicionin më të përshtatshëm të tij janë bërë tentativa të shumta dhe grupi i inxhinierëve është i besimit se ka gjetur pozicionin më të përshtatshëm..... Për tunelin e Murrizës janë paraqitur edhe dy variante të tjerë me tunele me gjatësi 3,6 dhe 4,2 km...."

Pas dy vitesh, për të justifikuar vonesat në fillimin e punimeve të këtij tuneli filluan të dalin nëpër intervista pushtetarë të lartë e "specialistë" ku flisnin për problemet gjeologjike e hidrogjeologjike të cilat shkaktuan, sipas tyre, vonesën dhe kushtëzuan ngritjen e nivelit të tunelit në lartësinë 950, rrjedhimisht shkurtimin e gjatësisë së tij nga 3500ml, në rreth 2400ml. Pavarësisht nga problemet gjoja gjeologjike e hidrogjeologjike që janë përdorur për të justifikuar këto vonesa, pretendimet e paraqitura deri tani për pengesat që mund të lindin nga ujrat e shumta që mund të dalin gjatë hapjes, apo për formacione të shkatërruara e të pakalueshme në hyrje e në dalje të tunelit nuk qëndrojnë.

Për të hapur një tunel nuk është një punë e lehtë, pa tjetër që është një sipërmarrje e vështirë, ka vështirësi, por ne në vendin tonë nuk është hera e parë që hapim tunele, edhe të këtyre përmasave. Nuk ka qenë më e lehtë hapja e tunelit të Qaf Thanës, në formacione më të vështira se ky tunel dhe me prurje ujërash të mëdha, apo 12 km. tunel të Traverbankut të Klosit, e disa kilometra tunele të përmasave të mëdha të niveleve kryesore që lidhin Bulqizën me Batrën, pa përmendur tunelin e Kalimashit dhe së fundi atë të Krrabës.

Afro 80 % e gjatësisë së tunelit të Murrizës do të përshkohet nga depozitime të shkëmbinjve gëlqerorë pllakorë, me ndërtim kompakt e të qëndrueshëm, me pak ose aspak ujë, pa probleme të vështira teknike për hapjen e tunelit. Edhe depozitimet e flishit të hershëm, në dalje të tunelit nga ana e Matit nuk paraqesin probleme të vështira teknike. Pak vështirësi paraqet vetëm hyrja e tunelit nga ana e Tiranës, poshtë lagjeve Lila e Kaçu, në afërsi të tyre, për shkak të rrëzimeve të dukshme në sipërfaqe, të ardhura nga pjesët e sipërme të shpatit. Por pasi të fillohet e sigurohet hyrja e tunelit depozitimet flishore alevrito-ranore do të kalohen pa vështirësi. Bile ato kanë shumë pak ujë, kryesisht në afërsi të kontaktit me depozitimet flishore me ndërtim karbonatik, pra edhe uji nuk përbën ndonjë problem se në depozitimet flishore nuk kemi të zhvilluar fenomenin e karstit, si në gëlqerorët e Malit me Gropa në pjesën jugore të Qafës së Murrizës, nga burojnë gurrat e Linosit e të Gurit të Bardhë.

Formacionet mesatarisht të qëndrueshme alevrito-ranore të pjesës së fillimit të tunelit nga ana e Tiranës dhe ato flishore të daljes nga ana e Matit, që të dyja së bashku nuk bëjnë as 20% të gjatësisë së tunelit, nuk janë më të paqëndrueshme se formacionet e përzierjes ofiolitike me prurje uji të tunelit të Qaf Thanës, ato ranore e argjilore të tunelit të Krrabës, apo formacionet e disa kilometrave tunele të rrugës nga Janina në Selanik të fqinjit tonë jugor

Në rast se duam të ndërtojmë rrugë me cilësi të standardeve të kohës, tuneli i Murrizës nuk duhet të ngrihet mbi 830-850m nga ana e Tiranës dhe jo mbi 820-850m nga ana e Matit, prandaj për derisa puna nuk ka filluar akoma, mendojmë se kemi kohë për të rishikuar lartësinë e hapjes së këtij tuneli si nga ana e Matit ashtu edhe nga ana e Tiranës. Bile në vartësi të lartësisë së daljes së tunelit nga ana e Matit, në përroin poshtë shkollës së vjetër fillore të Xibër Murrizës duhet të dalë pozicioni më i përshtatshëm dhe lartësia e hyrjes së tunelit nga ana e Tiranës. Në vartësi të këtyre lartësive do të dalë gjatësia e tunelit të Murrizës.

Ngjitja e rrugës nga Zall Dajti në drejtim të Shpalit, Marecit, deri poshtë lagjes Lile e asaj Kaçu nuk është problematike. Në afërsi të këtyre lagjeve, poshtë tyre duhet gjetur vendi më i përshtatshëm për të filluar hapjen e tunelit nga ana e Tiranës.

Gjeologu i vjetër dibran, Prof. As. Dr.Vesel Hoxha, pasi lexon artikullin e gazetarit Bujar Karoshi të muajit gusht 2013 "Shpëtoni rrugën e Arbërit", në Gazetën"Rruga e Arbërit" nr. 9 (89) shtator 2013, shkruan : "...Lexoni ju lutem shqetësimet njerëzore mbushamendëse të bazuara në shkencë.... ku argumentohet mbi bazën e studimeve, realiteti ku ndodhet Rruga e Arbërit, duke tërhequr vëmendjen e të gjithëve, vëmendjen e atyre që ju dhimbset sadopak Dibra dhe Shqipëria, për të ndërhyrë secili në mënyrën dhe mundësinë e vet, sa nuk është vonë, për t'u bërë ato përmirësime që rekomandohen , rekomandime jetike për standartin që kërkohet për t'u realizuar në rrugën e dytë të Kombit. Rruga ndërtohet një herë e mirë kur thonë, ndaj me rrugët nuk duhet lënë askush të bëjë shaka me to. Profesor Lleshi thotë : "Standardi i Rrugës së Arbërit është në rrezik." Ky është sinjal alarmi..."(Vesel Hoxha 2013)

Shqetësimi i këtij specialisti të shquar dibran, është krijuar tek të gjithë intelektualët dibranë që u dhimbset Dibra dhe Shqipëria. Për këtë arsye e pritëm me entuziazëm edhe marrëveshjen e fundit në parim, Memorandumin e Bashkëpunimit midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj Kineze, që u nënshkrua më 16 dhjetor 2014 në Tiranë, ku Banka "CHINESE EXIM BANK" do të financojë disa projekte në vendin tonë, e në radhë të parë projektin për përfundimin e Rrugës së Arbërit. Më së fundi po na ngjallet shpresa, që edhe Rruga e shumëpërfolur e Dibrës, Rruga e Arbërit, rruga më e shkurtër që pret Shqipërinë nga perëndimi në lindje, rruga e dibranëve këndej e matanë kufirit, rruga e të gjithë shqiptarëve, rruga që afron Tiranën 100 km me Shkupin po vihet në rrugën e zgjidhjes përfundimtare, për t'ju përgjigjur standardeve të rrugëve europiane.

Tiranë, dhjetor 2014





(Lart). Depozitimet flishore alevrito-ranore në rrugë mbi lagjen Selçune në J-L të lagjes Kaçu në lartësinë 1080m.

Pamje e depozitimeve flishore alevrito-ranore në shpatin e rrugës "Egnatia" Janinë-Selanik (Greqi) në sektorin Kozanë - Veria, ku janë hapur mijëra ml. tunele.

Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës viziton kantieret e ndërtimit në Burrel dhe Bulqizë: "Shumë shpejt do nënshkruhet marrëveshja koncensionare për ndërtimin e pjesës së mbetur prej 27 km për Rrugën e Arbrit

Haxhinasto: Rruga e Arbrit, **tuneli** i Qafë Buallit **po ndërtohet me standarde**

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Fundjava e parë e muajit dhjetor ka sjellë një lajm shumë të mirëpritur nga Dibra dhe dibranët, atë të ndërtimit të rrugës së Arbrit. Lajmi aq më tepër bëhet jo vetëm shpresëdhënës, por edhe i besueshëm, pse jo, kur jepet nga goja e ministrit të Transporteve dhe Infrastrukturës, Edmond Haxhinasto, i cili e bëri një deklarim të tillë gjatë një vizite për inspektimin e punimeve për ndërtimin e Tunelit të Qafës së Buallit, pjesë e ndërtimit të kësaj rruge.

MINISTRI NË BURREL: 210 MILIONË LEKË PËR URËN E RE

Vizita e Haxhinastos në qarkun Dibrës, realizuar në fundjavën e parë të muajit dhjetor, ka nisur në Burrel, tek Ura e Matit, ku nën shoqërimin e stafit të tij, ka parë ecurinë e punimeve për ndërtimin e kësaj ure. Kjo urë ndërtuar që para çlirimit nga italianët, në vazhdimësi ka shfaqur probleme për shkak të amortizimit të saj, veçanërisht për kalimin e automjeteve të rënda në të që transportojnë mineralin e kromit nga Bulqiza drejt Portit të Durrësit.

"Konstatoj me kënaqësi se punimet për ndërtimin e kësaj ure, po ecin me ritmin e duhur dhe sipas projektit.

Ura me një fond investimi prej 210 milion lekë të reja, po vijon të ndërtohet sipas projektit, me sigurinë dhe cilësinë e nevojshme të ndërtimit të saj, tha në fjalën e tij ministri. Po ecën me ritme sipas planifikimit e cila do të ndihmojë shumë zhvillimin ekonomik të kësaj zone. Me disa ndryshime të vogla në projekt besoj se në bashkëpunim me pushtetin lokal, do ndërtojmë me këtë rast edhe një zbukurim të mjedisit, pasi vënia në funksionim e këtyre dy urave do krijojë mundësinë edhe të ndërtimit të një pedonalje.

Ura e re që po ndërtohet, vijoi në fjalën e tij, Haxhinasto, është në një distancë 13.8m nga ura ekzistuese dhe do të ketë një gjatësi prej 100 metrash. Ndërhyrja për ndërtimin e urës së re ishte tepër e domosdoshme për faktin se ura ekzistuese kishte ulur në mënyrë të ndjeshme sigurinë rrugore. Ura e re sipas projektit do të ketë tre hapësira drite HD = 3x30m. Ndërsa mbistruktura e saj me gjerësi 9.44m , do të ketë pjesën kaluese e cila është e përbërë nga dy vija kalimi me gjerësi 3.5m dhe trotuare me gjerësi 2x1.22 m të kufizuar në të dy anët me parmakë metalik. Kanë përfunduar punimet për ndërtimin e themeleve të urës, pilave, si dhe kanë përfunduar punimet e ndërtimit të ballit nga qyteti i Burrelit. Është kryer spostimi i ujësjellësit të qytetit, i cili shtrihet përgjatë ballit tjetër, ku ka përfunduar ndërtimi i pilotave. Në fund të fjalës së tij ministri Haxhinasto kërkoi nga firma zbatuese e punimeve që të sigurojë standardin e cilësisë së punimeve, përshpejtimin e ritmeve të punës për respektimin e afateve të kryerjes së punimeve, që është maji i vitit të ardhshëm 2015-të. Ndërkohë ai hodhi idenë që Ministria e Transporteve do jetë në kontakt me pushtetin vendor, për të parë mundësinë për përdorimin funksional rekreativ të urës ekzistuese.

INTERVISTA E MINISTRIT TË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS, EDMOND HAXHINASTO, EKSKLUZIVISHT PËR GAZETËN "RRUGA E ARBËRIT"

Shkurtimi i tunelit nuk e prek standardin e rrugës

Gjatë inspektimit të punimeve për ndërtimin e Tunelit në Qafën e Buallit, mundëm t'i marrim një intervistë për gazetën "Rruga e Arbrit", ministrit të Transporteve dhe Infrastrukturës, Edmond Haxhinasto, për të mësuar në lidhje me problematikat dhe ecurinë e ndërtimit të kësaj rruge.

- Cili është qëllimi i inspektimit të punimeve për hapjen e Tunelit të Qafës së Buallit, pjesë e rëndësishme e Rrugës së Arbrit?

- Qëllimi është për të parë në vend ecurinë e punimeve të hapjes së këtij tuneli prej 460 metrash, i cili është pjesë e rëndësishme e ndërtimit të Rrugës së Arbrit.

- Dhe ç'farë konstatoni me këtë rast?

- Konstatojmë me kënaqësi se po ecet me ritme të mira nga kompania për të realizuar sipas grafikut të gjitha zërat e këtyre punimeve, si dhe po bëhet kujdesi i duhur që këto punime të jenë të standardit të lartë dhe gjithmonë të realizuara në kohë. Nga çfarë po shihet po ecet me ritmin e duhur ku kompania po punon në të dy krahët e tunelit hyrje-dalje. Deri më tani janë realizuar 70% e këtyre punimeve dhe besoj se në kohën e duhur, që është 30 dhjetori i këtij viti, do të përfundojë i gjithë ndërtimi i këtij tuneli.

- Pra Viti i Ri 2015-të do të sjellë me vete edhe lajmin për hapjen e këtij tuneli?

- Patjetër që ky vit i ri do të japë sihariqin për ndërtimin e tunelit, ku më 30 dhjetor do të jetë dita që do të bashkohen dy anët e këtij tuneli.

- Sipas projektit të prezantuar ndër vite, gjatësia e Tunelit të Qafës së Buallit, ka qenë parashikuar të ketë gjatësinë rreth 890 m, nëse nuk gabojmë. Ndërkohë sipas punimeve që po kryhen aktualisht, gjatësia e këtij tuneli do jetë jo 890 m, por 460m. Pse ky ndryshim dhe a cenohen kështu standardet në ndërtimin e tij?

- Sigurisht që në mënyrë të vazhdueshme bëhen axhustime të projektit, por në funksion të përmirësimit të cilësisë së projektit për të ofruar një segment rrugor me cilësitë më të larta që ne kemi në rrugët tona.

- Pra mendoni se një gjë e tillë e shkurtimit të gjatësisë së tunelit nuk e dëmton cilësinë e ndërtimit të rrugës, kur dihet se Qafa e Buallit, njihet për kushte atmosferike të veçanta gjatë stinës së dimrit, me reshje e stuhi shiu e dëbore të shoqëruara me erëra të forta si askund në vendin tonë, që tradicionalisht kanë shkaktuar vështirësi, pse jo edhe bllokim të qarkullimit në këtë segment rrugor?

- Aspak nuk do të dëmtohet cilësia. Në vlerësimin e gjykimin tim, ndryshimi i bërë në projekt nga specialistët e Autoritetit Rrugor Shqiptar, kanë patur parasysh respektimin e të gjitha standardeve për ndërtimin e kësaj rruge.

- Fondet financiare për ndërtimin e këtij tuneli, si janë siguruar, pasi është folur për mungesë fondesh financiare, gjë e cila ka sjellë zvarritjen pa të drejtë të ndërtimit të kësaj rruge?

- Fondet buxhetore janë siguruar nga buxheti i shtetit që tashmë janë të siguruara.

- E fundit, por jo për nga rëndësia, si do vijojë sigurimi i financimeve për ndërtimin e Rrugës së Arbrit?

- Qeveria shqiptare dhe vetë kryeministri Rama, e konsiderojnë si tejet të rëndësishëm projektin për ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Dhe ky projekt jo vetëm që nuk do të ketë kthim prapa dhe zvarritje të mëtejshme të tij, por do të finalizohet se shpejti marrëveshja me kinezët, brenda këtij muaji, për financimin e ndërtimit të saj. Kjo është e sigurtë. Ndaj qoftë nga burimet e brendshme të buxhetit të shtetit janë parashikuar ata fonde që realizojnë ecurinë normale të këtij projekti dhe e përsëris se unë jam optimist se edhe pjesa tjetër prej 27 km që mbetet është në rrugë të mbarë dhe shumë shpejt do kemi marrëveshje koncensionare me kinezët.

Bisedoi: H. Likdisha.



Zhbllokimi i fondeve për vijimin e punës në ndërtimin e Tunelit në Qafën e Buallit, është bërë nga qeveria shqiptare, e cila ka dhënë një fond investimi prej 1.6 milion dollarë për firmën tenderuese "Gjoka konstruksion" që po kryen këto punime.

HAXHINASTO NË QAFË BUALL: MË 30 DHJETOR HAPET TUNELI

Ndalesa e dytë e ministrit Haxhinasto, gjatë kësaj vizite pune, ka qenë në Qafën e Buallit, Bulqizë, ku ka inspektuar punimet për ndërtimin e tunelit në këtë zonë, pjesë e Rrugës së Arbrit. Tuneli në Qafën e Buallit është pjesë e lotit të 3 të ndërtimit të Rrugës së Arbrit, dalje Ura e Vashës-Bulqizë. Ndërkohë që punimet për ndërtimin e Rrugës së Arbrit edhe në lotin e 3-të të saj ishin pezulluar për shkak të mungesës së financimit, gjë për të cilën qeveria nisi negociatat me kinezët për të arritur marrëveshjen për financimin e saj, në muajin tetor nisin punimet për hapjen e Tunelit në Qafën e Buallit, nga kompania tenderuese e këtij loti rrugor "Gjoka konstruksion".

"-Me ç'farë po shohim këtu, vërejmë se po ecet me ritme të shpejta dhe unë bindem se ndërtimi i tunelit do ndërtohet se shpejti sipas planifikimit më 30 dhjetor", tha Minsitri i Transporteve gjatë inspektimit në tunel. "Jam i kënaqur se shoh se punimet në ndërtimin e këtij tuneli po bëhen në standardet e duhura bashkëkohore teknike".

Pyetjes për ndryshimin e bërë në projekt për shkurtimin e gjatësisë së këtij tuneli, ai iu përgjigj se "natyrisht që në vijimësi bëhen axhustime në projekt, por gjithmonë në përmirësimin e mëtejshëm të tij". "Kështu ka ndodhur edhe me ndryshimin e variantit të bërë në projekt për shkurtimin e gjatësisë së këtij tuneli nga 890 metra në 460 metra, - që sipas tij, - kjo jo vetëm nuk do të cënojë cilësinë e ndërtimit të tij, por do të çojë në ofrimin e standardeve më të larta të ndërtimit të tij", - tha ministri.

Ndërkohë ai bëri me dije se zhbllokimi i fondeve për vijimin e punës në ndërtimin e Tunelit në Qafën e Buallit, është bërë nga qeveria shqiptare, e cila ka dhënë një fond investimi prej 1.6 milion dollarë për firmën tenderuese "Gjoka konstruksion" që po kryen këto punime.

"Loti 3-të i Rrugës së Arbrit, dalje Ura e Vashës-Bulqizë, me gjatësi 1960 m. linear, -tha në fjalën e tij ministri gjatë inspektimit të punimeve në Qafën e Buallit, ka një vlerë kontrate prej 19 milione dollarë. Afati i përfundimit të këtij segmenti është Korrik 2015."

Ky lot përbëhet nga Tuneli i Qaf Buallit me gjatësi 460 ml përfshirë dhe portalet si dhe 2 segmentet rrugore në hyrje dhe në dalje të tunelit me një gjatësi 1520 ml. Gjerësia e rrugës është 2 x 3,5m pjesa kaluese e asfaltuar, 2 *1m bankina të asfaltuara, si dhe nje korsi 3m në ngjitje kur rruga ka pjerrësinë 6%. Kanë përfunduar punimet në segmentin prej 1520 m deri në shtresën e çakëllit. Ndërkohë avancimi i punimeve në tunel është përkatësisht 205ml nga ana e qytetit të Bulqizës dhe 90 ml nga ana e Tiranës.Veç punimeve për hapjen e tunelit kryhet edhe përforcimi me ankera dhe shortaret.

Paralelisht me këto punime vazhdon dhe betonimi i bazamentit të tunelit shtrirja e tokëzimit, izolimi dhe kanalet për largimin e ujerave. Vlera e realizuar e këtyre punimeve është 67% deklaroi në fjalën e tij ministri Haxhinasto. "Konstatoj me kënaqësi se po punohet me ritme shumë të shpejta dhe garantoj se data 30 dhjetor e këtij viti, do shënojë shpimin e këtij tuneli në të dyja anët e tij".

Me këtë rast ministri i bëri thirrje kompanisë ndërtuese për cilësi të lartë në realizimin e këtyre punimeve. "Jemi në fazën e fundit të bisedimeve me kompani serioze kineze për segmentin 27 km ku nuk kanë nisur punimet ende, bisedime këto që pritet të mbyllen brenda këtij muaji, pasi qeveria dhe vetë kryeministri Rama, e kanë prioritet ndërtimin e kësaj rruge që zhvillon jo vetëm zonën, por na lidh edhe me rajonin e fqinjët", tha në përfundim të fjalës së tij ministri Haxhinasto.

opinion

Rruga e Arbrit është një projekt "silur", që shemb muret ndërshqiptarë në rajon, duke krijuar një realitet të ri gjeopolitik për shqiptarët dhe perspektiva zhvillimi me një temporitëm epokal.

Vizioni i Kryeministrit për rrugën e Arbrit - **garanci për një vepër moderne të infrastukturës**

Nga **HYSEN UKA***

"Projekti i parë që do të çelë siparin e një epoke të re bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Kinës do të jetë Rruga e Arbrit, e cila do të nisë vitin e ardhshëm"- shpalli Kryeministri, zoti Edi Rama menjëherë pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit me Chinese Exim Bank për hapjen e një kantieri projektesh në Shqipëri.

Ky ishte lajmi më i gëzueshëm që mund të merrnim këtë fund viti, ky është lajmi më i mirë me të cilin do të nisë viti 2015, për të gjithë popullsinë që gjallon sot në trojet e Arbërisë, qytetarët e Durrësit e Tiranës, Dibrës, Malësinë e Mavrovës, Kërçovës e të Luginës Pollogut, por dhe për Kumanovën e shqiptarët e Luginës së Preshevës.

Shoqata për Zhvillim e Kulturë "Nisma Dibrane", si zëri i parë, që në vitin 1995 artikuloi e luftoi fort, mbi domosdoshmërinë e ndërtimit modern të rrugës së Arbërit, i shpreh një falënderim të thellë Kryeministrit, i cili, me punën dhe angazhimin e tij të drejtëpërdrejtë, që nga Samiti i Bukureshtit një vit më parë e deri në nënshkrimin e këtij Memorandumit të investimeve me Qeverinë e RP Kinës, ku ndërtimin e rrugës së Arbërit e ka vendosur në krye.

Në përpjekjen tonë 20 vjeçare, të advokimit për këtë Nismë, na u bashkuan edhe një rrjet i gjerë shoqatash të shoqërisë civile, zëdhënëse të vullnetit popullorë të banorëve të mbarë rajoneve shqiptare nga Tirana, Dibra, Tetova etj. Besojmë se shprehim edhe mirënjohjen dhe falënderimet e tyre, për rolin që po luan Kryeministri i vendit, në të mirë të realizimit të këtij projekti, me rëndësi jetike për zhvillimi, përparimin e integrimin, në radhë të parë ndërshqiptarë, të rajoneve tona.

Ky projekt infrastrukturor, në dukje i zakonshëm, është i një rëndësie të veçantë, thënë qartë, i një rëndësie ekzistenciale për shqiptarët në Maqedoninë Perëndimore, por edhe për shqiptarët e Luginës së Preshevës, për të cilët rruga e Arbrit, është një dorë e zgjatur, një krah i shtrirë për ta nga shteti shqiptar.

Rruga e Arbrit nuk është thjesht dhe vetëm një projekt rrugor, që lidh territore e tregje, por mbi të gjitha është një projekt i rilidhjes dhe i rilindjes shpirtërore e kulturore të një popullsie të ndarë tragjikisht me dhunë nga aleanca e projekte nacionaliste të koordinuara një shekull më parë.

Të gjitha rrugët kanë edhe një aspekt politik, por Rruga e Arbrit e ka të spikatur këtë, për shkak të ndikimit të madh që sjell në shtimin e lidhjeve e të bashkëpunimit, funksionalizimin organik e normal, të gjithë hapësirës nga buza e ujit, në Portin e Durrësit, në fushën e Tiranës, Krahinën e Dibrës e Luginën e Pollogu, Luginën e Preshevës e deri në Vranjë. Por, më e veçanta është se vetëm përmes rrugës së Arbrit, më në fund shteti shqiptarë vihet realisht në zotërim të një njërës nga luginat më të rëndësishme të vendit tonë, Luginës së Drinit të Zi. Të gjitha këto hapësira hyjnë në një marrëdhënie të re lëvizshmëri e bashkëpunimi edhe me rrjetet infrastrukturore ballkanike, duke filluar nga Porti i Durrësit në Adriatik e deri në Portin bullgar të Varnasit në Detin e Zi.

Rruga e Arbrit është një projekt "silur", që shemb muret ndërshqiptarë në rajon, duke krijuar një realitet të ri gjeopolitik për shqiptarët dhe perspektiva zhvillimi me një temporitëm epokal.

Edi Rama është i pari kryeministër që e ka kuptuar thellë këtë dhe e ka shprehur qartë rëndësinë e këtij projekti, duke e cilësuar ndërtimin e Rugës së Arbrit "projekt startegjik të infrastrukturës rrugore kombëtare". Dhe për këtë falënderimi për të sot, dhe aq më shumë nesër kur rruga të fillojë e përfundojë, duhet të jetë mbarëkombëtar.

Gjatë 20 viteve punë e përpjekje, kemi shpresuar shumë por dhe jemi zhgënjyer shpesh, ndaj edhe krahas besimit tonë në fjalën dhe angazhimin e Kryeministrit, ka patur edhe skepticizëm dhe pandehma se premtimet për rrugën e Arbrit, ashtu si më parë, do të ishin fjalë e thënë, e jo fjalë e dhënë, jo fjalë e mbajtur. Edhe në këtë rast, Nderi dhe vlerësimi i shkojnë Kryeministrit Edi Rama, i cili zgjodhi njeriun e duhur, për t'i dhënë fjalën popullit të Dibrës e më gjerë. Ai shënoi për këtë një nga personalitetet e shquara të Dibrës, profesorin e nderuar, Shkëlqim Cani, i cili ka qenë i angazhuar që në fillimet e përpjekjeve tona, në mbështetje të këtij projekti dhe të Shoqatës "Nisma", i ndërgjegjshëm dhe i vetëdijshëm më shumë se shumëkush për dobinë dhe domosdoshmërinë e ndërtimit të Rrugës së Arbërit.

Me fillimin e punimeve dhe me ndërtimin e rrugës nesër, Kryeministri ka fituar një sfidë personale me popullin e Dibrës dhe me vendimmarrjen politike të Partisë Socialiste. Falënderimi në këtë rast ju shkon të dyve, Ramës dhe Canit, për punën që kanë bërë në arritjen e marrëveshjes, nënshkrimin e Memorandumit për "një kantier projektesh në Shqipëri". Ju keni fituar një sfidë të madhe, më të madhe se ndërtimi i rrugës së Arbrit.

Përmes përpjekjeve e punës që kemi bërë me këtë Nismë, si shoqëri civile jemi pjekur, jemi aftësuar dhe kemi kuptuar edhe rëndësinë dhe fuqinë tonë dhe se mund t'ia dalim të ndikojmë në institucionet vendimmarrëse, kombëtare e lokale, nëse jemi të qartë në idetë tona dhe të vendosur në përmbushjen e tyre. Në këtë rast, një falënderim shumë i madh ju shkon të gjithë atyre njerëzve që i janë bashkuar, si anëtar apo si mbështetës dhe simpatizantë shoqatës "Nisma", në punën e saj të madhe këmbëngulëse për ta bërë të dëgjohet e të vlerësohet projekt-idetë tonë për rrugën e Arbrit, nga të gjitha qeveritë, që nga viti 1995 e deri më sot.

Edhe vonesat e deritanishme, do ti konsiderojmë për mirë, kur shohim atë pak punë që është bërë deri më tani me këtë projekt, punë mjaft e dobët, pa cilësi e në shkelje të standardeve, me një projekti që nuk u bë asnjëherë publik, një projekt që nuk përmbante as kërkesat e as vizionet tona për një investim me rëndësi kombëtare, një projekt i tjetërsuar nga përshtatje të vazhdueshme me qëllim justifikimin e dështimeve të programeve politike qeverisëse, të partisë në pushtet. Duke shkelur mbi personalitetin profesional, pjesë e këtyre lojërave janë bërë edhe disa inxhinierë që janë marrë me studimin dhe projektimin e rrugës së Arbrit që nga fillimi. Ajo çfarë është bërë deri më tani nuk është aspak më shumë se sa modifikim e përshtatje e rrugës ekzistuese, të rrugës së vjetër, dhe se kjo duhet bërë objekt investigimi për abuzimet e mundshme me standardin e rrugës.

Në këtë kuptim, vonesa shkon për mirë, sepse projekti i ndërtimit të rrugës së Arbrit do të realizohet nën vizionin, përkujdesjen dhe këmbënguljen e Kryeministrit të Shqipërisë, z. Edi Rama, i cili, që gjatë fushatës elektorale e deri më tani ka treguar se zotëron gjithë gjithë vizionin për rrugën dhe se ky vizion është një garanci për ne, se do të kemi më në fund në vendin tonë, një vepër të infrastrukturës rrugore, model të standardeve dhe të cilësisë së lartë. Për fatin tonë të mirë kjo do të jetë Rruga e Arbrit. Ndjehemi fatlum që rruga e Arbrit do të jetë e para vepër që lind si iniciativë qytetare dhe realizohet nga qeveria Juaj.

Ne mezi presim të kemi vëmendjen e qeverisë shqiptare, të komunikojmë e të bashkëpunojmë me Kryeministrin e Shqipërisë edhe për nisma të tjera, për zhvillimin e përparim, ngritjen e iluminimin e shoqërisë sonë të re demokratike. Edi Rama është shprehur se na konsideron partner të rëndësishëm në ndërtimin e Shqipërisë dhe ne do të përpiqemi të jemi të denjë dhe ta meritojmë partneritetin me qeverinë.

** Shoqata "Nisma" për Zhvillim e Kulturë – Dibër&Tiranë*

Deklaratë e deputetit të Dibrës, Ulsi Manja:

"Rruga e Arbërit është kartolina me e bukur për Dibrën dhe Dibranët për Festat e Fundvitit. Një ëndërr e vjetër tashmë realitet. Faleminderit z. Rama për fjalën e mbajtur, dibranët i respektojnë përjetë burrat e fjalës së mbajtur." "Edhe njëherë faleminderit në emër të të gjithë Dibranëve, mbylli statusin e tij në FB deputeti i Dibrës.

Rruga e Arbrit nuk është thjesht dhe vetëm një projekt rrugor, që lidh territore e tregje, por mbi të gjitha është një projekt i rilidhjes dhe i rilindjes shpirtërore e kulturore të një popullsie të ndarë tragjikisht me dhunë nga aleanca e projekte nacionaliste të koordinuara një shekull më parë.

Edi Rama është i pari kryeministër që e ka kuptuar thellë këtë dhe e ka shprehur qartë rëndësinë e këtij projekti, duke e cilësuar ndërtimin e Rugës së Arbrit "projekt startegjik të infrastrukturës rrugore kombëtare". Dhe për këtë falënderimi për të sot, dhe aq më shumë nesër kur rruga të fillojë e përfundojë, duhet të jetë mbarëkombëtar.



Iljaz Kaca*: Marrëveshja e arritur, një lajm i gëzuar

Vlerësoj shumë angazhimin e Kryeministrit në vendosjen e këtij projekti si prioritar në listën e investimeve me financime nga Kina. Në të gjitha rastet, dhe nga të gjitha qeveritë është pranuar rëndësia e ndërtimit të rrugës së Arbrit, edhe pse është bërë ende shumë pak. Por, në dallim nga qeveritë e mëparshme mendoj dhe shpresoj se qeveria e zotit Edi Rama, ka zgjidhur problemin kyç, lidhur me këtë projekt: ka zgjidhur problemin e financimit. Për mua, marrëveshja e arritur me Qeverin kineze është e gëzueshme dhe për një fakt tjetër: besimi që kam në seriozitetin dhe cilësinë e punimeve që mund të bëjën kinezët. Kina ka ndërtuar në Shqipëri një numër të konsiderueshëm veprash industriale, në të cilat njerëzit kanë parë seriozitetin dhe cilësinë me të cilën ato punojnë. Shpresoj që kjo çfarë kemi dëgjuar e lexuar këto ditë, si në Tiranë edhe në Beograd, të jetë sa më shpejtë realitet, të kemi rrugën e ndërtuar nëpër të cilën të udhëtojmë.

** Arkeolog, ish kryetar i Shoqatës "Nisma Dibrane"*

Gëzim Alpion: Dibra shpreson, por peticioni vazhdon

Sot kam marrë disa mesazhe nga kolegë, miq dhe njerëz të panjohur për të më bërë me dije për njoftimin e përcjellur nga Kryeministri Edi Rama në Facebook për nënshkrimin e 'memorandumit të bashkëpunimit' me Bankën Kineze Exim për financimin e disa projekteve në Shqipëri, përfshirë Rrugën e Arbërit, e cila, po sipas Ramës, do të nisë vitin e ardhshëm.

Ne e përshëndesim sigurimin e fondeve për këtë vepër jetike për infrastrukturën e Dibrës, Shqipërisë verilindore, dhe këtij rajoni në Ballkan.

Shpresojmë që qeveria Rama të bëjë publike sa më shpejt kushtet e nënshkrimit të marrëveshjes me këtë bankë dhe të njoftojë se kur do të fillojë dhe përfundojë çdo segment i Rrugës së Arbërit. Ne do të bëjmë një prononcim më të detajuar për mediat kur të kemi më shumë informacion.

Pavarësisht lajmit optimist për sigurimin e fondeve, ne vazhdojmë ta monitorojmë proçesin. Siç kemi premtuar më 18 mars 2013, peticioni do të qëndroj i hapur deri në përfundimin e metrit të fundit të rrugës me cilësi dhe standarde ndërkombëtare. Ju bëjmë thirrje të vazhdoni të nënshkruani peticionin online.

16 dhjetor 2014

https://www.change.org/p/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit



Rruga e Arbërit nr. 104

analizë



Kryeministri që ka nostalgji për Adem Rekën

Nga **SKËNDER MINXHOZI- BEN ANDONI,** revista **JAVA**

Samiti i Beogradit përfundoi para pak ditësh, me një vitrinë liderësh të Europës Lindore, që u thirrën nga kryeministri kinez Li Keqiang, për të diskutuar për një paketë financimesh që Kina mendon të akordojë për vendet në fjalë...

Bëhet fjalë kryesisht për vepra në infrastrukturë, energji e transport, të cilat do të modernizojnë të gjithë rajonin e Lindjes europiane. Por krahas këtij aspekti të rëndësishëm zhvillimor, kjo paketë kredish të buta që gjigandi aziatik përgatitet të hedhë në këtë pjesë të botës, shënon edhe një shkelje këmbësh të sikletshme për Perëndimin: për BE në rradhë të parë, por edhe për SHBA.

Shqipëria e ka parë me shumë entusiazëm nismën kineze. Qysh në Samitet e Varshavës (2012) dhe Bukureshtit (2013), qeveritë shqiptare e kanë mirëpritur iniciativën e Pekinit, për të ndihmuar me kredi zhvillimi Europën Lindore. Tirana zyrtare ka llogaritur lidhjet e vjetra tradicionale që dy vendet kanë patur mes tyre, përfshirë ndihmën e Shqipërisë gjatë afrimit të Kinës Popullore në OKB. Një aspekt që e pasqyron edhe përmbledhja e intervistës së kryeministrit kinez, të cilën po botojmë më poshtë. Lidhjet tradicionale shqiptaro-kineze, kanë qenë dhe janë një potencial i rëndësishëm zhvillimi, por në 25 vjetët e fundit kanë mbetur në suazën e retorikës, pa rezultate konkrete të prekshme.

Qeveria shqiptare ka njoftuar se konform nismës kineze, janë identifikuar disa projekte, të cilat po negociohen me Pekinin. Më së pari është rruga e Arbrit, për të cilën u firmos një memorandum mes dy palëve pak ditë më parë.

Përveç këtij projekti, janë edhe disa plane të tjera konkrete për bashkëpunim ekonomik, të cilat po i rendisim më poshtë.

LI KEQIANG, KRYEMINISTRI QË KA NOSTALGJI PËR ADEM REKËN

Miqësia e thellë tradicionale dhe besimi i përbashkët dhe i palëkundur politik, kanë krijuar themele të forta për bashkëpunim të mëtejshëm ndërmjet Kinës dhe Shqipërisë, vlerësoi Kryeministri kinez Li Keqiang duke iu përgjigjur pyetjeve të Albania Daily News.

Në vigjilje të takimit të tretë ndërmjet udhëheqësve kinezë dhe atyre nga vendet e Europës Lindore, e cila u mbajt të martën në Beograd, Li dha intervistë për mediat e këtyre vendeve.

"Miqësia është si vera, sa më e vjetër aq më e mirë", tha Li duke cituar një thënie të vjetër kineze. Shqipëria dhe shumica e vendeve të tjera në Europën Qendrore dhe Lindore, vendosën marrëdhënie diplomatike me Kinën në ditët e para të themelimit të Republikës Popullore të Kinës në 1949, çka i dha Kinës mbështetje të paçmuar, sipas agjencisë Xinhua.

"Ne gjithmonë e kemi ushqyer këtë miqësi të vërtetë", tha Li.

Sipas Kryeministrit, sot, shumëkush në Kinë e mban mend ende kontributin historik që Shqipëria bëri për rivendosjen e të drejtave të ligjshme të saj në Kombet e Bashkuara, në vitin 1971.

Pamjet e grave luftëtare të guximshme në filmin "Horizonte të Hapura" dhe veshjet në filmin "Oshëtimë në Bregdet" lanë një gjurmë të pashlyeshme në mendjet e një brezi të tërë të popullit kinez,kujtoi Li.

"Gjenerimi i rezultateve më të arritshme nëpërmjet bashkëpunimit reciprokisht të dobishëm ka qenë një aspiratë e përbashkët të popujve të vendeve tona", tha Li. Ai shtoi se kjo është edhe mënyra më e mirë për të çuar përpara miqësinë e përbashkët tradicionale.

Kryeministri vlerësoi se krijimi dhe zhvillimi i platformës së bashkëpunimit mes Kinës dhe vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, kanë shtuar një dimension të ri në marrëdhëniet ndërmjet Kinës dhe këtyre vendeve, duke injektuar një stimul të fuqishëm në bashkëpunimin dypalësh.

Kina dhe Shqipëria po punojnë bashkërisht për të rrokur mundësi të tilla historike, në mënyrë që të nxitin aktivisht bashkëpunimin praktik në transport dhe energji. Takimi i Beogradit do të konturojë një skicë më të detajuar të bashkëpunimit të mëtejshëm dhe do të hapë një derë edhe më të gjerë për një baskëpunim ku përfiton secila palë, duke iu përgjigjur pyetjes së ngritur nga gazeta shqiptare.

"Ne jemi gati të punojmë me Shqipërinë për t'i dhënë vrull bashkëpunimit dhe të shënojmë arritje të reja në bashkëpunimin ndërmjet Kinës dhe vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, dhe në bashkëpunimin ndërmjet Kinës dhe Shqipërisë", deklaroi Li.

***

Kanë qenë të pakta samitet e huaja të viteve të fundit, ku Shqipëria ka qenë pjesëmarrëse, e që kanë pasur impaktin e samitit të ditëve të fundit. Arsyeja ka qenë e thjeshtë: zyrtarët shqiptarë, edhe pse pjesë e forumeve, traktateve të ndryshme, thjesht kanë qenë në radhët e pasme. Si asnjëherë tjetër, në samitin kinez të Beogradit, kryeministri i vendit Rama, jo vetëm ka qenë në radhën e parë, por edhe është përpjekur ta bëjë protagoniste vendin e tij në grantin e madh prej 10 miliardë dollarësh akorduar nga Kina për Ballkanin. Kështu, Shqipëria, mes të tjerave, ka kërkuar që projekti i madh kinez i SILK-Road, i cili ka një infrastrukturë komunikacioni komplete, të ketë akses dhe në rrjetin hekurudhor të Evropës Juglindore dhe të Ballkanit.

Por, në ditët e samitit, Shqipëria ka paraqitur projektet e saj, ku nënvizimi ka qenë në disa projekte në infrastrukturë, bujqësi, energji nga qeveria e saj. Marrëveshjet për këto bashkëpunime u konfirmuan gjatë takimit që kryeministri Edi Rama pati me homologun e tij kinez Li Keqiang.

KATËR PROJEKTET

Katër projektet thelbësore që paraqiti Shqipëria në Samit lidheshin specifikisht me "Rrugën e Arbrit", "Autostradën Blu", Portin e Shëngjinit dhe hekurudhat shtetërore. Kjo e fundit me idenë që të propozohej përmirësimi i të gjithë nyjeve shtetërore dhe pastaj të bëhej lidhja me ato ndërkombëtare, duke e futur vendin në sistemin e fqinjëve: në Veri me Malin e Zi, në Lindje me Maqedoninë dhe në Jug me Greqinë. Ky është një nga projektet që pretendohet se do të financohet menjëherë.

E veçanta e përfaqësimit të Shqipërisë në këtë samit, kish të bënte me përgatitjen e saj specifike. Ajo ka bërë një përgatitje speciale në fisha-projekte, për të mos përsëritur gabimet e qeverive paraardhëse, që kanë shkuar në të tilla takime me përshkrime të thata. Në fisha-projektet e kësaj here, ishin të paraqitura në mënyrë shumë konkrete përshkrimet e detajuara dhe kostot e propozimeve. Si rezultat i kësaj pune, të nisur herët, "Rruga e Arbërit" është në fund të negociatave dhe puna për të nisi me marrëveshjen e dy kryeministrave tanë. Porti i Shëngjinit është gati si projekt. "Mendohet që të bëhet port kontanierësh. Ka pak punë studimore, pasi do bëhet studimi i rrymave detare dhe me radhë...Por një nga projektet është edhe zhvillimi i Vlorës. Janë tetë zona të lira industriale dhe një zonë ekonomike, por që nuk ishin ndërtuar. Tani jemi duke mbyllur reformat e zonave të lira dhe industriale", thotë Etjen Xhafa, Drejtori i Kabinetit të Ministrisë së Zhvillimit të Ekonomisë. Është kërkuar ndërthurje e projekteve kineze me ato të BE-së dhe partnerëve të tjerë. Janë rreth 600 milion Euro për Shëngjinin, që me Rrugën e Kosovës, bëhet shumë i domosdoshëm tashmë për Ballkanin. Vështirësitë e mëtejshme janë ato burokratike, por jo nga pala shqiptare, vëren zyrtari.

SPITALLA

Interesi më i madh i kinezëve, në fakt, nuk ka qenë vetëm në këto projekte por në disa syresh. Një nga këto ishte Zona e lirë e Spitallës. "Ne jemi në bisedime për Zonën e Lirë Ekonomike të Spitallës, e cila është një zonë prej 500 ha dhe këto negociata prej palës kineze insistonin dhe më tepër, pasi donin dhe 2000ha", thotë Xhafo. Por, sipas tij, problemi është një gjigand tjetër kinez, që kërkon një zonë po kaq të madhe. "Problemi jonë është të gjejmë një të tillë hapësirë që të jetë e krahasueshme me të...". Arsyeja e këtij insistimi lidhet me pozitën e Spitallës.Tregu më i madh i Kinës sot është BE-ja dhe për fat Shqipëria ka disa marrëveshje me BE-në dhe rajonin. Në këto kushte, sipërmarrjes kineze i intereson të jetë më afër tregut dhe me këtë rast të eliminojë tarifat e transportit, që janë problem, ndërkohë që nga territori ynë Evropën e kanë afër dhe po ashtu edhe lëndën e parë, nga ku mund të realizojnë më shpejt dhe pa kosto prodhimet e tyre. Spitalla është një projekt, që do të mundësojë gati 100.000 të punësuar. "Është një projekt masiv. Do dhe pak kohë që të kryhet negociata, pasi ata i marrin dhe i zhvillojnë me faza projektet e tyre dhe do marrin mbështetjen edhe të ndonjë prodhuesi të njohur botëror. Kjo na intereson dhe neve në terma ekonomikë, pasi jemi të interesuar të vijë një prodhues i madh. Në këtë rast, duam të vijë Haier, prodhuesi më i madh i elektro-shtëpiakeve sot në botë që tregun e ka në Evropë", sipas Xhafës. Spitalla do jetë një zonë, ku do të ketë prodhime elektronike, elektrike dhe industrinë e lehtë. Por jo industri e rëndë, pasi s'është zona e banuar. Investitorëve kinezë u duhet kjo infrastrukturë, pasi Spitalla ka parkun energjetik, impiantin e ujërave të zeza dhe është vetëm 8 kilometra me Durrësi.

TË TJERA

"Chinese Exim Bank" do jetë Banka nga ku do kalojnë paratë për ndërtimin e "Rrugës së Arbrit", punimet e të cilës do të fillojnë vitin e ardhshëm , por edhe disa projekteve të tjera. Kryeministri Rama ka deklaruar se Rruga e Arbrit është vetëm fryt i parë i një epoke të re. Bashkëpunimi me këtë bankë ka dhe përparësitë se shumë nga firmat janë shtetërore dhe banka ka fonde shtetërore, sipas zyrtarit. Me shumë interes është pritur edhe një propozim i ri, inincuar nga Shqipëria: lidhja e gjithë zonës ballkanike dhe më gjerë e plot 17 vendeve me "Projektin e madh kinez Silk-road që është një projekt i madh hekurudhor, por që duam të ketë sa me shumë atribute. Tani është vetëm problemi i tyre burokratik, pasi duhet që të lëvizin në strukturat e tyre, përfundon shefi i kabinetit. Ndërkohë që po vazhdojnë tratativat me kompaninë kineze të China Reconstruction Company. Kjo është kompania që mendohet se do të zhvillojë Shëngjinin dhe krejt zonën industriale. Ndërkohë, ata, vetë, kanë filluar punë duke kërkuar partnerë për menaxhimin e portit, duke parë tek kompani holandeze.

* * *

Zaret janë hedhur. Kurse titulli i filmit "Horizonte të hapura", që u citua nga kryeministri kinez, është metafora më e bukur e marrëdhënieve mes dy shteteve, që po rilindin një marrëdhënie historike.

aktualitet

Deputeti Roland Keta:

Rruga e Arbërit, një premtim i pambajtur i qeverisë



Një premtim të pa mbajtur të qeverisë, e ka quajtur deputeti i Qarkut të Dibrës, Roland Keta, projektin e shumëpërfolur të ndërtimit të Rrugës së Arbrit. Kështu, në një intervistë për TVBulqiza, në vigjilje të Vitit të Ri 2015-të, deputeti i zonës, Roland Keta, ka bërë me dije se qeveria Rama-Meta, nuk ka arritur për të nënshkruar marrëveshje me kinezët për ndërtimin e Rrugës së Arbërit. Si vizita në Pekin, ashtu edhe ajo në Samitin e Beogradit, të trumbetuara nga kryeministri Rama si tejet të suksesshme, për thithjen e investimeve kineze në vendin tonë dhe posaçërisht për ndërtimin e shumë të përfolurës Rruga e Arbrit, janë veçse një mashtrim, ka thënë ai gjat kësaj interviste. Kjo pasi në asnjë rast nga këto dy takime, nuk ka patur nënshkrim marrëveshje për ndërtimin e saj mes palëve. Edhe marrëveshja e fundit, sipas deputetit Keta, ka qenë një mashtrim i radhës, pasi në Samitin e Kinës me 16 vende të Evropës Juglindore, zhvilluar në Beograd është nënshkruar një memorandum dhe jo marrëveshje. Mbi bazën e këtij memorandumi, u deklarua hapja e një sërë projektesh me financime kineze, ku vetë kryministri Rama deklaroi se projekti i parë që do të çelë siparin e këtyre financimeve, do të jetë Rruga e Arbërit. Pra bëhet fjalë për projekte dhe jo nënshkrim marrëveshje për ndërtimin e kësaj rruge, tha në vijim të fjalës së tij deputeti Keta. Sipas tij, nënshkrimi i kësaj marrëveshje bëhet mjaft i vështirë pasi kinezët për marrjen e ndërtimit të kësaj rruge me koncension kërkojnë mjaft detyrime nga qeveria, që në tërësinë e tyre mbeten mjaft të vështira për tu plotësuar prej saj. Kjo ka qenë arsyeja e vërtetë që Kryeministri Rama, nuk e ka përmendur fare ndërtimin e Rrugës së Arbrit, gjatë vizitës së tij në Bulqizë. Nuk e di se si është ndjerë deputeti i zonës dhe njëherësh ministër i Financave të qeverisë Rama-Meta, Shkëlqim Cani, që në këtë vizitë shoqëronte kryeministrin. – "Kini parasysh, vijoi në fjalën e tij Keta, se kemi të bëjmë me një projekt mjaft të rëndësishëm dhe strategjik pasi kjo magjistrale rrugore, jo vetëm e bën Bulqizën lagje të Tiranës, por lidh Dibrën këndej dhe andej kufirit, si dhe Shkupin me Tiranën. Të gjithë ne deputetët e Dibrës, përfshirë edhe vetë Kryeministrin Edi Rama, kemi premtuar gjatë fushatës elektorale ndërtimin e kësaj rruge dhe tërheqja nga ky premtim përbën një kosto të rëndë morale pa përmendur atë elektorale për ne, tha deputeti Roland Keta.

Deputeti keta foli në televizionin lokal edhe lidhur me uljen e moshës së daljes në pension të minatorëve nga 60 në 55 vjeç. Ai e quajti këtë një mashtrim të radhës të qeverisë kjo ulje do të shoqërohet me rritje të pagesës së kontributeve prej tyre në masën 5%. Nga kjo rritje, 2% do t'i përballojnë vetë minatorët dhe 3% biznesi. Kjo sipas tij do të çojë në uljen e pagave për minatorët, pasi biznesmenët llogarisin fitimet e tyre, ndaj kjo kosto prej 3% për ta, do t'i faturohet prap minatorëve. Ndërkohë, vijoi në prononcimin e tij deputeti Keta, një tjetër hile e këtij ligji mbetet dhe ajo e viteve të punës në nëntokë për minatorët. Sipas këtij ligji minatori duhet të ketë 30 vite punë për të dalë në pension, prej të cilave 12.6 vite në nëntokë. Mirë 12.6 vite në nëntokë, por për të plotësuar 30 vite punë atij i duhet që të punojë jo 12.6 vite, por edhe 17.4 vite të tjera, për të plotësuar 30 vite punë që të dalë në pension, të cilat përveçse në galeritë e minierës, nuk ka tjetërkund ku t'i realizojë. Pra përfundimisht mbetet që një minator për të dalë në pension i duhet të punojë jo 12.6 vite në nëntokë sipas ligjit të qeverisë, por 30 vite. Me këtë rast, deputeti gjatë kësaj interviste, shprehu shqetësimin e tij, për punën në të zezë në minierë, e cila është kthyer në një shqetësim serioz. Kjo për arsye se sipas tij, informaliteti në Minierën e Bulqizës, ka përfshirë edhe të rinjtë e moshave 18-20 vjeç e lart dhe kontrolli i instancave shtetërore për këtë problem në vijimësi ka lënë dhe len shumë për të dëshiruar.

Hysen Likdisha



Bulqizë, 70 minatorë në protestë për punë në të zezë

70 minatorë në pjesën jugore të minierës së Bulqizës, thënë ndryshe "Zona D" e kësaj miniere, kanë ndërprerë punën nw fillim tw muajt, duke u hedhur në protestë për mospagesën nga ana e firmës "Marea" ku ata punojnë, të sigurimeve shoqërore, raporteve mjekësore dhe ditët e festive e pagën e 13-të, sipas kontratës së nënshkruar.

Në përgjithësi që nga vera e këtij viti në vazhdim, minatorët e këtij subjekti ish "Tur-Alba", protestuan për ditë me radhë deri sa detyruan këtë firmë që të japë dorëheqjen për t'ia kaluar atë firmës aktuale "Marea". Pas disa muajsh të qetë administrimi nga ana e kësaj firme, sot shënohet dita e parë e protestave të minatorëve, të cilët përsërisin të njejtat kërkesa si edhe më parë nën administrimin e "Tur-Albës". Minatorët thonw se firma "Marea", nuk u paguan sigurimet shoqërore, raportet mjekësore dhe pagën e 13-të konform kontratës së nënshkruar mes tyre.

"Punojmë në kushte skandaloze të sigurisë në punë, ku dhjetra prej nesh janë aksidentuar me plagë për të cilat kemi marrë edhe raporte mjekësore, por nuk na janë paguar nga ana e firmës." "Firma, - vijojnë të tregojnë minatorët protestues, - nuk na paguan jo vetëm siguracionet e jetës në punë, por as edhe ata të sigurimeve shoqërore për pjesën më të madhe prej nesh."

"-Jam 25 vjeç, thotë J. Lica, punoj në galeri dhe nuk më paguhen nga ana e firmës sigurimet shoqërore, ku nesër nëse arrij të kap pensionin nuk jam i siguruar. Ndërsa për sigurimin e jetës, as që bëhet fjalë, kur dihet se kjo zonë, është vlerësuar si më e pasigurta nga specialistët dhe aksidentet me humbje jetësh nuk kanë munguar, pasi edhe kushtet e sigurisë në punë lënë shumë për të dëshiruar."

Ndërkohë minatorët shprehen të vendosur për vijimin e protestave të tyre deri në plotësimin e kushteve nga ana e firmës sipas kontratës së nënshkruar me të.

H.Likdisha

Ministria e Mjedisit, kontroll subjekteve minerare per lejet e mjedisit

Inspektorët e Ministrisë së Mjedisit kanë verifikuar në minierën e Bulqizës lejet mjedisore për shfrytëzimin e galerive nga kompanite koçensionare dhe ata të vogla private.

Pas këtij kontrolli, 27 subjekte që shfrytëzojnë mineralin e kromit në këtë zonë janë gjobitur me nga 500,000 lekë, pasi rezoltuan pa lejet mjedisore.9 prej tyre u wshtw pezulluar aktiviteti.

Ky Inspektoriati ka nisur një aksion për të gjitha subjekete që shfrytëzojnë mineralin e kromit, e ndërsa në rrethin e Bulqizës janë 86 subjekteve minerare që ushtrojnë aktivitetin e tyre.

Ergys Agasi, inspektor i përgjithshëm shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave në ministrinë e Mjedisit, bëri me dije se aksioni do të vazhdojë në të gjithë territorin e republikës. Gjatë aksionit, jo vetëm që do të kontrollohen lejet mjedisore, por edhe lënda drusore që subjektet përdorin për armimin e galerive, në plotësim të kushteve të sigurisë në punë për minatorët.

Sipas tij, nga verifikimi i bërë deri më tani, janë konstatuar se në Bulqizë veprojnë 86 subjekte minerare, dhe mbi 50% e tyre nuk janë të pajisur me leje mjedisore.

H. L.

Ftesë për bashkëpunim

Gazeta "Rruga e Arbërit" në bashkëpunim me Botimet M&B ka në projekte për vitin e ardhshëm disa veprimtari dhe botime në fushën e kulturës, me vlera historike, kulturore dhe kombëtare për Dibrën dhe gjithë Shqipërinë.

Ftojmë individë, shoqata apo institucione vendore të bëhen bashkërealizuese të këtyre projekteve.

Për më shumë informacion mund të shkruani në email mbbotime@gmail.com, rrugaearberit@gmail.com ose mund të telefononi në numrin 069 20 68 603.
Faleminderit!

Librat e botuar nga Botimet M&B mund ti gjeni në Tiranë pranë librarisë së Shtëpisë Botuese M&B, në rrjetin e librarive "Adrion", si dhe në disa librari kryesore në Tiranë.
Në Peshkopi: Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.
Në Durrës: Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353
Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603
068 65 08 441 / 067 30 73 265
E-mail: <mbbotime@gmail.com>

600 vende të reja pune, 25 milionë USD investime

Nga **HYSEN LIKDISHA**

22 dhjetori i këtij viti ka qenë një ditë e veçantë për qytetet e verilindjes së vendit, Burrelit dhe Bulqizës, pasi janë vizituar nga Kryeministri Edi Rama. Në këtë tur vizitash, ai është shoqëruar nga ministri i Energjitikës dhe Industrisë, Damian Gjiknuri dhe deputetët e zonës, Shkëlqim Cani dhe Përparim Spahiu.

VIZITA NË BURREL: 600 VENDE PUNE ME 600 DOLLARE RROGËN

Gjatë vizitës në qytetin e Burrelit, kryeministri Rama ka ndaluar në Uzinën e Ferrokromit, ku ka parë në vend vënien në punë të kësaj uzine, si dhe është interesuar për kushtet e punës për metalurgët. Uzina e Ferrokromit në Burrel prej vitesh kishte ndaluar punën për pasurimin e kromit, duke lënë pa punë të paktën 200 metalurgë. Mbi bazën e interesimit dhe ndërhyrjes së qeverisë, u mundësua ndërhyrja me fonde investimi nga ana e kompanisë AlbChrome, për vënien e saj në punë. Gjatë kësaj vizite, Kryeministri Rama u shpreh tejet i kënaqur që në këtë uzinë filloi puna për përpunimin e kromit, gjë për të cilën u investuan 15 mln USD. Mbi bazën e investimeve të dhëna, kjo uzinë do krijojë një potencial punësimi për 600 punëtorë, rroga e të cilëve do të jetë 600 dollarë, -tha gjatë kësaj vizite kryeministri Rama. Pas kësaj vizite Kryeministri i shoqëruar edhe nga kryetarja e bashkisë, Adelina Farrici, ka bërë një vizitë në Parkun e lojrave që po ndërtohet në Burrel, me një fond investimi prej 70 milion lekë të ri, i cili sipas projektit do të jetë i paisur me të gjitha komponentët e duhur. Po kështu kryeministri inspektoi punimet edhe për sistemim-asfaltimin e bulevardit në lagjen "Budi", punime këto të realizuara me një fond investimi prej 15 milion lekë të ri. Po kështu në këtë lagje është kryer edhe një tjetër investim prej 17 milion lekë të ri, për rehabilitimin e fasadave të pallateve.

VIZITA NË BULQIZË: VËZHGIM NË PUSIN E THELLËSISË DHE INVESTIMEVE NË QYTET

Ndalesa e radhës në këtë tur vizitash në verilindje, të kryeministrit Rama, ishte në qytezën e minatorëve të kromit, Bulqizë. Ai fillimisht ka shkuar në minierën e kromit, ku është pritur nga drejtues dhe minatorë, si dhe një grup specialistësh kinezë, që punojnë prej muajsh këtu të kontraktuar nga firma koncensionare që menaxhon aktualisht minierën, Balfin Group, për realizimin e punimeve për hapjen e thellësisë së pusit nr.9, nën nivelin e 16-të të tij. Hapja e thellësisë së minierës, ka qenë dhe mbetet një nga problemet dhe sfidat më të mëdha për tu realizuar, pasi ka të bëjë me jetgjatësinë e saj, por që ndër vite është është zvarritur dhe ka mbetur e pa realizuar.

Sipas specialistëve të minierës, thellimi i pusit nr.9, hap perspektivën e shfrytëzimit të kësaj miniere, të paktën edhe me 20 vite të tjera. Kryeministri gjatë kësaj vizite "rezervoi" një takim të veçantë me punëtorët e specialistët kinezë, duke i pyetur ata një nga një për shëndetin, u është drejtuar atyre në shqip, duke i thënë gjithësecilit prej tyre - "si je", si për të thënë që ata duhet të mësojnë shqip. Kjo "kërkesë" e Kryeministrit për kinezët që të mësojnë shqip, ndofta u bë për të thënë se bashkëpunimi me kinezët do vijojë për gjatë, po të kemi parasysh edhe marrëveshjen e nënshkruar së fundmi në Samitin e Kinës me 16 vende të Evropës Juglindore zhvilluar në Beograd. Në këtë Samit, u deklarua hapja e një sërë projektesh me financime kineze, ku vetë kryministri Rama deklaroi se projekti i parë që do të çelë siparin e këtyre financimeve, do të jetë Rruga e Arbërit, ndërtimi i së cilës do të nisë në vitin e ardhshëm 2015, gjë e cila është mjaft e mirëpritur nga Bulqiza, Dibra dhe dibranët këndej dhe andej kufirit.



Gjatë inspektimit në minierë, foli ministri Gjiknuri, i cili e informoi Kryeministrin se ndër vite kjo minierë, ka qrenë pre e abuzimit dhe grabitjes. Me ndërhyrjen e qeverisë dhe investimin e ri në krom prej 25 mln usd, kjo minierë tashmë është vënë nën kontrollin dhe funksionimin ligjor të saj.

Një informacion më të detajuar për mirfunksionimin e minierës dha për Kryeministrin Rama, drejtori i kësaj miniere Edmond Xhafa. Mesazhi i shkurtër, por mjaft shpresdhënës për ecurinë efektive e të duhur në këtë minierë, që kryeministri Rama përcolli gjatë kësaj vizite ishte: "Miniera e Bulqizës, jo më shpellë e grabitjes.

Pasi vizitës në minierë, Kryeministri Rama, nën shoqërimin e kryetarit të bashkisë Bulqizë, Myfit Duriçi, ka inspektuar investimet e dhëna nga qeveria për sistemim-asfaltimin e rrugëve në lagjen Gjeologu dhe rikonstruksionin e Gjimnazit. Gjatë inspektimit kryeministri është shprehur i kënaqur me realizimin e këtyre investimeve.

> "Në Bulqizë investim i ri në krom 25 mln USD dhe transformim urban që do të preket edhe më shumë në 2015. Bulqiza - jo më shpellë për grabitësit!"

"-Kryetari me 19 milion lekë, - ja ç'farë ka realizuar, po sikur t'i japim më shumë, çfarë mund të bëjë ai!" – tha kryministri gjatë këtij inspektimi. Ndërkohë ka sugjeruar terrene sportive për shkollat.

- "Do mbështeteni me financim për t'i dhënë pamjen e duhur qytetit, theksoi Kryeministri në fund të kësaj vizite. Në qoftë se Bulqiza është trajtuar në mënyrën më të keqe të mundshme, kjo ka ardhur pasi janë shpërdoruar fondet e dhëna, prandaj ka mbetur në këtë gjendje".

Ndërkohë, gjatë kohës që po kryente këtë vizitë në qytetin e minatorëve, Kryeministri shkroi në faqen zyrtare në FB: "Në Bulqizë investim i ri në krom 25 mln USD dhe transformim urban që do të preket edhe më shumë në 2015. Bulqiza - jo më shpellë për grabitësit!"

Gjatë këtyre vizitave kryeministri Rama u shoqërua, edhe pse nuk ishin lajmëruar për një gjë të tillë, nga qindra banorë të këtyre qyteteve dhe të zonave përreth që kishin dalë në pritje të tij.

Intervistë me kryetarin e bashkisë Bulqizë, Myfit Duriçi.

Viti i ardhshëm do sjellë më shumë investime

Për të marrë një informacion më në detaje në lidhje me vizitën e kryeministrit Rama në Bulqizë, biseduam me kryetarin e Bashkisë, zotin Myfit Duriçi, i cili e ka shoqëruar Kryeministrin në çdo hap të kësaj vizite, ku dhe i ka bërë prezente atij të gjitha investimet e realizuara në pak më shumë se një vit në krye të kësaj bashkie.

- Si u mundësua realizimi i vizitës së kryeministrit Rama në qytetin truaj të Bulqizës dhe cili ishte qëllimi i kësaj vizite

- Kryeministri Edi Rama ju përgjigj dëshirës dhe ftesës për të bërë një vizitë në qytetin tonë, për të biseduar për gjithë investimet e realizuara me fondet e dhëna nga qeveria gjatë këtij viti, si dhe për të parë ecurinë e punimeve në hapjen e thellësisë së pusit nr.9, gjë e cila është mjaft e rëndësishme për hapjen e perspektivës së minierës.

- Dhe si e vlerësoi punën për hapjen e këtij pusi kryeministri?

- Kryeministri pasi u informua për punën e bërë për hapjen e këtij pusi u shpreh mjaft i kënaqur me ecurinë e mirë të këtyre punimeve që po realizohen me cilësi dhe konform projektit përkatës. Gjendja paraqitej e tillë që ishtë në fazën përfundimtare të vendosjes së makinerive, të cilat do mundësojnë fillimin e punës për avancimin e hapjes së thellësisë.

- Kur mund të nisë puna për këtë avancim?

- Drejtuesit dhe specialistët e minierës deklaruan para kryeministrit se hapja e thellësisë do vijojë pas 1 muaji, pra fundjanari i 2015-tës.



- Me çfarë mesazhi u largua Rama nga miniera?

- Jam i kënaqur, - tha Rama, me ecurinë dhe ritmin e punimeve që po kryhen nga kinezët për hapjen e thellësisë së minierës, gjë për të cilën inkurajoj kontraktuesit dhe garantoj se miniera dhe biznesi në përgjithësi dhe koncensionari në veçanti, do të ketë mbështetjen e qeverisë.

- Po gjatë inspektimeve në rrugën dhe shkollën e mesme, ç'farë i tërhoqi vëmendjen Kryeministrit.

- I tërhoqi vëmendjen puna e bërë për këtë rrugë me aq pak investime, ku veçoi brezin e gjelbërt të kësaj rruge. -"Kryetari me 19 milion lekë, - ja ç'farë ka realizuar, po sikur t'i japim më shumë, - çfarë mund të bëjë ai! – tha kryministri gjatë këtij inspektimi. Ndërkohë ka sugjeruar terrene sportive për shkollën e mesme dhe dy shkollat 9-vjeçare.

- Projekti për sistemimin e rrugës që lidh dy pjesët e qytetit, u diskutua me kryeministrin?

- Po dhe mora premtimin se në janar 2015-të, do bëhet kalimi i të gjitha fondeve financiare për realizimin e plotë të këtij projekti me të gjithë aksesorët përkatës.

Bisedoi: H.Likdisha

"Mjeshtër i Madh" për Ismail Ketën

Vëllezërit kampion i dhurojnë qytetit të Bulqizës afro 100 mijë Euro


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI I REPUBLIKËS

I jep

ZOTIT ISMAIL KETA

titullin "Mjeshtër i Madh"

"Në vlerësim të përkushtimit të tij të rallë, duke e konsideruar sportin e Tai dhe Kik Boksit si një mision madhor për t'i shërbyer Shqipërisë. Me talentin dhe aftësitë e veta, ai është kthyer në një përfaqësues të denjë të komit shqiptar në arenën botërore."

Nr. Dekretit 8850
Tiranë, më 19.12.2014

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
BUJAR NISHANI



Ismail Keta u nderua nga Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, me titullin "Mjeshtër i Madh" me motivacionin "Në vlerësim të përkushtimit të tij të rrallë, duke e konsideruar sportin e Tai dhe Kik Boksit si një mision madhor për t'i shërbyer Shqipërisë. Me talentin dhe aftësitë e veta, ai është kthyer në një përfaqësues të denjë te komit shqiptar në arenën ndërkombëtare".

Mjeshtri Keta e mori titullin gjatë një mbrëmje gala të organizuar nga Presidenti i Republikës me rastin e Vitit të Ri.

Më 24 dhjetor, Ismaili se bashku me vëllain e tij, Gjetanin, i dorëzuan Bashkisë së Bulqizës çekun prej 4.5 milionë lekësh, të cilat u mblodhën nga reklamat dhe biletat në ndeshjen e zhvilluar për Kampion Europe nga Gjetani në muajin tetor.

"Ishte kënaqësi që me mundësitë tona profesionale si sportistë, mundem të promovojmë vendlindjen tonë, Bulqizën, në gjithë botën. Përveç çekun prej afro 45 milionë lekësh, në projekt janë dhe hekurat e Arenës prej rreth 40 mijë eurosh, që do t'i përdorim për pallatin e sportit ose për futbollin në Bulqizë", thotë kampioni i botës në Tai & Kik Boks.

"Gjatë një bisede me Ministrin e Finavcave, z. Shkëlqim Cani, thotë Keta, i kemi kërkuar atij që lekët që i takojnë Gjetanit për Titullin Kampion Europe, ti bashkangjiten donacioneve për sportin e Bulqizës.

Duke llogaritur në vlerë financiare gjithë kontributin - çekun, arenën dhe çmimin e Gjetanit si Kampion Europe,- vëllezërit Keta kanë dhuruar për sportin e Bulqizës një shumë mbi 100 mijë Euro, duke e renditur këtë donacion për qytetin e vogël të minatorëve, si një ndër më të madhin në historinë e saj.

Ç'kemi ásaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Ky muaj ishte i mirë me lajme për Dibrën, sidomos për lajmet për Rrugën e Arbërit. Edhe gënjeshtër të jetë, bukur është.

Mbaj mend kur na gënjenin kur ndërtohej Rruga e Kombit: Sa të mbarojë, do plasin minat në tunelin e Murrizës... Por minat plasën në tunelin e Krrabës, atij të Murrizit i plasën ujërat...

Meqë jemi te tuneli, i doli drita tunelit të Qafë Buallit. I doli dy ditë para se tha Ministri, por lajmin e lam ta japim me 30, që t'i dalë fjala ministrit, i cili u mundua shumë të shpjegonte, se shkurtimi i tij ishte standard i arritur...

Kundërshtarët e kryeministrit u sulën në rrjetet sociale: U ka falur kinezëve minierën për Rrugën e Arbërit... Pse ka 20 vjet që minierën e shfrytëzojnë pa kriter, duke shfrytëzuar punën e fëmijëve, grave e pleqve, apo gjakun e viktimave në galeri, nuk flet kush...

Por, sidoqoftë, kryeministri kinez duket sa ka premtuar seriozisht për Rrugën. Ndoshta sepse kishte simpati për Adem Rekën, djalë Dibre, dhe për këtë ka vendosur ta bashkojë Durrësin me Dibrën...

Këtë muaj media zbuloi se sipas statistikave, dibranët kishin qenë spiunët më të mëdhenj: shkruanin letra sigurimit për njëri-tjetrin, madje njëri kishte futur edhe vëllain në burg...

Në Dibër u organizua një konkurs: Kush kap peshkun më të madh në liqen, fiton 100 euro... Çmimin nuk e fitoi asnjëri, se jo vetëm peshk i madh nuk u kap, por as i vogël...Vetëm atëherë u kuptua se koncensionari aktual e ka shfarosur të gjithë peshkun e Liqenit të Dibrës...

U kap "banda e babagjyshëve". Njërin nuk e ka kapur dot policia: mori plumbin ballit në korrik në Dibër.

Këtë muaj ishte në Peshkopi një dëgjesë publike për arsimin. Korrespondenti ynë e ndoqi takimin dhe përcolli lajmin: Drejtori recitoi fjalimin, vartësit cicërinë pas tij: matura ishte më e dobta në republikë, në olimpiada nuk pati as pjesëmarrës, jo më të mendosh fitues, per ngjarjet kriminale në shkolla nuk merr kush përgjegjësi, një fëmijë bie nga kati i dytë i shkollës, por askush nuk del fajtor.... Fjalët kyçe të takimit ishin Akademi, Akademizëm, Cilësi, Standard... Kështu që takimi nga "Dëgjesë publike" u bë "fërgesë publike"...

Studentët vazhdojnë protestat, ditë pas dite. U fol për një greve urie, por me sa duket e kanë lënë pas vitit të ri. Ndoshta edhe qeveria për festa ndërron mendje: i lë studentët të vazhdojnë shkollën si deri më tani: 50 euro një provim, pavarësisht se nuk dinë as shkrim e këndim...

Korabi u shpall Kampion i Dimrit. Tifozët mbushën stadiumin, por nuk kanë rënë dakord akoma për emërtimin e grupit të tifozëve...

Viti që iku ishte me strese për Dibrën: Radika, Universiteti, Rruga, Miniera... 2015 erdhi me dëborë! Qoftë me fat të bardhë, si vetë bora që solli!

Ditari i një vajze...

Letër Babagjyshi për Vitin e Ri!

I dashur babagjysh,

Në fillim të kërkoj shumë ndjesë nëse për fajin tim, dikush do të mbetet pa dhuratë. Unë vetë nuk jam fëmijë, por kam shumë fëmijë të cilët më kanë braktisur dhe më kanë lënë në mëshirë të fatit.

Unë jam një grua e moshuar, dhe mos e ndërpre leximin këtu të lutem, sepse nuk i dua dhuratat për vete, dua t'ua lë trashëgim fëmijëve të mi. Ato janë shumë të zënë me punët e tyre e nuk kanë kohë të vijnë të më shohin, ndaj Babagjysh bëje Rrugën e Arbrit, sa më shpejt, sepse po më djeg malli për bijtë e mi. Jam e sigurt që me ndihmën tënde ato do të vijnë më shpesh të më vizitojnë. Kështu i kam justifikuar gjithmonë, kështu justifikohen dhe ato. E di ti Babagjysh sa e lodhshme është rruga ndaj s'ju vë faj...

Dëgjo Babagjysh, nëse do të na e bësh rrugën këtë vit, do të jetë më mirë edhe për ty, sepse vitin e ardhshëm kur të vish prap tek unë, do të kursesh shumë kohë dhe para me të cilat mund të kënaqësh fëmijë të tjerë.

Se harrova të të them, nuk më kanë braktisur të gjithë bijtë jo, i kam ca në gjirin tim. Janë çunat e "Korabit", Babagjysh. Duhet të kesh dëgjuar për ta, po, po, ke dëgjuar. Ato po thyejnë rekorde: janë kampionët e dimrit në kampionatin e futbollit. Edhe për ta kam një kërkesë Babagjysh. Dua një thes me para. Mos u habit, nuk i dua për asnjë qëllim negativ. Nuk duam t'i blejmë ndeshjet, as albitrat, atyre u kam mësuar se në jetë ecet me drejtësi, djersë e mund, jo më mashtrime e rrugë të padrejta. Jam nënë e më dhimbsen kur i shoh të stërviten në të ftohtë, në borë, në shi. Në fushën plot baltë. Dua t'ju bëj atyre një palestër të mbyllur, sepse si atje në Pol të Veriut ku je ti, edhe këu tek ne bie shumë borë e bën ftohtë. Dua t'ju blej atyre uniformat e përshtatshme, t'ju krijoj kushte, t'u gatuaj mirë sepse ata stërviten fort.

Njësoj si këto më dhimbsen fëmijët e tjerë që po shkolloj Babagjysh. Atyre duan t'ju mbyllin universitetin, t'i nxjerrin në rrugë. Unë nuk kam para të mjaftueshëm për t'i shkolluar në një vend tjetër dhe ti e di mirë që pa shkollë s'bën dot asnjë hap përpara. Mendo një zgjidhje optimale dhe për ta Babagjysh.

Kam edhe disa kërkesa të tjera, por nuk dua të të mërzis e të të lodh. Në qoftë se do të më plotësosh këto sa përmenda do të jem shumë e lumtur. Ti mos mendo se do të të lë pa të shpërblyer edhe unë Babagjysh. Sapo të mbërrish, do të të çoj në një vend ku burojnë ujëra termale, "llixha" - u themi ne. Ato do të të qetësojnë e do të ta heqin lodhjen e rrugës së gjatë, si me dorë. Në qoftë se do të kesh nge Babagjysh, do të të çoj të shohësh Kalanë e Grezhdanit, është më e madhja në Ballkan. Më pas nëse do të më marrësh dhe mua në slitë, sepse dhe për atje është rrugë e gjatë dhe e vështirë e s'kalojmë dot ndryshe. Do të të çoj të shohësh Liqenet e Lurës dhe të Balgjajt. Unë e di se ti ke parë shumë vende të botës por këtu të premtoj se do të mbetësh i mahnitur.

Po të duash babagjysh, do shkojmë edhe në Korab të rrëshqasim njëherë me slitën tënde... Në Korab, babagjysh, mund të vish edhe në verë: lart në male ka dëborë, ndërsa poshtë në kullotë bagëtia hazdiset livadheve që zbukurohen me plot lule shumëngjyrëshe.

E fundit Babagjysh, do kisha nevojë edhe për një xhiro nga Radika... Do ta shohësh sa e bukur është dhe kërkoj ndihmën tënde për ta mbrojtur Babagjysh...

Në fund të vizitës babagjysh, do të të shtroj një gosti më të gjitha të mirat: ushqime bio të të gjitha llojeve, që do të të shijojnë shumë nën shoqërinë e djemve të mi, që do të të mbajnë me muhabet gjithë natën!

Si të duket Babagjysh?

Ku ndahet Dibra e Epër nga Dibra e Poshtme, Topalltia dhe Malësia si dhe mbi përdorimin e gabuar të ndarjeve Dibër e Madhe - Dibër e Vogël.


histori

Mbi emërtesat Dibër e Epër dhe Dibër e Poshtme



Nga **MOISI MURRA**

Dibra e Epërme nga Dibra e Poshtme ndahet nga një vijë që del në jug të malit Krepi i Zanit (2116) aty ku fillojnë të burojnë dy rrjedhje të Radikës, kthen drejt jugut, ulet në Qafë të Kadisë, Guri i Velpnës, përroi i Krojftit, len fshatin Grekaj, Tanushaj dhe Zhirovnicë në Dibër të Poshtme dhe fshatrat Zhuzhinja, Nivishtë, Verbjan, Bitushë në Dibër të Epër, e del në malin e Hinoskës(L.1998). Nga mali i Hinoskës ulet në Kodrat e Qenokut, duke lënë në Dibër të Epërme fshatrat Erebar dhe Dovalan dhe në Dibër të Poshtme fshatrat Ilnicë, Trepçë, Pjeçë, Pejkë. Nga Kodrat e Qenokut kufiri zbret në Drinin e Zi dhe pasi e kapërcen ate në veri të Urës së vjetër të Daut Murres , ndjek rrjedhjen e Gurrës së Mazhicës, duke lënë në Dibër të Poshtme fshatrat Hotesh, Lishan i Poshtëm, Lishan i Epërm , kalon në Qafë Qarr, në Majën e Shullanit, Qafë Torrë, Maja e Runjës, Qafas (Zhuri i Pllajit, Lurë).



(Shtrunga-Kurdari), Mali i Kreshës, Mali i Lepurit, Qafë Buell, ngjitet në Liqenin e Zi , Kalon në Prodan e në Malin e Gurit, zbret në Qafë Shkallë të Llangës, vazhdon nga Qafa e Helmit, te Panja e Sul Tupit, Mali i Draganit, mali i Darsit, Mali i Shebenikut ose malet e Kuqe, del te Varri i Nuses, pastaj vazhdon para faqes veriore të maleve të Belicës, fut brenda Jabllanicën, pret Drinin e Zi, vazhdon në Mbigjur të Mislodezhit, ngjitet në malin e Llokmave, duke lënë brenda Dibrës së Epër mikrokrahinën e Zhupës, kalon në fshatin Sencë, Duf, ngjitet në Malet Kozhuf e Bistrica, e mbyllet atje ku u nis, lartësia 2116 m.

Këtu të tërheqin vemendjen tri fshatrat e Rekës: Grekaj, Tanushaj dhe Zhirovnica që hynë në Dibër të Poshtme.

Në Dibër të e Epër numërohen dhjetë mikrokrahina me veçori etnokulturore të ndryshme si: Gryka e Vogël, Gryka e Madhe, Katër Grykët, Bulqiza, Golloborda fshatrat e Gollobordës Perëndimore (Okshtun, Prodan, Zabzun, Sebisht, Borovë, Muglicë, Llëngë), Drinkolli i Dibrës (Otishan, Xhepishtë, Drenok, Modriç, Llukovë, Nerezi, Bezova, Piskupshtina, Jabllanica), Zhupa, Reka dhe Fusha e Shehrit.

Dibra e Poshtme kufizohet nga veriu me Kukësin, nga juglindja me Dibrën e Epër, nga Perëndimi me Matin dhe Mirditën. Kufiri nis nga Guri i Kuq i Lurës, ulet dhe vazhdon rrjedhen e përroit të Mallës, Kalon Drinin e Zi, rrotullohemi pak nga veriu deri në Qafë-Draj (Draj-Reç), kthehemi përsëri nga jugu e zbresim në ujët e Veleshicës. Prej këtu, duke ndjekur rrjedhjen e ujët të Veleshicës ngjitemi në Korab, kthejmë drejt juglindjes e zbresim aty ku fillon të burojë Radika, në jug të fshatit Restilicë të Komunës së Prizrenit, e prej këtu sipas ndarjes që u tregua për Dibrën e Epërme dalim në Pllajin e Lurës, kalohet në pjesën lindore të malit të Dejës, që ndan Macukullin nga Gurë Lura, pastaj në Fushë Vjerdhës të Mirditës, Lajthizë e përfundon aty ku u nisëm, në Gurë të Kuq.

Në Dibër të Poshtme numrohen shtatë mikrokrahina : Luznia, Muhurri, Lura, Reç e Dardhë, Uj' e m'ujë, Çidhna dhe Katundet e Epërta e ata për rreth qytetit të Peshkopisë.

Veç emërtesave Dibër e Epërme dhe Dibër e Poshtme nisi të përdorej dhe Dibër e Madhe dhe Dibër e Vogël. Nuk dihet me saktësi se kur nisi të përdoren këta emërtesa, por ka shumë mundësi të ketë nisur nga mesi i shekullit XVII. Nga një letër e konsullit italian në Durrës, Xhuzepe Kapriata, dërguar eprorëve të tij, më 9 qershor 1784, mbi masat stabilizuese të Kara Mahmud Pashës, hasim në emërtesën Dibra e Vogël: "...Mamut Bek levante in Cavaglia, e con tutto quest' ammaso di gente il Pasc medesimo si e diretto ad ataccare il comandante di Zibra piccolo. (... Mamud Bej i ngritur në Kavaj dhe me gjithë këtë grumbull njerëzish po ai Pasha u drejtua të sulmoi komandantin e Dibrës së Vogël (Jusuf bej Hysenagollin-M. Murra).

Më vonë, aty nga viti 1878, me emërtesën Dibër e Madhe fillojë të nënkuptohej Shehri i Dibrës me fshatrat përreth. Përdorimi i emërtesave Dibër e Madhe dhe Dibër e Vogël nuk ndryshon gjë me emërtim tradicional Dibër e Epër dhe Dibër e Poshtme. Por është gabim t'i thirrësh Shehërit (Oranikut famëmadh) të Dibrës, Dibër e Madhe. Sipas kësaj logjike dhe me emërtesën Dibër e Vogël duhet të kuptojmë qytetin e Peshkopisë. Aq keq ka hyrë në përdorim Dibër e Madhe për Shehrin (qytetin) e Dibrës sa që kur pyet një qytetar të Peshkopisë, apo të fshatrave të Dibrës se ku shkon, ai të përgjigjet: në Dibër të Madhe. Por kjo nuk është e drejtë.

Dibra ka njohur dhe një ndarje tjetër: Topallti dhe Malësi ose Nandë Malet .

Topallti quhej ajo pjesë e Dibrës që kishte pranuar e njohur sundimin turk, d.m.th. paguante vergji, të dhjeta e xhelp dhe ndonjë herë më të rrallë jepte dhe ushtarë. Në Topallti hynte qyteti i Dibrës, Reka, krahina e Zhupës, Golloborda lindore dhe të gjithë katundet në lindje të rrugës: Koxhaxhik, qyteti i Dibrës-Peshkopi-Kastriot.

Pjesa tjetër quhej "Malësi". Malësia ndryshe quhej "Nandë Malet e Dibrës", të cilët kurrë nuk i kanë qenë nënshtruar sundimit turk.

Malësia kishte një administratë autonome dhe sundohej me ligjin e maleve, që dibranët e moçëm e quanin "Kanuni i Skenderbeut".

Në Malësinë e Dibrës (Nandë Malet) hynin: Reçi, Dardha, Çidhna, Muhurri dhe Luznia në Dibër të Poshtme dhe Gryka e Vogël, Gryka e Madhe, Bulqiza, Katër Grykët në Dibër të Epër.

Gjithashtu është quajtur Malësi, d.m.th hynin në Nandë Malet dhe katundet e Gollobordës Perendimore (Okshtun, Prodan, Zabzun, Sebisht, Borovë, Muglicë, Llëngë).

Ne se duam shtrirjen e Dibrës së Epërme, vija kufitare zbret në Vanas, vazhdon me Kepin e Qetës, Mali i Allamanit, Vinjoll (Mat), Fusha e Thatë, Maja e Thatë e tillë paraqet dobësi, por për deri sa nuk kemi tjetër indikacion jemi të detyruar të heshtim.

Dibra e Epër nga Dibra e Poshtme ndahet nga një vijë që del në jug të malit Krepi i Zanit (2116) aty ku fillojnë të burojnë dy rrjedhje të Radikës, kthen drejtë jugut, ulet në Qafë të Kadisë, Guri i Velpnës, përroi i Krojftit, len fshatin Grekaj, Tanushaj dhe Zhirovnicë në Dibër të Poshtme dhe fshatrat Zhuzhinja, Nivishtë, Verbjan, Bitushë në Dibër të Epër, e del në malin e Hinoskës(L.1998).Nga mali i Hinoskës ulet në Kodrat e Qenokut, duke lënë në Dibër të Epërme fshatrat Erebar dhe Dovalan dhe në Dibër të Poshtme fshatrat Ilnicë, Trepçë, Pjeçë, Pejkë. Nga Kodrat e Qenokut kufiri zbret në Drinin e Zi dhe pasi e kapërcen ate në veri të Urës së vjetër të Daut Murres , ndjek rrjedhjen e Gurrës së Mazhicës, duke lënë në Dibër të Poshtme fshatrat Hotesh, Lishan i Poshtëm, Lishan i Epërm , kalon në Qafë Qarr, në Majën e Shullanit, Qafë Torrë, Maja e Runjës, Qafas (Zhuri i Pllajit, Lurë).

intervistë



MONIKA STAFA:

Vizita në Dibër, një peng i heshtur

Intervista me gazetaren Monika Stafa Shoshori është realizuar në kuadër të bashkëpunimit të gazetës "Rruga e Arbërit" me faqen sociale në FB "Peshkopi,Dibër,Albania". Ajo do botohet edhe në faqen në internet http: peshkopidiberalbania.wix.com. Bashkëpunimi synon të bëjë publike me anë të intervistave sukseset e dibranëve në fusha të ndryshme të jetës.

Nga SASHENKA NDREKA

Ka krijuar imazhin e vet në ekran dhe zor se mund ta ngatërrosh. Është Monika Stafa. Spikerja e parë e Top Channel-it, e cila nuk i është ndarë asnjëherë karriges informative të këtij televizioni. Por ajo nuk është thjesht personi që lexon lajmet. Pasioni për gazetarinë ka bërë që Monika të ideojë dhe të realizojë një sërë dokumentarësh historikë, duke u vlerësuar gjithashtu me çmime të rëndësishme, më i freskëti ai i "Gazetares së vitit", dhënë nga Unioni i Gazetarëve. Ajo nuk e rastësishme në dokumentarët historikë, pasi Monika është diplomuar në degën e Historisë. Dashuria dhe pasioni për fjalën e ka çuar atë më tej, në botimin e një seri librash, ndër të cilët mund të përmendim: "Çështja e Shën Naumit", "Monarkia kundër Republikës", "Gati për rinisje" dhe më i fundmi, "Një ditë si Sofia".

Intervista e mëposhtme është një bisedë ekskluzive për gazetën Rruga e Arbërit.

- Çdo të përjetonim po të ishim "Një ditë si Monika"?

Gjëra të bukura, aspak të mërzitshme. Askush nuk do ta përjetonte njësoj jetën në thelbin e vet edhe po të donin të jetonin një ditë si Monika, secili do ta përjetonte në mënyrën e tij, pavarësisht se do të përpiqeshin të ndiqnin çfarëdo modeli.

- Keni provuar të bëni shumë zhanre mediatike, gjithashtu keni ardhur dhe ndryshe tek publiku, si shkrimtare. Si jeni ndier më mirë?

Unë ndihem mirë sa herë krijoj dhe sjell në fund një vepër që mban emrin tim. Puna, natyrisht është në skuadër, por impenjimi në krijimtari është personal. Nuk do t'i ndaja dot zhanret. Për mua secila prej tyre kanë impenjimin e vet maksimal dhe që përpiqem të arrij sipëroren.

- Keni drejtuar një emision në kuadër të 100 Vjetorit të Pavarësisë, që personalisht më ka lënë mbresa të thella "Kush e ngriti flamurin". Si do ta cilësonit këtë moment në karrierën tuaj?

Ka një gjë të veçantë në fakt, nëse do ti gjesh ndopak më shumë cilësi apo emër. U krijua në kuadër të 100 Vjetorit të Shtetit Shqiptar dhe për mua një emision i tillë ishte më shumë se sa kënaqësi, ishte një çmim në motivimin për të kryer më shumë punë e aksione në shërbim të vendit ku jetojmë e që i përkasim.

- Po frymëzimin për të shkruar, ku e merrni? Merrni nxitje nga realiteti shqiptar?

Unë e vlerësoj të bukurën dhe të mençurën dhe përpiqem të jap maksimumin për t'i nxjerrë në pah këto vlera që i kemi dhe, kur i gjejmë, t'i nxisim. A ka frymëzim më të madh se ky? Jo vetëm realiteti shqiptar ka vend për frymëzim, të mirat e tij mundohem t'i kuroj dhe nga ana tjetër të modeloj ato vlera që na humbasin shpesh në egërsinë tonë të përditshme.

- A ngjajnë gratë shqiptare me Sofinë tuaj?

Çdo grua ngjan me Sofinë e mençur dhe të bukur nëse lufton të jetë si ajo. Asgjë nuk vjen nëse nuk përpiqesh ta kesh me dituri dhe mençuri. Jeta është e bukur vetëm kështu. Gratë tona kanë nevojë vetëm për pak më shumë ndjeshmëri për veten dhe tjetrin, për empatinë. Tingëllon e thjeshtë por nuk është dhe aq.

- Nëna juaj është dibrane. Ç'karakteristika të Dibrës ka trashëguar ajo tek ju?

Mençurinë e heshtur apo dhe vullnetin për punë ndoshta? Se di duhet të pyesni atë.


- A mund të ndani me ne një eksperiencë me Dibrën që ka mbetur akoma në kujtesën tuaj?

Jo e kam të pamundur. Nuk kam qenë atje asnjëherë. Është një peng i heshtur dhe një detyrë në kalendarin tim të punëve.

Çdo grua ngjan me Sofinë e mençur dhe të bukur nëse lufton të jetë si ajo. Asgjë nuk vjen nëse nuk përpiqesh ta kesh me dituri dhe mençuri. Jeta është e bukur vetëm kështu. Gratë tona kanë nevojë vetëm për pak më shumë ndjeshmëri për veten dhe tjetrin, për empatinë. Tingëllon e thjeshtë por nuk është dhe aq.

Unë e vlerësoj të bukurën dhe të mençurën dhe përpiqem të jap maksimumin për t'i nxjerrë në pah këto vlera që i kemi dhe, kur i gjejmë, t'i nxisim.





- Koha mediatike është gjithmonë në disfavor të punonjësve të saj. Si ia bëni ju për të menaxhuar kohën tuaj dhe për t'iu kushtuar familjes?

Oh, është një pyetje e vjetër tashmë. Tani jam kthyer mbrapsht unë. Koha është flori për të gjithë, por për mua është një kohë pa kohë. Shpesh herë më duket sikur vazhdon pafundësisht pa stacione.

- Ekziston akoma shpirti i fëmijës tek ju, duke qenë se dhe djalin keni zgjedhur ta quani Aladin apo shihni tek ai realizimin e një ëndrre tuajën?

Jo, nuk them se ëndrrat e mia i shoh tek djali. Kjo nuk më pëlqen madje as ta dëgjoj e jo më ta kem si motiv. Ëndrrat e mia lidhen me të ardhmen e tim biri, natyrisht, por dhe me kujtimet e së shkuarës, të cilave kur kthej kokën pas them se jam në rrugën e duhur të realizimit të tyre. Asgjë s'është kryer, do të doja madje dhe më shumë. Por një gjë e kam të qartë, sa kohë kam frymë nuk do ndalem të bëj më të mirën në kryerjen time të plotë ashtu si ajo fëmija që gëzon në fund të ditës mes morisë së lodrave të saj. Po këtu gëzoj tamam si fëmijë.

- A do ta konsideronit 2014 vitin tuaj?

Falë Zotit kam vite që i konsideroj vitet si të mitë. Dashuria dhe suksesi më kanë shoqëruar pafundësisht. Por natyrisht do kisha dëshirë të kisha para syve babin tim e të gëzonte bashkë me mua. Është një ndjesi që më vjen sa herë më duhet të gëzojë pa të këto vite. Ai do të ishte njeriu që do të kënaqej shumë për mua, ndoshta i vetmi deri në lot.

- Po projektet e 2015 cilat janë?

Detyrat dhe planet janë të shumta në të gjitha fushat. Preferoj t'i tregoj kur t'i kem kryer një e nga një. Jam pak supersticioze si natyrë dhe i besoj misterit. Bota është e jashtëzakonshme nëse rrethohet me të dhe plotësisht e sigurt nga përplasjet e gjithfarshme që vijnë nga mbështjellat e saj apo mijëra trupa qiellorë në galaktikë.

Rruga e Arbërit nr. 104

intervistë

Drama shumë shekullore e shqiptarëve ortodoks të Rekës së Maqedonisë shpaloset nëpërmjet rrëfimit ekskluziv të Branko Sinadinovskit. Ligjëruesi universitar me prejardhje nga Beliçica e Rekës së Epërme nga rajoni i Mavrovës në Maqedoni, së fundmi doli publikisht dhe deklaroi preardhjen e tij etnike. 66 vjeçari që për shumë vite jetoi në Lindjen e Mesme rrëfen në Info Magazine të Klan Kosovë historinë personale për asimilimin e shqiptarëve ortodoks nga Maqedonia. Thotë se edhe vetë është një rast i tillë, ndonëse e pranon se i ati dhe gjyshërit kanë folur vetëm shqip. Për çudi të shumëkujt ai është themelues i partisë VMRODPMNE, subjektit politk të kryeministrit aktual të Maqedonisë Nikola Gruevski.

Sinadinovski: Jemi 75 mijë shqiptarë

Përse pas shumë vitesh vendosët të deklaroheni si shqiptar. Cila është arsyeja për një gjë të tillë?

Sinadinovski: Nuk është kjo e viteve të fundit, unë gjithëmonë jam ndjerë dhe kam qenë shqiptar. Kjo sepse përkatësia kombëtare, sipas të gjitha kushtetutave në botë, është ndjenjë intime dhe as unë nuk kam pasur nevojë që ta manifestoj publikisht. Për herë të parë në një libër timin kushtuar Josif Bagerit, para katër a pesë vjetësh, u hetua dhe publikisht se përkatësia dhe prejardhja ime e babait dhe gjyshes time dhe e paraardhë sve të mi të afërt e më të largët është shqiptare dhe se jemi shqiptarë ortodoksë .

Prej nga e keni prejardhjen profesor Sinadinovski?

Sinadinovski: Me prejardhje jam nga Beliçica e Rekës së Epërme, ndryshe, vëllai i gjyshes time, Pavli, ishte shume i respektuar nga krejt shqiptarët. Ai ishte Kmet, që atë herë kjo ishte punë e madhe dhe e respektueshme, sidomos te shqiptarët. Si e thashë quhej Pavle dhe pasi që në Kiçinicë nuk kishte shkollë e në Beliçicë kishte, te ai ka jetuar dhe ka mësuar në shkollë fillor edhe xhaxhai im, Brankoja, që tashmë jeton në Amerikë.

Si është e mundur Profesor që të mos flisni shqip dhe të thoni se jeni shqiptar?

Sinadinovski: Është e mundshme dhe nuk jam vetëm unë por ka dhe shumë shqiptarë, që janë të rëndësishëm në historinë bashkëkohore shqiprare e që nuk dinin shqip apo që nuk folnin mirë shqip. Konkretisht për veten time do të them se krejt rrethanat e dyzet e pesë vjetëve të fundit ndikuan dhe nuk munda të kontaktoj me motrat dhe vëllezërit e mi shqiptarë që jetonin jashtë vendit dhe për këtë kjo është arsyeja themelore. I ri u largova dhe u ktheva vetëm pas shpërbërjes së Jugosllavisë.

Cila është historia e familjes tuaj në pak fjali. Ku gjendet Reka dhe çfarë do t'u thoshit shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë për këtë çështje?

Sinadinovski: Reka e Epërme gjithëmonë ishte bërthamë e shqiptarëve ortodoksë dhe jo vetëm tash – me shekuj ishte e tillë. Zatën ata, si dhe gjithë shqiptarët ortodkosë, janë plotësisht shqiptarë dhe janë pasardhës të drejtpërdrejtë të Ilirëve. Edhe ju e dini se shqiptarët deri te islamizimi i tyre, jo vetëm në Rekë por gjithë kund, ishin të përkatësisë fetare ortodkose dhe pastaj pranuan besimin katolik dhe atë islam. Përndryshe, po e përsëris dhe një herë, bërthama ishte Reka, por nga kjo trevë shumica e popullatës, për shkaqe objektive, janë shpërngulur dhe shumica e shqiptarëve ortodoksë të kësaj ane jetojnë tash nëpër gjithë Maqedoninë, në Lindje e në Perëndim dhe në Jug të saj, ndoshta më së shumti ka në Shkup, por ka që jetojnë dhe në qytete të tjera të Republikës së Maqedonisë.

Profesor, a keni qenë edhe ju dhe familja juaj objekt i një asimilimi? Si ka ndodhur kjo?

***Sinadinovski*:** A kam qenë objekt i asimilimit? Them se po, se është bërë presion i caktuar. Është ndjekur dhe babai im, që kishte dhe një dosje të madhe policore, pavarësisht se ishte professor universitar. Janë ndjekur nga policia dhe më shumë njerëz të mi të afërm e pak më të largët. Është fakt se gjithë shqiptarët ortodoksë të Rekës e të gjithë Republikës së Maqedonisë së tashme e të kohës kur ishte pjesë e Turqisë otomane, i janë nënshtruar fillimisht dukurisë së asimilimit të fuqishëm që në kohën e Turqisë otomane e të Serbisë, pastaj nga bullgarët dhe normanët. Megjithatë , shqiptarët ortodoksë të kësaj ane janë fenomen botërorë, se përkundër asimilimit të madh e të fuqishëm, kanë arritur që ta ruajnë gjuhën e tyre amtare.

Kur flasim për identitetin e shqiptarëve ortodoksë, a janë shumë ata në Maqedoni?

Sinadinovski: Ka një studim që është punuar dhe është shpallur në fillim të shekullit të XX, të cilin e kam botuar dhe unë në librin tim, që e kam prezentuar. Dhe, në se në Rekën e Epërme të atëhershme , që ishte bërthama, jetonin tetë deri në dhjetë mijë shqiptarë ortodoksë , ndërsa pasi tani regjistrimi i popullsisë nuk bëhet më sipas përkatë sisë fetare, sipas një vlerësimi tim të lirë, që e kam dhe duke pasë për bazë edhe faktin se te ne shqiptarët shkalla e natalitetit është e lartë ,



mundë të them se në gjithë Maqedoninë tashmë ka rreth 70 apo 75 mijë shqiptarë ortodoksë, po sigurisht se kjo shifër nuk duhet të merret si një fakt i kryer, se numri i tyre do të dihet vetëm atëherë kur do të bëhet regjistrimi i popullsisë edhe sipas përkatësisë së tyre fetare. Fakti se në promovimin e librit tim për shqiptarët ortodoksë të Republikës së Maqedonisë, në Hotel "Aleksandar Pallace", kur u promovua dhe libri i bashkëshortes time për Rilindësit shqiptarë, që është gjithashtu profesoreshë, morën pjesë më shumë se 120 shqiptarë ortodoksë, shumica të rinjë, gjithashtu flet shumë dhe dëshmon se edhe nëse dikush përpiqet që ti asimilon, nuk mundet më ta bëjë këtë, sepse kur të rinjët nisin të flasin, fryma nga Llamba e Aladinit ka dalë dhe atë nuk mundet askush më ta kthen prapa.

Te kthehemi pak te familja juaj z. Sinadinovski, si keni folur në shtepi ju, si kanë folur nëna dhe babai juaj?

Sinadinovski: Nëna ime nuk ishte shqiptare. Por babai dhe gjyshja ime, Parashqevia, me sa e mbajë mend unë, flisnin mes veti pastër shqip. Gjithashtu mbajë mend, si fëmijë, kur ajo më thirrte gjithëmonë "Djali i dadës", që unë dhe nuk e merrsha vesh se çdo të thoshte kjo, por më vonë e kuptova se më ledhatonte dhe me këtë ma shprehte krejt dashurinë e saj. Ndryshe, babain tim që ishte mësues, professor në Shkollën Normale të Shkupit dhe profesor universitar e shkencëtar, e respektonin të gjithë shqiptarët që vinin shumë shpesh te ne dhe këshilloheshin me të e ai, me sa mundej u ndihmonte bashkëkombë sve të vet shqiptarë, se i tillë ishte. Më kujtohet dhe tash se si rrinin vonë dhe ngriteshin në mëngjes, shpërndanin mes veti dhe ndiznin cigare, pinin çaj dhe folnin për historinë shqiptare.

Kur jemi te familja juaj, së fundmi është realizuar një intervistë me motrën tuaj. Ajo tha se ju nuk jeni shqiptar, jeni maqedonas dhe mashtrues. Pse e bëri këtë gjë dhe a janë të vërteta ato çfarë po thotë ajo?

Sinadinovski: Jo. Ajo kryesisht ka folur për atë se unë nuk qenkam shqiptar dhe kjo është qesharake, se ajo nuk mundë të futet te shpirti im, te ndjenjat e mia personale. Por ajo e di shumë mirë se babai dhe gjyshja ime ishin plotësisht shqiptarë dhe gjithmonë folnin shqip mes veti vetëm shqip. Duket shumë qartë se krejt kjo është një konstrukt me një skenar të parapërgatitur për të më njollosur në një plan sa më të gjerë, mirë po kjo nuk pati sukses, sepse ata që e përgatitën këtë skenar gabuan duke përzgjedhur personin e gabuar. Ajo që prezentohej si motra ime që moti nuk është më e tillë, sepse ajo është dënuar për më shumë vepra penale, ka një dosje të trashë penale, ka rrahur bile dhe nënën time, e cila ka lënë testament me të cilin e ka hequr nga trashëgimia. Krejt ai testament nuk ka qenë i shkruar në makinë shkrimi por veç me dorën e saj. Nga ajo pati hequr dorë dhe nëna ime, njësoj kam vepruar dhe unë, që nuk e njoh më si motër timen dhe që është më e dhimbshmja, ajo që mundohej ta "mbronte" babain tim se nuk qenka shqiptar, përmes gjykatëses Toshanova të Gjykatës së Parë të Shkupit ishte përpjekur që babain tim, që kishte ca probleme shëndetësore, ta shpallte të paaftë bile dhe pas një viti të vdekjes së tij!

Si ndihen të tjerët familjarë tuaj. A keni motra dhe vellezër të tjerë?

Sinadinovski: Vëllezër dhe motra nuk kam, kam të afërmin tim të vetëm Xhaxhain tim, Branko Manojllovskin, të ciline njohin të gjithë, por dhe ai kishte problem me familjen e tij kur tha se ishte shqiptar ortodoks, por si thotë populli – çudia më e madh tre ditë zgjatë! Pavarësisht se as nga ai nuk më duhej të reagonte, sepse për mua flasin dhe librat e mi, se unë jam shqiptar ortodoks, megjithatë ai pasi dëgjoi këto marrëzitë që i thoshte ajo që paraqitej si motra ime, e bëri dhe u paraqit edhe nga Amerika me një shkrim, të cilin e botoi në "Facebook" e ku thoshte se "ai nuk mundë të jet tjetër pos një shqiptar ortodoks " siç them dhe unë se "ai nuk mundë të jet askush tjetër pos një që është Xhaxhai im".

A ka qenë kundër paraqitjes tuaj publike vetëm motra juaj, apo edhe sistemi politik dhe Kisha Ortodokse Maqedonase?

Sinadinovski: Më e zëshmja, që nuk e prisja, ishte Kisha Ortodokse Maqedonase. Unë u sulmova me një fjalorqë nuk i ka hije sidomos njerëzve anëtarë të Sinodit të Shenjtë të KOMit, se jam shovinist, se jam nacionalist, se dëshiroj të asimiloj popullin maqedonas me këtë që po prezentohem si shqiptar ortodoks, etj etj. Sikur t'i thoshte gjithë këto ndonjë politikan, ndoshta dhe do ta kuptoja, por asnjë politikan serioz nuk i thotë ato gjëra. Megjithatë nuk po mundë ta kuptoj se pse ata janë frikësuar aq shumë dhe aq shum po frikësohen kur ne nuk po ekzistuakam si shqiptarë ortodoksë. Ata tash, kur Kisha Ortodokse Shqiptare po na ofrohet për mbajtje të liturgjisë në gjuhën shqipe, po vazhdojnë si më parë të na minimizojnë ndërsa vetë mua po më sulmojnë. Krejt kjo është kundërthënëse, sepse ne ekzistojmë dhe do të jemi dhe më shumë në të ardhmen, bile shumë më tepër se ajo shifra prej 75 mijëve, që e thashë më herët.

Ju keni qenë të sulmuar në shtëpinë tuaj për këtë çështje, apo jo?

Sinadinovski: Fatkeqëisht po, jam sulmuar fizikisht, isha nga pak naiv, nuk ma ka marrë mendja se dikush mundë të më sulmon fizikisht, por një natë rreth orës 8 a 8 e një çerek dikush i ra ziles së derës, kinse për të kërkuar ndonjë ndihmë dhe kur e hapa derën më shtynë fuqishëm dhe rashë e u rrëzova. Mblodha forcën e u ngrita për ta mbyllur derën por më ranë fuqishëm te gjunjtë, ku edhe më tutje po ndjejë dhembje të madhe. Këta njerëz edhe më tutje nuk po më lënë të qetë, po e shkruajnë në derën time "SHIPTAR", e kanë shkruar një letër me fjalë tejet fyese dhe me alfabet latin, të cilën ia tregova dhe policëve që erdhën, e ku thuhej edhe ajo se mua dhe familjarët e mi do të na therrin.

A po frikesoheni Z. Sinadinovski?

Sinadinovski: Unë, për veten time, që gjatë jetës time kam parë shumë gjëra, nuk fikësohem, por objektivisht po frikësohem për familjarët e mi, për vajzën time sidomos, që e dua shumë, për bashkëshorten time të shkëlqyeshme, që gjithashtu e dua shumë e të cilat janë të vetmet që fuqishëm më mbështesin në krejt këtë punë.

A ju ka ofruar dikush ndihmë? Si kanë vepruar organet shteterore?

Sinadinovski: Nuk mu ka ofruar kurrëfar ndihme, pavarësisht se policia është njoftuar për këto raste. Se a kanë ndërmarrë ata diçka si Polici, këtë nuk e di dhe nuk mundë të them asnjë gjë, por ata veç kanë ardhur te shtëpia ime, kanë marrë deklaratë prej meje dhe u kam treguar se çfarë ka ndodhur dhe më askush prej tyre nuk më ka thënë asnjë gjë.

A do të vazhdoni ti promovoni vlerat e shqiptareve ortodoksë të Maqedonisë, pavarësisht se keni patur problem te shtëpia juaj?

Sinadinovski: Askush nuk mundë mua të më frikësoj dhe të më detyrojë që të heq dorë nga ajo që jam, që jam shqiptar, që jam pjesë e Kombit të madh Shqiptar, që ka historinë më të begatshme në këto troje të Ballkanit, duke filluar që nga Pellazgët dhe Ilirët, Skënderbeu, Hasan Prishtina dhe Boletini e të tjerë. Unë krejt këto që i kam thënë do t'i vazhdoj edhe më tutje. I mbaj krejt këto qëndrime, i vetëdijshëm se krejt kjo është me rëndësi jo vetëm për popullin tim shqiptar por dhe për maqedonasit, sepse ne nuk kemi problem me popullin maqedonas, kemi probleme me disa struktura me tru të çimentuar, që nuk mund ta kuptojnë se sa më shumë të jetë një shoqëri multikulturore dhe më multikonfesionale, aq më e begatshme do të jetë. Çështja se si dikush deklarohet a se çka është, kjo është e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. Një gjë dëshiroj ta theksoj, se çështja e Kishës Ortodokse Maqedonase, bile sipas Kushtetutës, është e ndarë nga Shteti dhe ajo ka dhe duhet të ketë status të njejtë me bashkësitë e tjera fetare dhe mu për këtë ata nuk janë të autorizuar të më thonë mua se kush apo çfarë jam ose ku apo në cilën kishë duhet të shkoj, sepse për krejt këto punë unë vendosi dhe do të vendos vet për vetveten time.

Këto ditë unë kuptova se Ju po tentoni të themeloni Kishën Ortodokse Shqiptare të Maqedonise? Si vendoset z. Sinadinovski? A është e vërtetë kjo?

Sinadinovski: Nëse kjo lejohet me ligjet e Maqedonisë, ne këtë dhe do ta bëjmë. Ne jemi qytetarë lojalë të këtij vendi dhe nuk do të bëjmë asnjë gjë që nuk lejohet me ligj. Nuk do të bëjmë asgjë që do tu shërbente të tjerëve thonë se po duan të na shkatërrojnë Shtetin, por ata po harrojnë se ky është Shtet yni i përbashkët, se për të nuk kanë derdhur gjak vetëm maqedonasit, kanë derdhur shumë gjak dhe shumë shqiptarë, kanë harruar se Sekretar i Përgjithshëm i Republikës së Krushevës ishte një shqiptar ortodoks i cili quhej Gjorgji Çaçe, kanë harruar gjithashtu se dy anëtarë të Kuvendit të ASNOMit ishin shqiptarë, kanë harruar se edhe Partia Komuniste u ishte drejtuar shqiptarëve me Proklamatat drejtuar të të ashtuquajturve Arnautë, që ti bashkangjiteshin asaj për tu çliruar nga forcat pushtuese fashiste. Për këtë, sa është Ilindeni i maqedonasve , po aq dhe ndoshta edhe më shumë është i shqiptarëve, sa është ASNOMi i maqedonasve , po aq dhe ndoshta dhe më shumë është i shqiptarëve. E thash dhe me parë se ky vend dhe ky Shtet yni është i përbashkët, ndajmë bashkarisht krejt këtë ajër dhe këtë qiell dhe duhet të jetojmë bashkë, se asnjë herë historikisht nuk kemi patur problem mes veti dhe këto probleme po i krijojnë vetëm disa kokënxehur që nuk kanë punë tjetër pos krijimit të problemeve! Por dhe ata këtë betejë që më parë e kanë të humbur!

dëshmi

Edhe përkundër kërcënimeve dhe sulmueve, ky promovues i vlerave të shqiptarëve ortodoks thotë se nuk frikësohet për vete por për familjen e tij. Sipas Sinadinovskit janë rreth 75 mijë shqiptarë ortodoks vetëm në Maqedoni. Madje sipas tij shumë të tillë shërbejnë edhe nëpër funksione të rëndësishme në institucionet në Shkup. Shqiptarë ortodoks sipas Sinadinovskit ka edhe në Kosovë, kryesisht në mesin e goranëve tek zona e Dragashit. Të cilit do vend qofshin, Sinadinovski i quan gjithë shqiptarët vëllezër dhe motra. Ai thotë se është krenar me prejardhjen e tij, kur deklaron se do të iniciojë edhe themelimin e Kishës Ortodokse Shqiptare të Maqedonisë, pavarësisht kundërshtimeve të palës maqedonase. Detajet tjera rreth rrëfimit rrëqethës të Sinadinovskit mund t'i ndiqni në intervistën e plotë më poshtë të dhënë për televizionin Klan Kosova.

ortodoks në Maqedoni

Z. Sinadinovski, a janë këto probleme të gjatë këtyre 20 viteve sa Maqedonia është Shtet i pavarur, apo këto probleme të njëjta kanë qenë edhe gjatë kohës së Jugosllavisë?

Sinadinovski: Këto probleme kanë ekzistuar gjithmonë. Sikur të realizoheshin qëndrimet programore të ASNOMit , ku ishte paramenduar Maqedonia si Shtet i përbashkët i maqedonasve dhe shqiptarëve e të tjerëve që jetonin në të dhe sikur të realizoheshin synimet e Ilindenit , sigurisht që nuk do të zhvillhej ai proces i asimilimit të fuqishëm të shqiptarëve, jo vetëm ortodoksëve por dhe të tjerëve, që tash do të ishim rreth një millioni dhe që nuk jam i sigurt se sa jemi, pasi që nga viti 2002 e deri tash nuk kemi pasur regjistrim të popullsisë. Megjithatë është fakt dhe ka shembuj të shumtë se është zhvilluar një asimilim i tmerrshëm jo vetëm kohës së pushtimit pesë shekullor të Perandorisë së Turqisë por dhe të Serbisë dhe në kohën e RSFJsë, që jo rastësisht u shkatërrua dhe që duhej shkatërruar, por jo për fajin tonë. Ju dhe në ato kohë ishit profesor.

Cili ka qenë qendrimi Juaj për shqiptarët? Cili ka qenë qëndrimi Juaj gjatë viteve të 70-ta dhe dhe të 80-ve?

Sinadinovski: Qëndrime të këtilla kam patur gjithmonë dhe për këtë flasin dhe ato 39 librat e mi, ku themelorja ka qenë respektimi i të drejtave themelore të njeriut te popujt e pushtuar. Kam botuar libra për palestinezër, për kurdët dhe armenët e tash edhe për shqiptarët ortodoksë, etj. Krejt kjo dëshmon se i kam mbështetur popujt e pushtuar dhe kam bërë ashtu siç ka bërë I madhi Skënderbe por dhe Hasan Prishtina e shumë e shumë kolosë të tjerë, ashtu siç ka bërë dhe bashkëvendësi im i madh nga Nistrova – Josif Bageri, i cili që në vitin e largët 1910 në Sofje, bashkë me mërgatën e madhe shqiptare kërkoi nga pushteti bullgar që të formohet Kisha Ortodokse Shqiptare, por kjo nuk iu lejua. Se si do të shkojë kjo punë as unë nuk e di, se nuk jam profet, por e ardhmja do ta dëshmojë. Por kjo nuk është arsye që të ndahemi dhe të frikësohemi.

Dua t'ju pyes dhe diçka tjetër. Ju keni patur edhe një karrierë politike? Jeni dhe themelues i subjektit politik VMRO?

Sinadinovski: Po, e vërtetë është dhe, si duket, krejt kjo dikujt po i dhemb dhe më së shumti … Isha njëri ndër njerëzit kyç që e kanë bërë programin politik për Maqedoninë e mëvetësishme dhe të pavarur. Për këtë punë kam botuar dhe libër dhe tash pres që goditjet do të nisin nga kjo pikëpamje, pasi nuk arritën me këtë të deritashmen dhe do të thonë se ai e falsifikoi dhe historinë. Por unë nuk flas për vetveten, për mua flasin ata që e dijnë se unë isha që e kreva punën më të madhe ideopolitike për planin dhe programin e Maqedonisë së Pavarur. Nëse përpiqen dhe në këtë fushë, betejën edhe në të do ta kenë të humbur që më parë.

A keni qenë pjesë dhe e Partisë? A distancoheni nga veprimtaria juaj?

Sinadinovski: Po kam qenë. Nuk distancohem nga e kaluara ime asnjë herë, se kjo do të ishte e tmerrshme.

Ata të VMROsë nuk kanë qenë aq shumë miqësor ndaj shqiptarëve?

Sinadinovski: Ka qenë nga pak me fluktuime, por unë gjithmonë dhe normalisht se kam qenë me njerëzit e mi, me popullin tim. Por edhe në atë VMRO kishte njerëz me kulturë e që nuk kishin asgjë kundër shqiptarëve. Shikoni, ata që janë kundër dikujt nuk e duan as popullin e vet, ndërsa ata që e duan popullin e vet i rspektojnë dhe të tjerët.

Profesor, më thoni diçka për Rekën, më shpjegoni pak për Rajonin e Mavrovës dhe Rekën? Si është zhvilluar popullata e atjeshme?

Sinadinovski: Kryesisht janë kurbetqarë, njerëz të qetë janë, që në të shumtën në kohëra më të largëta kanë shkuar për të punuar në Stamboll, në Sofje, siç kishte shkuar për të punuar dhe Josif Bageri, në Bukuresht dhe në më shumë qytete të vendeve fqinje, prej nga sollën kulturë e dituri dhe njohuri të reja. Ishin të emancipuar dhe përkundër ndërhyrjeve të fuqishme asimiluese e pushtuese, Perandorisë Turke , të Serbisë dhe bullgarëve e normanëve, mbetën shqiptarë ortodoksë. Tash atje po ndodh një lloj rilindjeje dhe për këtë më së shumti ndikoi krejt ajo që ndodhi në vitin 2001, ndikuan ngjarjet që ndodhën dhe më të cilat dhe shekujt u tejkaluan! Deri atëherë të gjithë ata atje janë trajtuar si njerëz jo të rendit të dytë por dhe si të rendit të tretë e të katërt. Por tashti shqiptarët po bëhen gjithënjë e më të barabartë …

Cilin ndikim e ka pasur konflikti i vitit 2001 tek shqiptarët ortodoksë të Maqedonisë?

Sinadinovski: Kishte ndikim shumë të madh pozitiv, ndikoi te vetëdijësimi dhe dhënia e guximit që ta thonë atë që janë. U çliruan nga frika dhe presioni që e kishin më parë, se do të largoheshin nga puna vetëm se do të thonin që janë shqiptarë ortodoksë, nga frika se fëmijët do tu mbeten pa punë e pa shkollë dhe tash ata janë bërë të guximshëm, gjë të cilën e dëshmon dhe fakti se në promovimin e librit tim morën pjesë më shumë se 120 shqiptarë të rinjë ortodoksë, të rinjë seç je dhe ti, e të cilët flisnin shqip. Ky proces nuk ka kthim prapa dhe unë në mënyrë figurative them se tashmë kjo frymë doli nga Llamba e Aladinit dhe kthim prapa nuk ka e ky është progresi të cilin e solli viti 2001, që do të jetë temë vlerësimesh edhe për brezat e ardhëshëm. Zatën, sipas vlerësimeve të mia, shqiptarë ortodoksë nuk ka vetëm në Maqedoni, ka dhe në Kosovë, në Serbi e në Rumani e Bullgari, në Greqi ku janë Arvanitasit. Unë është dashtë që kem një takim dhe me Pangallosin, që është Arvanitas, por takimi nuk u mbajt për shkaqe shëndetësore të tij, se dhe ai është dhe në moshë.

Po në Kosovë kush janë ata shqiptarë ortodoksë?

Sinadinovski: Janë në mesin e goranëve dhe do të vjen dhe koha kur dhe ata këtë do ta thonë. Ka shqiptarë ortodoksë në Rusi dhe në Ukrainë, ku kam qenë dhe unë. Sipas vlerësimeve, se nuk ka regjistrime dhe të dhëna statistikore, jashtë dy shteteve të njohura ndërkombëtarisht – Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë, jetojnë rreth dy milionë shqiptarë ortodoksë, pavarësisht shqiptarëve të Maqedonisë, që janë këtu rreth një million.

Profesor, si Ju ka pritur popullata shumicë e shqiptarëve myslimanë të Maqedonisë? Dhe jo vetëm ata, pse jo edhe të shqiptarëve të Shqipërisë dhetë Kosovës?

Sinadinovski: Është dashtë që të merrni pjesë në promovim, se ajo nuk ishte vetëm një promovim libri, nuk është mirë që unë si autor të flas, por pa modesti do ta them se krejt ajo ishte si një akt historik. Salla ishte përplot, ishin më shumë se 5 a 6 % veta dhe krejt fjala ime që mbajta për shqiptarët ortodoksë ndërpritej çdo dhjetë minuta nga shumë aplaudime. Krejt kjo ngjarje ndodhi në ditën tonë më të rëndësishme kombëtare, më 28 Nëntor në Ditën e Flamurit, që është dhe Dita e Pavarësisë, kur Ismail Qemali e ngriti Flamurin e Pavarësimit të Republikës së Shqipërisë !

Cilët janë shqiptarët tjerë të njohur ortodoksë të Maqedonisë? Ju thoni se janë shumë. Cilët janë ata? Janë nëpër institucione?

Sinadinovski: Ka shumë të tillë, por nuk është mirë që unë të flas për ta, sepse nuk e di që nën çfarë presioni janë ata dhe si do të reagojnë. Por ka në të gjitha nivelet e strukturave shoqërore dhe shtetërore, duke filluar nga Akademia e Shkencave, Universiteti dhe gjithë strukturat shoqërore, por le t'i lëmë ata që vetë të veprojnë siç veprova dhe unë, që mora guximin dhe e thashë atë që duhej thënë. Por dhe unë tash po u bëj thirrje që të mos frikësohen se nuk kanë pse që të frikësohen, sepse krejt ajo do të ndikojë në stabilizimin e Maqedonisë, sepse nga raportet maqedono – shqiptare do të varet jo vetëm paqeja por dhe zhvillimi ekonomik, siguria dhe e ardhmja e Shtetit tonë të përbashkët. Maqedonia mundë të ekzistojë vetëm si Shtet multinacional dhe multikonfesional e multikulturor.

Si mos të frikësohen ata kur Ju keni qenë të sulmuar në shtëpinë tuaj? Si të dalin ata publikisht kur mund të sulmohen në secilin moment?

Sinadinovski: Në këtë jetë tonën, gjithçka ka çmimin e saj. Për Bagerin as sot e kësaj dite nuk e dijmë se ku i pushojnë eshtrat të ndjerit. Nuk e dijmë se si përfundoi jeta e tij në Prishtinë, ku më 1915tën duhej të takohej me Hasan Prishtinën, ndërsa u zhduk për gjithmonë në mënyrë tejet të mistershme. Shoqata që mbanë emrin e tij, të Bagerit, po përpiqet për gjetjen e varrit dhe kthimin e eshtrave të tij në vendlindje. Unë do t'ua them edhe këtë se jam optimist se progresin, që mbështetet vetëm tek 5 përqinshi i njerëzve të mençur e të guximshëm të botës, nuk mundë ta ndalë asnjë forcë retrogarde. Kjo nuk ka mundur të ndodhë as në Amerikë e as në Rusi dhe aq më pak mundë të ndodhë në Maqedoni. Ekzistimi i këtij shtetit të përbashkët, do të thosha vëllazëror shqiptaromaqedonas të Maqedonisë , është në të mirë të popullit shqiptar dhe të popullit maqedonas. Dhe mu për këtë nuk shoh ndonjë arësye që të frikësohet nga kjo Kisha Ortodokse Maqedonase, se ne nuk po bëjmë ndonjë punë të keqe, nuk kemi marrë pushkët në duar, vetëm po botojmë libra dhe po përpiqemi që të demistifikojmë rrenat që janë përhapur për punën e shqiptarëve ortodoksë të Maqedonisë. Dhe ta them edhe këtë, se satsfaksionin më të madh e kemi përfituar mu nga KOMi , që thonë tashmë se liturgjitë mund ti mbajmë dhe në gjuhën tonë por, siç thonë ata, në kishat e tyre! Këto janë deklarata të tyre, edhe nga kreu i KOMit dhe nga një anëtar i Sinodit, që më kishte sulmuar ashpër më parë mua si fashist e si nacionalist. Mirëpo unë për krejt këto po ua lë që vetë të gjykojnë shikuesit e Televizionit Tuaj të nderuar, motrave dhe vëllezërve të mi në Kosovë, pasi ta shikojnë këtë bashkëbisedim tonin dhe të shohin nëse ka shovinizëm, nacionalizëm dhe përpjekje asimilimi në këto qëndrime të miat, si dhe në katër librat që i kemi botuar për këto çështje të shqiptarëve ortodoksë në Maqedoni e të Rilindësve shqiptarë.

A është interesuar dikush për Juve këtu në Maqedoni dhe nga Kisha Ortodokse Shqiptare?

Sinadinovski: Kam marrë ftesë dhe besoj se shumë shpejt do të shkoj në SHBA si mysafir i Kishës Ortodokse në Çikago, ku ekziston Kisha Ortodokse Shqiptare siç ekziston dhe në Kalabri, ku jetojnë më shumë se 250 mijë shqiptarë ortodoksë dhe shpresoj se shumë shpejtë do ta vizitoj edhe Kalabrinë. Ky proces tashmë ka filluar dhe atë do ta çojmë përpara bashkë me Xhaxhain tim Branko Manojllovski, me të cilin bashkarisht e nisëm, ndërsa krejt kjo nisi më herët me dorëshkrimet që i shkroi babai im dhe të cilat janë botuar te librat e mia.

Cilat janë ato dorëshkrime? A mund të na shpalosni disa?

Sinadinovski: Po i kemi në libra dhe ka dorëshkrime edhe të vitit 1951… kur, duke i parë gjithë ato që po ndodhnin ,e pati thënë dhe një medim tejet gjenial se " që të jesh maqedonas në Republikën e Maqedonisë, do të luftosh për gjithëmonë, por jo me armë, vetëm me forcën e fjalës dhe të argumenteve për të dëshmuar se në Maqedoni ekzistojnë dhe jetojnë jo vetëm shqiptarët ortodoksë por dhe shqiptarë të shumtë të tjerë të shtypur nga regjimi. Edhe ju duhet të pajtoheni, se sa shumë e vështirë por dhe e guxmshme ka qenë të thuhet kjo në vitin 1951, kur ende ishte në fuqi pushteti i tmerrshëm i Aleksandar Rankoviqit dhe unë me këtë mendim gjenial edhe e kam nisur dhe e kam përmbyllur librin tim kushtuar shqiptarëve ortodoksë të Republikës së Maqedonisë.

A shkoni shpesh në fshatin tuaj, në Beliçicë? A e vizitoni shpesh Rekën?

Sinadinovski: Fatkeqësisht jo. Me ndërtimin e Liqenit artificial të Mavrovës, por dhe për shkak të kurbetit dhe gjetjes së rrugës për të siguruar një jetë më të mirë për veten e tyre, shumica e shqiptarëve ortodoksë janë shpërngulur nga Rajoni i Rekës dhe tashmë janë në që të katër anët e botës, ndërsa në mbarë Maqedoninë, siç kam thënë dhe më lartë, janë rreth 75 mijë të tillë. Unë dhe shkoj rrallë herë, por shumëçka ka mbetur shkret, kanë mbetur shumë shtëpi të rrafshuara apo dhe vetëm muret e rrënuara. Kanë mbetur shkret edhe shtëpitë e gjyshes time Parashqevisë, të gjyshit dhe të dajës tim Pavle, që ishte atbotë Kmet … pavarësisht se krejt kjo ka ndodhur dhe po ndodh dhe për më shumë arsye objektive, ne shqiptarët ortodoksë, gjithë ne shqiptarët, tek të cilët nuk bëhen dallime për fe, nuk guxojmë të lejojmë që të shuhet ky margaritar i Ballkanit me ato 23 fshatrat e e shqiptarëve ortodoksë, ku kanë jetuar bashkarisht dhe me vëllezërit shqiptarë të besimit islam, por ku ka patur dhe nga ndonjë vlleh e madje dhe sllavë të vjetër. Kjo anë qanë dhe kërkon por dhe do një dorë kujdesi, e të gjithë ne duhet të angazhohemi që ta ringjallim dhe ta ripërtrijmë Rekën, ta bëjmë që sërisht të jetojë.

Sa është ruajtur tradita në këto anë?

Sinadinovski: Traditën e kanë ruajtur. Vetëm t'i shihni ato kostume dhe ato veshje e mbathje tradicionale të Anës së Rekës, ti shihni ato vajza të bukura shqiptare ortodoske me ato veshje tradicionale, që janë ruajtur për breza që nga koha e Ilirëve. Ekziston aty një traditë e begatë tradicionale shqiptare nga e cila duket që dikush dhe po frikësohet shumë këtu në Republikë të Maqedonisë. Kur unë e botova librin për Josif Bagerin ndërmora dhe nismën për themelimin e një Çmimi Kombëtar që do të mbante dhe emrin e Josif Bagerit, çmim siç i kanë dhe i japin dhe të tjerët e që do tu jepej veprimtarëve të dalluar nga Maqedonia. Kjo deri më tash ende nuk është bërë por nuk do të thotë se nuk do të bëhet. Por dhe me emrat e Kristoforidhit dhe Millosh Gjergj Nikollës, që gjithashtu janë nga Reka, që janë veprimtarë tanë mëdhenjë e që ju kemi borxh jo vetëm ne shqiptarët ortodkoksë por gjithë Kombi Shqiptar. Nëse asgjë tjetër, ata meritojnë që bile ndonjë Çmim, që do ta jepte ky Shtet yni i përbashkët shqiptaro – maqedon, ta mbajë dhe emrin e tyre.

Profesor si i ndjeni shqiptarët tjerë, që nuk janë nga Maqedonia? Ju thatë edhe vet se për shqiptarët çdo herë në plan të parë ka qenë etnia e jo feja?

Sinadinovski: Unë i ndjejë dhe gjithë shqiptarët i kam vëllezër të mi dhe sinqerisht e nga thellësia e zemrës dhe e shpirtit tim u dëshiroj që të përparojnë. Kosova ende po rrugëton nëpër një periudhë vështirësishë, por një dijetar antik ka thënë se "Ajo që fitohet lehtë dhe humbet lehtë", ndërsa Kosova, motra dhe vëllezërit e mi në Kosovë e dëshmuan se e meritojnë që të kenë Shtet dhe këtë askush më nuk do të mundë t'ua marrë. Kjo punë u bë dhe çështje kohe do të jet kur dhe fqinjët do të kthjellohen dhe do ta njohin edhe ndërkombëtarisht si të tillë Shtetin e Kosovës. Zatën kjo bile dhe do të jet më shumë në interes të tyre se sa dhe të Kosovës, se ajo tashmë dhe është njohur edhe ndërkombëtarisht nga shumë shtete, ndër to dhe nga shumë fuqi të mëdha botërore.

A keni miq ne Kosove dhe Shqiperi?

Sinadinovski: Kam dhe me këto që po them dua ti përgënjeshtëroj gjithë ata që po më quajnë mashtrues, se mashtrues nuk mundë të jetë ai që shkruan libra, katër libra emotive kushtuar çështjes kombëtare. Kam një mik të madh sidomos nga Lloshkobarja e Ferizajit, Sejdë Reshanin, që në shtëpinë time dhe ka jetuar për një kohë të rëndë të regjimit të Serbisë në Kosovë, nga i cili dhe fshihej dhe për të cilin personalisht kanë garantuar te Ambasadori i Gjermanisë për t'i dhënë një "pasavan" për të shkuar nga Shkupi në Gjermani. Ndryshe, po të mos bëhej kjo, po të mos ikte, serbët do ta likuidonin. Të dëshmoj unë se kush jam, kjo është qesharake, se këtë e dëshmojnë vet librat e mi dhe krejt këto që i kam bërë deri më sot. Shpresoj që të mos më ndodh ndonjë e keqe dhe së pari shpresoj që të jem shëndosh e mirë dhe pastaj do të shkruaj dhe libra të rinjë për pupullin e Maqedonisë dhe bile edhe për Xhemë Hasën e njohur, që e vranë dhe e shpallën armik dhe e i cili, siç pati thënë dhe babi im, në atë kohë vetë u ishte afruar partizanëve me më shumë se 12 mijë veta për ta çliruar vendin, por krejt këtë punë e kishte minuar Tempoja, që e njohin të gjithë.

A e keni vizituar kohëve të fundit Kosovën dhe Shqiperinë? Tiranën dhe Prishtinën?

Sinadinovski: Kam qenë dhe shkoj me kënaqësi në Kosovë dhe në Shqipëri. Kosova po përparon, Prishtina po shndërrohet në një kryeqytet tamam. Shpresoj se shumë shpejt sërish do të shkoj. Edhe kjo intervistë tashmë e imja do të ndihmojë në prezantimin e librit tim kushtuar Shqiptarëve ortodoksë të Maqedonisë, por dhe të librave të tjerë të mi kushtuar çështjes shqiptare e të librit të bashkëshortes time kushtuar Rilindësve shqiptarë, të cilët shumë shpejt do të prezentohen edhe për publikun tjetër shqiptar në SHBA. Për mua, si shkencëtar, nuk ka satisfaksion më të madh si ai i botimit të librit, që është sikur të të lind një fëmijë. Sidomos kur mirëpritet nga lexuesit dhe publiku, siç u mirëprit dhe libri im më i ri nga vëllezërit e mi shqiptarë në Maqedoni. Shpresoj se njësoj do të ndodh edhe në SHBA dhe në Tiranë e në Prishtinë e satsfaksion më të madh se ky nuk ka për një shkencëtar që ka botuar më shumë se tridhjetë libra.

Rruga e Arbërit nr. 104
recencë

Leksion publik i
Dr. Gëzim Alpion në Londër



'Intelektuali dhe Mallkimi i Vegjetimit – *harresa e imponuar në veprën letrare të Fatmir Terziut'*

Leksioni Publik me temë 'Intelektuali dhe Mallkimi i Vegjetimit – Harresa e Imponuar në Veprën Letrare të Fatmir Terziut', i njoftuar nge mediat në Shqipëri, Kosovë dhe diasporë që në tetor, u mbajt të shtunën, më 6 dhjetor në Ambasadën e Shqipërisë në Londër, nga Dr Gëzim Alpion, sociolog i mirënjohur i Universitetit të Birminghamit.

Leksioni u ndoq me interes nga një numër i madh intelektualësh, krijuesish dhe drejtues shoqatash shqiptare me banim në Londër dhe qytete të tjera në Mbretërinë e Bashkuar. Para se të fillonte ligjërata 90 minutëshe e Dr Alpion, të pranshmit u përshëndetën nga Ambasadorët e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës në Londër, Mal Berisha, dhe Lirim Greiçevci, si dhe organizatori i aktivitetit Lutfi Vata, drejtues i Shoqatës 'Ardhmëria' dhe i Forumit të Bashkimit të Shoqatave në Londër.

Leksioni i Dr Alpion u vlerësua lart nga të pranishmit për tematikën, perceptimin, analizën dhe sugjerimet e bëra në lidhje me letërsinë dhe kritikën letrare të traditës dhe atë bashkëkohore në përgjithësi, ashtu edhe për vlerësimin e tij objektiv për krijimtarinë e larmishme të Fatmir Terziut në veçanti.

Në diskutimin interesant që u zhvillua pas leksionit të Dr Alpion, përveç ambasadorëve Berisha dhe Greiçevci, e morën fjalën edhe një numër intelektualësh dhe krijuesish si Xhavit Gasa, Xhemail Peci, Lutfi Vata dhe Burim Turjaka.

LETËRSIA, INTELEKTUALI DHE SHKRIMTARI

Në këtë leksion Dr Alpion u përqëndrua kryesisht në tre tema. Në fillim ai u ndal në 'traditën' dhe mënyrën se si ky koncept është perceptuar dhe trajtuar në faza të caktuara në letërsinë shqiptare. Shembujt në këtë pjesë të leksionit ishin përzgjedhur nga krijimtaria e klasikëve si Jeronim De Rada, Pashko Vasa, Naim Frashëri, Andon Z. Çajupi, Gjergj Fishta, Fan S. Noli, Faik Konica, Lasgush Poradeci dhe Ismail Kadare. Në këtë pjesë të leksionit Dr Alpion theksoi se tradita është një nga temat kryesore dhe më interesantet në krijimtarinë e shkrimtarit Fatmir Terziu.

Në pjesën e dytë të ligjeratës Dr Alpion u ndal në veçantitë në jetën e disa autorëve të lartpërmendur për të shpjeguar motivet e tyre për përzgjedhjen e 'traditës' si leitmotiv thelbësor në krijimtarinë e tyre. Po në këtë pjesë, Dr Alpion pastaj theksoi se Terziu është një ndër autorët bashkëkohorë që e trajton traditën me origjinalitet. Disa herë gjatë leksionit Dr Alpion aplikoi analizën disksursive duke iu referuar veprave të ndryshme të Terziut.

Në pjesën e tretë Dr Alpion u përqëndrua kryesisht në tre romanet e para të Terziut: 'Grykës' (2010), 'Bunari' (2012) dhe 'Kojrillat' (2013). Krijimtaria shumë planëshe e Terziut u trajtua në aspektin biografik, dhe rolin e intelektualit në mërgim në faza të ndryshme të letërsisë shqiptare që nga Rilindja dhe deri në kohën e sotme.

Dr Alpion, i cili ka studiuar letërsinë anglo-amerikane në Universitetin e Kajros nga 1985-93 dhe pastaj në Universitetin e mirënjohur të Durhamit në Angli, ku në vitin 1997 përfundoi doktoratën, theksoi ndër të tjera në leksion se ndërsa po rritet numri i botimeve në lëmin e krijimtarisë artistike, kritika shqiptare është në një gjendje kryesisht amatoreske dhe për pasojë nuk po luan rolin që duhet.

Megjithë angazhimet e tij të shumta akademike, Dr Alpion herë pas here ka botuar shkrime për romanet e disa autorëve bashkëkohorë si Visar Zhiti dhe Thanas Jorgji, të cilat kanë gjetur jehonë të gjerë në media. Në këto shkrime si edhe në leksionin në Londër kushtuar veprës së Terziut, Dr Alpion theksoi se është e rëndësishme të jemi më zemërgjerë kur është puna për të promovuar talentet dhe vlerat e kulturës tonë si në Shqipëri dhe Kosovë ashtu edhe në disaporë.

Profesori i Universitetit të Birmingamit e quajti leksionin e tij një 'gjest modest për të promovuar vlerat shqiptare në përgjithësi në Londër' dhe vlerat njerëzore dhe krijuese të Terziut në veçanti. Ai theksoi se shpreson që leksioni publik për Terziun të pasohet nga aktivitete të tilla të ngjashme ku ekspertë të letërsisë të promovojnë veprat e shkrimtarëve, veçanërisht të autorëve të rinj, të cilët shpesh injorohen.

Nuk duhet të gënjejmë veten, tha ndër të tjera Alpion, se po i ndihmojmë dhe vlerësojmë krijuesit duke organizuar promovime të pafund librash; qëllimi kryesor i promovimeve të tilla të bujshme, tha ai, duket sikur është të mbulojmë autorët me lëvdata, shpesh të pamerituara.

ROMANI 'BUNARI' SI PIKË KULMORE

Një vend të veçantë në leksion iu kushtua romanit 'Bunari' që, sipas studiuesit Alpion, përbën një pikë kulmore dhe një premtim në krijimtarinë e Terziut, si dhe një arritje për letërsinë bashkëkohore shqiptare. Kjo vepër, u argumentua në leksion, dëshmon aftësinë krijuese, kurajon intelektuale, dhe integritetin e autorit për tu ballafaquar me tabu.

'Bunari', theksoi Alpion, është një hymn i vonuar për një nga zonat më të shquara dhe tragjikisht më të harruara jo vetëm në Dibër por në të gjithë Shqipërinë, si dhe një vlerësim i merituar i përkushtimit të banorëve të saj fjalëpak ndaj atdheut. Harresa që ka përjetuar dhe po përjeton Dibra, vazhdoi Dr Alpion, është një paralajmërim që të mos lëjojmë as tani as kurrë që pjesë të tjera të truallit kombëtar dhe komunitete bashkëatdhetarësh të kthehen në të 'huaj' në atdheun e tyre.


Dr Alpion e cilësoi Terziun si nje intelektual dhe shkrimtar 'i njerëzishëm' që nuk ka rreshtur, që kur erdhi në Angli, për të studiuar, për tu specializuar dhe për të përfituar nga eksperienca e pasur britanike si në fushën akademike, letrare, dhe publicistike, ashtu edhe në industrinë e filmit, etj.

KONKLUZIONE

Dr Alpion, i cili është cilësuar nga kritika perëndimore si studiuesi më autoritar i Nënë Terezës në gjuhën angleze dhe është vlerësuar për dramat e tij që janë shfaqur me sukses në disa skena britanike, e përfundoi ligjëratën e tij publike duke theksuar se 'tradita' dhe 'harresa' në veprën e Terziut kanë gjetur një krijues të përkushtuar që shpërfill korrektësinë politike dhe që është gjithmonë në gjurmim të së harruarës, ri-zbulimi i të cilës njëherazi na fajëson kolektivisht dhe tregon se çfarë duhet bërë që të mos përsëriten gabimet.

Po ashtu, Dr Alpion theksoi se shteti, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, duhet të bëjë më shumë për të promovuar vlerat intelektuale dhe krijuese në diasporë. Alpion u ndal gjithashtu edhe në kujdesin që shteti duhet të tregojë për personalitetet e shquara të artit dhe kulturës të cilët tani në pleqëri ndihen të braktisur.

Letërsia, tha në fund Dr Alpion, është art që e ka kryer misionin kur të shqetëson, dhe jo argëtim. Ai shtoi se lexuesi, që është i përgaditur të sëkëlldiset nga mesazhet që përcjell letërsia pa kompromise, duhet të lexojë Fatmir Terziun.



botime

Botimet Dita 2000
ISBN: 978-99956-92-96-4
Çmimi: 1000 lekë

Sistemi i ndëshkimeve në Shqipëri gjatë regjimit komunist

Nga **FEMI SUFAJ**

Kohët e fundit tematika e studimeve historike është shtrirë jashtë kuadrit tradicional të saj dhe ka hedhur dritë edhe në fusha të parrahura deri tani. Një temë e tillë është "Sistemi i ndëshkimeve në Shqipëri në periudhën 1944-1991", e cila është bërë objekt i këtij studimi.

Në kuadrin e rishikimit të historisë së sotme të Shqipërisë dhe veçanërisht të periudhës komuniste, tema e mësipërme hedh dritë në një aspekt shumë të rëndësishëm të historisë së vendit tonë. Studimi në fjalë do të ndihmojë për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Europës në Rezolutën nr. 1096 datë 27.06.1996 dhe nr. 1481 datë 25.01.2006 si dhe vendimin e Kuvendit të Shqipërisë për dënimin e krimeve të komunizmit. Nuk bëhet fjalë për hapjen e proceseve penale për mijëra krime, vrasje burgosje, internime dhe persekutime të padrejta, por për ngritjen e mekanizmave ligjorë dhe praktikë për parandalimin e çfarëdolloj diktature e dhune mbi qytetarët, siç rekomandohet në rezolutat e sipërcituara. Informacioni dhe të dhënat që ofrohen nga ky studim, janë burim për analiza të mëtejshme të studiuesve dhe kërkuesve të rinj, të cilët do të kontribuojnë për pasqyrimin sa më të plotë të aspekteve te dënimeve penale gjatë diktaturës komuniste. Brezat, të cilët nuk e kanë jetuar atë kohë dhe ata që do të vijnë, do të kuptojnë më mirë rolin e diktaturave në manipulimin dhe përdorimin e qenies njerëzore në shërbim të një interesi, i quajtur i përgjithshëm, por në fakt ishte i një kaste sunduese të përhershme.

Natyra e mbyllur e institucioneve të sistemit të drejtësisë penale në shtetin e tipit totalitar e bën të vështirë kërkimin dhe publikimin e praktikave të tyre për publikun e gjerë. Kjo është arsyeja, që për një periudhë të gjatë të sundimit të shtetit të diktaturës komuniste, në Shqipëri nuk u bë e mundur asnjëherë, publikimi i informacioneve mbi ekzekutimet e vendimeve penale dhe dënimet. Me sa duket, dënimet dhe persekutimet e qytetarëve nuk konsideroheshin si punë të "lavdishme" të shtetit komunist, kështu që, ato mbaheshin të fshehura për publikun.

Portat e burgjeve janë një rrugë e brendshme, ku mund të kalohet për të kuptuar më mirë historinë e shoqërisë në përgjithësi. Shkalla e demokratizimit të një shoqërie, hapësirat e lirisë që ekzistojnë dhe respektimi i drejtave njerëzore, do të kuptohen më mirë duke parë se si shteti i trajton personat e dënuar me heqje të lirisë dhe si e bën drejtësinë."Thuhet se askush nuk e njeh me të vërtetë një komb, pa u futur njëherë brenda burgjeve të tij. Një komb nuk duhet të gjykohet nga mënyra si i trajton qytetarët e tij shembullorë, por ato më të këqijtë"1

Sistemi i dënimeve dhe ekzekutimeve të vendimeve penale, është një reagim që bën shoqëria ndaj kriminalitetit dhe merr të gjitha tiparet e makrosistemit. Shoqëritë në zhvillimin e tyre historik kanë evoluar dhe ndryshuar dhe njëkohësisht kanë ndryshuar edhe mikrosistemet përbërëse të saj. Në këtë kuadër, sistemi i burgjeve ka ndryshuar gjatë rrjedhës historike duke, krijuar tipe karakteristike sipas sistemeve politike. Misioni, vizioni dhe qëllimet e dënimeve gjatë sistemeve diktatoriale ndryshojnë nga sistemet demokratike. Para së gjithash, ato ndryshojnë në përbërjen e popullatës së burgut. Në shtetet totalitare dhe diktatoriale, klientë të burgjeve janë përveç atyre që shkelin rendin publik dhe cënojnë normat dhe parimet e shoqërisë edhe persona të tjerë, të cilët regjimi i konsideron armiq të popullit dhe janë kundërshtarë aktivë ose pasivë të regjimeve në fuqi, madje kjo pjesë në momente të veçanta është dominuese numerikisht. Ndryshimet janë të thella në mënyrat e reagimit dhe në shkallën dhe ashpërsinë se si ka reaguar sistemi ndaj krimeve. Shembuj për këtë gjinden në të gjithë botën, por ne mund të krahasojmë reagimin e drejtësisë penale në periudhën e monarkisë në Shqipëri. Në vitin 1936, regjistrohen deri në 1600 të dënuar2 dhe të paraburgosur. Në vitin 1946, numri i të dënuarve, arrestuarve dhe internuarve dokumentohet zyrtarisht 10.000 persona,3 për të njëjtin numër të popullsisë.

Objektivi i këtij punimi është që nëpërmjet burimeve arkivore të pashqyrtuara deri tani të kryhet një studim konçiz, mbi sistemin e dënimeve penale gjatë periudhës se diktaturës komuniste, i cili të kontribuojë për pasurimin e historisë kombëtare gjatë kësaj periudhe. Studimi synon të influencojë për përmirësimin dhe pasurimin e teksteve dhe programeve mësimore të arsimit të të gjitha niveleve, si dhe të shërbejë për njohjen e brezit të ri me këtë pjesë të jetës së shoqërisë tonë dhe të orientohet më mirë për t'u bërë mbrojtës i lirive individuale dhe të parimeve të shoqërisë demokratike. Nëpërmjet këtij studimi do të paraqiten të dhëna të shumta mbi përmasat e përndjekjes gjatë regjimit komunist dhe njëherazi analiza të aspekteve të rëndësishme si përbërja sociale e të dënuarve politikë gjatë regjimit komunist, diferencimi dhe veçimi politik i grupeve të caktuara të shoqërisë, pasojat e politizimit dhe ideologjizimit të sistemit të drejtësisë penale, i kuadrit ligjor dhe i personave të punësuar në këtë shërbim, pasojave negative të reagimit për qytetarët etj. Do të bëhen përpjekje për të pasqyruar në mënyrë sa më reale dhe të qartë mënyrën si ka funksionuar sistemi shtypës në periudhën komuniste dhe cili ka qenë rezultati dhe pasojat negative mbi jetën e qytetarëve.

Gjatë periudhës 1944 deri 1991 nuk është publikuar ndonjë studim mbi ndëshkimet penale dhe brenda këtij kuadri as për politikat e sigurimit e trajtimit të dënuarve. Por nga institucionet e këtij sistemi janë bërë studime mbi përbërjen sociale, nivelin e arsimit, kategoritë e krimeve etj., të cilat kanë vlerat e statistikave informuese. Analizat janë në frymën ideologjike, por duke qenë sekret, ato nuk janë vënë në dispozicion të lexuesit apo studiuesve. Pas periudhës komuniste kemi një sasi të konsiderueshme botimesh, si kujtime dhe monografi të ndryshme të cilat japin një ndihmesë të çmuar në njohjen dhe studimin e ndëshkimeve penale. Autorët janë kryesisht nga shtresa e të persekutuarve të regjimit komunist apo ish të dënuar të regjimit. Por mangësia e tyre thuajse e përgjithshme është burimi mbi të cilat ato janë ndërtuar. Si burim kryesor janë kujtimet personale dhe të dhënat gojore. Nuk janë shfrytëzuar si duhet dokumentet arkivore. Subjektivizmi është i dukshëm, për shkak të ngarkesave emocionale që sjell vuajtja dhe privimi i lirisë. Megjithëkëtë botimet rreth kësaj periudhe janë një pasuri e çmuar e kulturës së vendit tonë dhe një kontribut shumë i madh i autorëve, të cilët janë përpjekur të hedhin dritë mbi një të kaluar tepër të rëndë jo vetëm për ata si individë, por për gjithë popullin e thjeshtë, që përballoi vuajtje dhe shtypje, izolim dhe ndëshkim.

Studimi është organizuar në katër kapituj dhe paraprihet nga një hyrje që bën një përmbledhje të zhvillimit të sistemit



ndëshkimor pas krijimit të shtetit të pavarur më 1912 deri më 1944, kur vendi u çlirua nga okupatorët fashistë dhe u vendos qeveria komuniste. Në kreun e parë është trajtuar ngritja e sistemit të drejtësisë penale nga viti 1945 deri më 1952. Në këtë kre është trajtuar në mënyrë të përmbledhur instalimi i shtetit komunist dhe ngritja e institucioneve të sistemit të drejtësisë penale, gjykatave, prokurorisë, policisë dhe sistemi i ekzekutimeve të vendimeve penale. Kemi bërë një shtjellim të përgjithshëm të legjislacionit penal dhe veçanërisht të Kodit Penal të vitit 1952, parimet e përgjithshme, dënimet penale dhe veprat kryesore. Mbi bazën e të dhënave statistikore janë dhënë përmasat e ndëshkimeve politike, ekzekutimet, burgimet dhe internimet dhe janë analizuar gjyqet kryesore politike të periudhës 1945-1952. Në këtë kapitull i është kushtuar vëmendje kontrollit të rreptë të partisë mbi sistemin e drejtësisë, jo vetëm nëpërmjet diktimit të dënimeve arbitrare, pa u bazuar në prova, por edhe në zgjedhjen dhe emërimin e drejtuesve dhe punonjësve të sistemit të drejtësisë.

Në kreun e dytë është trajtuar periudha 1952-1966. Në këtë periudhë arrihet të konsolidohet më tej sistemi drejtësisë në kuadër të sistemit socialist. Pas eliminimeve kryesore brenda strukturës së partisë u fuqizua më tej klani dhe kulti i udhëheqësit të vendit Enver Hoxha, i cili e ashpërsoi më shumë luftën e klasave për mbrojtjen e pozitave të tij dhe eliminimin e kundërshtarëve. Një prej ilustrimeve më të forta të luftës politike dhe luftës së klasave të kësaj periudhë, ishte konferenca e Tiranës dhe zhvillimet pas saj. Në këtë pjesë është bërë një trajtim edhe mbi rezistencën brenda vendit dhe mbështetjen e shërbimeve të huaja ndaj saj për rrëzimin e qeverisë së Hoxhës. Trajtimi i të dënuarve në kampe dhe burgje gjatë kësaj periudhe është trajtuar në detaje.

Në kreun e tretë trajtohen zhvillimet e sistemit të drejtësisë në periudhën 1966-1976. Në këtë periudhë është arritur të dominohet më tej politika penale nga ideologjia dhe politika e Partisë së Punës. Ministria e Drejtësisë dhe mbrojtja ligjore pushuan së ekzistuari, me nismën e drejtpërdrejtë të partisë dhe drejtuesve të saj. Pas orientimit të ri ndërkombëtar të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë filloi fushata e revolucionarizimit dhe e zbatimit të vijës së masave, duke ju dhënë goditje të reja drejtësisë, administratës, institucioneve shtetërore dhe fetare dhe letërsisë e artit. Në këtë kapitull janë trajtuar edhe internimet, e mira qytetarëve si ndëshkim për shkak të origjinës dhe pozitës së tyre shoqërore, bazuar në

(Vijon në faqen 23)

Fjalë arabe që qarkullojnë në të folurën e Dibrës

Nga **SULEJMAN TOMÇINI**

Ashtu si në mbarë gjuhën shqipe,edhe në të folurën e Dibrës përdoren shumë fjalë arabe,qe kane hyrë nëpërmjet turqishtes. Disa prej tyre ruajnë kuptimin dhe domethënien e tyre origjinale,ndërsa disa të tjera jane transformuar.Këte transformim mund ta kete bere gjuha turke,nga e cila erdhën tek ne,ose edhe vete gjuha shqipe gjate viteve.Unë nuk e njoh gjuhën turke,që të mund të japë ndonjë mendim të specializuar për përdorimin dhe kuptimin e këtyre fjalëve në këtë gjuhë.Por po mjaftohem duke i rënditur një pjesë të madhe të tyre,se mund të ketë edhe të tjera,duke dhënë kuptimin e tyre në gjuhën arabe.Ndërkohë mund të ketë edhe ndonjë fjalë shqipe që rastësisht ngjason me atë arabe,gjë që mund të sqarohet nga studime te mëtejshme nga specialistët e fushës.

Them se disa prej këtyre fjaleve mund të ishin zëvendësuar me kohë me fjalë të shqipes,disa të tjera tashmë jane rrënjosur dhe janë bërë pjesë e fondit të saj leksikor.Megjithate, me pakë përpjekje, shumica e tyre mund te zëvendësohen me fjalë shqipe.

* * *


Akt - lidhje, marrëveshje, kontratë
Belagji – i gojës, orator
Beleg – 1. kapje, zënie; 2. shpallje, njoftim
Beqar – i virgjër
Bereqet – bekim
Beter - i shëmtuar, i keq, qe s'bën të mira
Beze – rrobë prej pambuku ose lini
Bidad – diçka e bërë për herë të parë,diçka e padëgjuar më parë; rrisi.
Biftan - shpifje, gënjeshtër
Bilbil – bilbil, zog këngëtar
Bilgerihak – pa të drejtë
Bilur - kristal
Bina - ndertesë
Bismilahi – në emëre të Zotiti
Budalla – i ndalur. Në Dibër përdoret me kuptimin e njeriut të trashe,njeriut të lehtë nga mendja.
Burgji - vidhë, bulon.
Bustan - kopsht i rrethuar, ku rriten pemë e bimë të tjera.
Bylik – i rritur, i pjekur.Është në bylik- është i rritur,është në moshë
Çark - lak, grackë
Çehre - qartësi, mënyrë publike e të vepruarit
Çorape - veshje këmbësh
Çorbë – supë
Dai - i zgjuar, i shquar.
Dajre – rreth,unazë
Damkë - stemë,vulë; pullë; shenjë
Dava - ankesë, ankim, padi; çështje, proces gjyqsor
Davet - grishje; ftesë
Def – shtynë, largon; E bëra def – e dëbova
Dekikë – minutë
Deng – ngushticë, ngushtësi
Derexhe – shkallë, gradë
Devër - qarkullim; periodë; kohë; alternim, këmbim; radhë; ndërresë prodhimi; cikël
Din – besim, fe
Dovlet - shtet
Dua – lutje, thirje
Duhan – tym, duhan
Dumus – i errët, i fshehur në arrësirë
Dynja – botë. E mori vesh dynjaja - e mori vesh bota
Edebsës – Fjalë e përbërë nga fjala arabe edeb,që do të thotë kulturë a sjellje,dhe ajo turke sës .Në të folmen dibrane vjen me kuptimin i poshtër, i panderë
Ef ! – ef!
Ejvallah – (ej-uallah) njëmend,po për Zotin
Elhamdurilah (elhamdu-li-lahi) - lavdi Zotit.
Elhyqmulilahi – (elhukmu-li-lahi) pushteti i perket Zotit.
Emër – urdher, urdherim; Kur të bëjë emër Zoti- kur të japë urdhër Zoti.
Emir – princ.
Emrullah – (emru-llah) urdhëri i Zotit.
Enë – enë, pajisje guzhine
Enkas – me qellim
Erz – nder, organet e turpshme të njeriut
Esfel - me i ulti, me i poshtmi; më i poshtri
Eshhedubilah – (eshhedu-bi-lahi) deshmoj në Zotin
Esmer – zeshkan.
Esnaf – klasë, kategori
Estekfirullah – (estegfiru-llah) kerkoj mbrojtje a përdëllesë nga Zoti
Evlad – femijë
Evlija - besimtar i mirë, i shenjtë;
Exhel – afat, vdekje
Eza - jep sinjalin për fillimin e një veprimi. Thirrje për në falje
Ezber - i madh, i fuqishëm

(Vijon numrin e ardhshëm)

Nëpër fletët e librit:
Zerqani, mrekullia njerëzore

Zerqani, *mrekullia njerëzore*

Nga **ESMERALDA BICA**



Këto ditë doli në dritë libri: "Zerqani, mrekullia njerëzore" e autorit Destan Rama. Libri çelet me parathënien në të cilën njihemi me pamjen fiziko-gjeografike të Grykës së Madhe (Zerqanit), me bukuritë natyrore të tij ku spikasin "qilimi i blertë i maleve" (fushat) si edhe ata që quhen "Syri magjik" i tyre (liqenet) e bukur malorë të cilët mund të shndërrohen në qendra të rëndësishme turistike apo HC-e të fuqishme.

Nga parathënia e librit veçojmë rreshtat: Sapo fut këmbën në luginën e bukur të Zerqanit do të përballesh me bukurinë magjepsëse të saj, me ajrin e pastër, erën e këndshme të luleve, me gurgullimën e ujit të gumave që zbresin vrullshëm nga mali për të parë dritë e falur jetë... Do të përballesh me zërin e ëmbël të bilbilit e mbi të gjitha me zërin e ëmbël e melodioz të zerqanasit që të uron nga zemra mirëseardhjen, rrugë të mbarë dhe mirëardhsh.

E rëndësishme është se autori me studimet e hulumtimet e tij ka arritur t'i gjejë Zerqanit një fshat që shekujt ia kishin fshehur në thellësinë e harresës, fshatin "Gropa". Ndaj ai shkruan: Ne u gëzuam shumë, ashtu siç gëzohet prindi kur gjen fëmijën e humbur pas shumë vitesh. Krenohemi me bijtë e fshatit tonë Andrea, Pal e Zakaria Gropa që paskan pasur gjak nga ky i yni, - shkruan autori.

Mjaft domethënëse dhe prekëse është hyrja e librit, e cila i kushtohet Zerqanit, vendlindjes së autorit, i cili nëpërmjet vargjeve i bën një retrospektivë tërë historisë së kësaj treve duke përmendur burrat e mençur, trimat më të zotë të saj, nga Zakaria Gropa, ish bashkëluftëtari i Skënderbeut, Sheh Mustafë Zerqani, Ahmet Leka, Can Bajrami, Fasli Malja, Rizvan Alla, Sheh Sulë Zerqani, Sheh Hajredinin e vazhdon me Jashar Kalën, Ramiz Hysenin e Isak Metalinë.

Po kështu autori me fakte historike bindëse mbron tezës se "Beteja e Torviollit", 29 qershor 1944 u zhvillua në fushën e Kalasë, komuna Zerqan për të cilën flet edhe vetë toponimi.

Në libër lexojmë se Zerqani ka qenë vendbanim parahistori. Këtë e mësojmë nëpërmjet pasurisë së objekteve të gjetura nga banorët vendës, si edhe të punë spasionante e të palodhur të dy arkeologëve dibranë Adem Bunguri dhe Iljaz Kaca. Si të tilla përmenden qyteza e Sofraçanit, e Krajkës, Kisha Manastir e Libarazit, si dhe e disa pikave të tjera që mbeten objekt studimi për arkeologët.

Nga libri ne mësojmë disa tipare të karakterit të zerqanasit, si: trimërinë, guximin, mençurinë, zgjuarsinë, atdhedashurinë, patriotizmin etj. Të gjitha këto zbulohen vetvetiu nëpërmjet veprimeve të mrekullueshme njerëzore në të gjithë situatat e paraqitura në kohë të ndryshme. Këtë e lexojmë në kapitujt "Të Nëntë Malet dhe Zerqani", "Në luftë për lirinë, lumturinë dhe begatinë e popullit", të ilustruara me thëniet e mençura të akademikut Rexhep Qosja dhe Fan Nolit. "Te liria nuk arrihet me lule, por me vuajtje dhe mundime të gjata..." dhe "këngën e lirisë asnjë saze s'e luan dot, përveç dyfeqeve". Në kapitullin "Nëntë Malet dhe Zerqani", ku ideatori dhe organizatori i Luftës së Drinit të Zi, 23 tetor 1844 ka qenë Sheh Mustafë Zerqani. Sheh Mustafa bashkoi në një të Nëntë Malet e Dibrës kundër Hajredin Pashës, ashtu siç bëri Skënderbeu që bashkoi në një principatat shqiptare. Në libër lexojmë: Sheh Mustafa me atin e zi/ Shemi malet, i l'shoi n'Dri/ Nançin vorret kush i bani?/ Gryka e Madhe e Sheh Zerqani.

Të rrënqethet trupi e të shkojnë mornica kur lexon... Në gjetshi kohë të bëni një sy gjumë sonte, mirë, në mos shnosh, u pjekshim nesër!... u tha Shehu krerëve të largët, të cilët ikën si era.

Por problemet me pushtuesit e Zerqanit s'iu ndanë kurrë. Ai ishte vend i lakmuar nga armiqtë. Nga libri ne mësojmë se as çallmexhinjtë turq, as sergjitë serbë e as pushtuesit më të rinj, austro-hungarezë, bullgarë, italianë e gjermanë nuk e mposhtën kurrë.

Duke udhëtuar nëpër faqet e librit zbulojmë se zerqanasi që që diti të mbajë të ndezur luftën për liri përparim dhe begati, diti edhe të organizojë mjaft mirë edhe e qeverisjen vendore. Fillimisht u drejtua nga bashkësia juridike krahinore në kushtet e ekzistencës së malit, ku një kontribut të shquar dhanë këtu drejtuesit e Teqes së Zerqanit.

Njëkohësisht në libër lexojmë për punën e shkëlqyer të bërë nga klerikët, Sheh Sula, Baba Jashar Krena, Baba Rushit Tollja dhe sot Baba Ismail Jangulli, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të konflikteve, pajtim gjaqesh etj.

Ndjehesh krenar kur mëson se Zerqani u emërua nënprefekturë që me vendimin e qeverisë së Vlorës, 1912 e Sheh Sula nënprefekti i parë i saj. Qeverisja e parë me rang nënprefekture (zyrtare) filloi më 1922-1947. Po kështu mësojmë se pas vitit 1928 Zerqani ka qenë njëkohësisht me nënprefekturën edhe Bashki (komunë). Në libër ne njihemi me administratën e këtyre njësive vendase dhe udhëtimin e tyre në vite, deri tek komuna sot.

Duke kapërcyer faqet e librit të bie në sy një titull metaforik i një kapitulli "Dritën e shpirti na e dhatë ne". Këtu flitet për zigzaget e zhvillimit të arsimit në trevë, etjen për dije të vogëlushëve, kontributi i vyer i patriotëve vendas, i mësimdashësve dhe veçanërisht Sheh Sulës si themeluesi i parë i shkollës shqipe në Zerqan që më 14 mars 1893. Kjo ditë që përkonte me ditën e mushujëverës nuk do të harrohet kurrë. Produkti i kësaj shkolle qenë katër ministrat që drejtuan ministritë nga më kryesoret të shtetit shqiptar në vite. Rrahman Hanku, Ahmet Kamberi, Qemal Disha, Tefta Cami.

Këtu spikat humanizmi i pashoq i mjaft individëve të cilët me mjeshtri e talent kryen punën e stomatologut, të ortopedit, të pneumatologut në ndihmë të bashkëndihmësve të tyre duke u pagëzuar me emrin "mjekë popullarë".

Këtu mbi të gjithë hedh dritë veprimtaria e mjekut popullor Muharrem Zogu i cili shëronte çdo sëmundje.


Shërbimi shëndetësor për Zerqanin nisi rrugën e tij nga viti 1936 me emërimin e dr. Aristotel Thomo, dr. Thoma Harito, çeljen e spitaleve partizanë në shtëpitë e Hasan Kolecit Adem Sinanit, Zenel Cekës e çeljes së spitalit rural tek hoteli i Myftarit, deri tek rihapja e tij më 1962 në Zerqan e spitalin e ri sot. Ndërsa shërbimin shëndetësor në fshatra e mësojmë nëpërmjet intervistës me infermiere-maminë Shahie Hysa. Motoja e librit është: "Po nuk dite ku je, nuk ke për të ditur ku do të shkosh".

Mendoj se të tjerë do të flasin më shumë për këtë libër, pasi të përjetojnë ngjarjet e veprimet e kryera nga njerëzit e mrekullueshëm, në një vend të mrekullueshëm si Zerqani.

Duke udhëtuar nëpër faqet e librit zbulojmë se zerqanasi që që diti të mbajë të ndezur luftën për liri përparim dhe begati, diti edhe të organizojë mjaft mirë edhe e qeverisjen vendore. Fillimisht u drejtua nga bashkësia juridike krahinore në kushtet e ekzistencës së malit, ku një kontribut të shquar dhanë këtu drejtuesit e Teqes së Zerqanit.

Shënime për novelën "Pengu" të Nexhi Baushit

Një libër që duhet lexuar



Nga **ILMI DERVISHI**

Panairi i librit të autorëve dibranë dh librit shkruar për Dibrën që u hap për herë të parë në Peshkopi në këtë vit, krahas veprave të shkruara për Dibrën dhe autorëve të njohur dibrane, pati dhe një prurje të re në vepra dhe autorë të rinj.

Një ndër këta ishte dhe poetja dibrane Nexhi Baushi, që në panairin e Peshkopisë ishte e pranishme mek atër tituj librash.

"Kur loton qielli" – poezi; "Autograf i pazbardhur" – poezi; "Poezia m'i solli pranë sytë e ty" – poezi; dhe botimi i fundit i vitit 2014 të novelës "Pengu". Tanimë poetja Nexhi Baushi në poezinë e saj ka lexuesit e vet dhe kritikat letrare në shtypin e shkruar e kanë thënë fjalën e saj. Poezia e saj vjen me gjetje kreative, me një tematikë të gjerë, me një poezi me mendim filozofik e me një mesazh të qartë, shkruar me ndjenjë dhe me një varg të veshur me figura artistike.

Në vargjet e saj, shkruan studiuesi Ali R. Berisha: "Nuk ka frazeologji inerte, ka mall, dhembje, brenga, lektisje, mallëngjim por jo melankoli, jo rezignatë, jo zili, as xhelozi".

Shpesh poetët e mëdhenj pas poezisë ose krahas saj merren dhe me prozën. Kështu ndodh edhe me Nexhi Baushin. Herë pas here provonte të shkruante prozë, tregimin e shkurtër, skicën, ese dhe në një moment hodhi në letër dhe novelën "Pengu", proza e parë e saj e botuar.

Subjekti i novelës mbështet mbi një ngjarje reale. Një histori e dashurisë së parë, që për arsye të ndryshme në rrethanat, në kohën, dhe mjedisin shoqëror ku zhvillohet ngjarja, sa në Malësinë e Shkodrës e në Sarandën e bukur, nuk realizohet por mbetet peng. Kjo histori reale, por e zgjeruar në vepër letrare nga autorja Nexhi Baushi. Personazhet kryesore Genci dhe Miranda, dy të rinj në një dashuri të parë, e pafajshme, njerëzore por e pa fat në rrethanat e kohës, pas shumë vitesh e shtyjnë Gencin në kërkim të dashurisë së parë me kuriozitetin për të ditur se si ka përfunduar personi që ja bëri zemrën t'i rrahë fuqishëm për herë të parë, me dashurinë e parë.

Autorja ka ditur të shmangë konfliktin mes të rinjve, duke dashur të nxjerrë në pah kontradiktat e vetë shoqërisë në të cilën jetonin dy të rinjtë.

Me një rrëfim të rrjedhshëm, me një gjuhë të kuptueshme.

Autorja e bën lexuesin jo vetëm të shijojë leximin por edhe të marrë mesazhe dhe kënaqësi estetike.

Botim i ri



Agron Tufa - **NGA HIRI I TË VDEKURVE**
Botime M&B. **ISBN: 978-9928-172-39-6**. 164 faqe. Çmimi: 700 lekë

"Nga hiri i të vdekurve" - një libër me ese kulturologjike. Në këto ese shkrimtari trajton raportet e tij me fëmijërinë, vendlindjen, kulturën, traditën, ideologjinë, gjuhën, historinë dhe artin e të shkruarit. Përmes stilit të tij ekspresiv, dinamik e sugjestiv, Tufa në këto ese bën një guidë meditative nëpër stacione të trazuara të së shkuarës dhe bashkëkohësisë dhe në sëmundjet e qytetërimit tonë.

Libra të tjerë nga Agron Tufa që i gjeni në librarinë e Botimeve M&B:
"Dueli" - Roman, "Frymë mbi Ujëra"- Poezi, "Dibra me sytë e të huajve"

Tel: + 355 4 22 33 283 / + 355 692068603 / + 355 686508441 / + 355 673073265
email: mbbotime@gmail.com

histori

Shënime dhe refleksione për dëshminë e Gjeneralit Gëzim Ostreni para Tribunalit Ndërkombëtar për ndjekjen penale të individëve përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtës humanitare ndërkombëtare kryer në territorin e Ish Jugosllavisë që nga viti 1991

Dëshmia e **gjeneralit Gëzim Ostreni** para Gjykatës së Hagës dhe pasngjarjet e Beogradit

Nga **SAKIP CAMI**



Shembulli i Gjeneral Ostrenit është domethënës dhe frymëzues. Në krye të ushtrisë dhe të luftës për të drejtat e shqiptarëvë në Kosovë dhe në Maqedoni, në Gjykatën e Hagës për të dëshmuar dhe për të vërtetuar se shqiptarët nuk janë terroristë por paqësorë, vitalë dhe të kulturuar. Dëshmia e tij është historike, është pjesë e historisë së popullit tonë që kurrë nuk u tremb dhe nuk u nënshtrua...

KUSH ËSHTË GJEN. GËZIM OSTRENI?

Gjeneral major Gezim Ostreni është lindur në qytetin e Dibrës me 1 nëntor 1942. Pas mbarimit të shkollës normale, mbaron edhe shkollën e oficerëve të rezervës si dhe disa kurse në Akademinë Ushtarake. Diplomohet në Fakultetin Filozofi dhe Sociologji në Prishtinë.

Në lëmin ushtarak ka kryer detyrën e komandantit të mbrojtjes territoriale në Dibër. Ka marrë pjesë në luftën e UCK , në fillim në detyrën e shefit të shtabit të Zonës së III, më pas komandant i Zonës së III Operative të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës me gradën Gjeneral Brigade. Në vitin 2000 gradohet Gjeneral Major dhe ngrihet në detyrën e Shefit të Shtabit të TMK.

Në vitin 2001 me fillimin e konfliktit në Maqedoni merr detyrën e shefit të shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë Clirimtare Kombëtare , ushtri që u krijua nga shqiptarët e Maqedonisë në mbrojtje të të drejtave të tyre legjitime. Së bashku me Ali Ahmetin, komandant dhe drejtues politik i kësaj ushtrie e detyruan faktorin ndërkombëtar dhe qeverinë, parlamentin dhe Presidentin e Maqedonisë të nënshkruanin Marrëveshjen e Ohrit për të drejtat e shqiptarëve të Maqedonisë, marrëveshje që tashmë është pasqyruar edhe në kushtetutën e Maqedonisë.

Nga 3 tetori i vitit 2002 është deputet i Kuvendit të Maqedonisë. Në vitin 2004 ka qenë kandidat për president i shtetit të Maqedonisë dhe nga viti 2002 deri në vitin 2006, nënkryetar i Kuvendit të Maqedonisë.

Mban gradën Doktor i shkencave dhe ka botuar një sërë librash dhe studimesh për historinë dhe luftën e popullit shqiptar për liri, pavarësi dhe të drejtat e tij vecanërisht për shqiptarët jashtë trungut amë, duke dhënë një përgjigje të merituar shkencore profesorëve serbë dhe maqedonas që duan të hedhin baltë mbi gjenezën dhe traditën historike të shqiptarëve.

DËSHMIA E GJENERALIT

Gjen. Gëzim Ostreni ish shef i shtabit të Ushtrisë Clirimtare të shqiptarëve të Maqedonisë në nëntor të vitit 2007 deponon në Gjykatën e Hagës për 19 ditë dhe argumenton me fakte dhe dokumente se lufta e Ushtrisë Clirimtare të shqiptarëve të Maqedonisë ka qenë një luftë e drejtë , për të drejtat themelore të shqiptarëve dhe që s'ka të bëjë aspak me veprimet terroriste.

Dëshminë e tij në Hagë e ka botuar në librin me titull "Dëshmia e Gjeneralit" në vitin 2011, në tre gjuhë, anglisht, shqip dhe maqedonisht, ku versioni në anglisht është marrë direkt nga procesverbali i kësaj gjykate nga faqja 7414 deri në faqen 7885.

Qëllimi i këtij botimi është që të bëjë transparente për opinionin e gjërë, atë që ndodhi në Maqedoni në vitin 2001, sepse pati qarqe dhe media shtetërore maqedonase dhe ndërkombëtare që u përpoqën që ta paraqesin Ushtrinë Clirimtare të shqiptarëve të Maqedonisë si terroriste dhe luftën e saj si të padrejtë . Cdo lexues shqiptar, maqedonas apo ndërkombëtar ka mundësinë që të lexojë process verbalin origjinal të Gjykatës së Hagës ku janë të akuzuar zyrtarët e lartë maqedonas Lube Boshkovski dhe Johan Tarcullovski. Gjeneral Gëzim Ostreni është thirrur dhe ka deponuar në cilësinë e dëshmitarit dhe të gjeneralit. Kryesues i seancës gjyqësore ka qenë juristi Australian Kevin Parker dhe prokuror Den Saxson.

Libri në fjalë, nëpërmjet gojës së autoritdëshmitar sjell fakte dhe dokumente, dëshmi, audio dhe video, foto dhe ngjarje për atë cfarë ngjau në Maqedoni në vitin 2001, kush ishin agresorët dhe kush ishin viktimat, kush ishin të shtypurit dhe kush ishin shtypësit, shkelësit e të drejtave të shqiptarëve. Gjen.

Gëzim Ostreni me maturi dhe argument denoncoi shpifjet e mediave të pushtetit maqedonas dhe fabrikimet e politikës zyrtare të Maqedonisë për kryengritjen e shqiptarëve të Maqedonisë, si u zhvillua kjo luftë, që coi në Marrëveshjen e Ohrit dhe në vendosjen e të drejtave të shqiptarëve në trojet e tyre.

E vështirë ishte lufta, por akoma më e vështirë ishte paslufta, tregon Gjeneral Gëzim Ostreni. Të vendosësh dhe të ruash paqen është gjëja më e vështirë. T'i tregosh faktorit ndërkombëtar se bën një luftë të drejtë, se shqiptarët nuk janë terroristë , por qytetarë të lirë që luftojnë për të drejtat e tyre, ta shpjegosh atë cdo ditë të luftës dhe më pas në Gjyqin e Hagës ishte shumë e vështirë.

Më poshtë po japim disa fragmente nga dëshmia dhe disa pjesë nga rregullorja e UCK që tregojnë për karakterin paqësor dhe luftën e drejtë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të shqiptarëve.

Teksti i betimit ushtarak:

"Unë gjithmonë do t'i shërbej dhe do të mbroj jetën dhe pronën e cdo qytetari të Maqedonisë. Unë gjithmonë vendosmërisht do të mbroj të drejtat dhe liritë e njeriut dhe për realizim të detyrave nuk do të toleroj asnjëherë diskrinimin mbi baza etnike, të gjuhës ose të lojalitetit."

Gjeneral G.Ostreni, pyetjes se përse është futur në tekstin e betimit ushtarak mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, i është përgjigjur se në bazë të Kartës së Lirive dhe të Drejtave të Njeriut është e rëndësishme për UCK që ushtarët të mos rrezikojnë jetën e qytetarëve civilë.

Pyetjes se a ishte në planet e UCK krijimi i një shteti të pavarur dhe të vecantë , Gjeneral Gëzim Ostreni i është përgjigjur se në të gjitha dokumentet dhe komunikatat e UCK është shprehur fakti se UCK është në favor të sovranitetit dhe të integritetit të Maqedonisë.

Edhe në dokumentet e tjera të UCK vihen në dukje kërkesat e herë pas herëshme për mbështetje nga faktori ndërkombëtar për zgjidhjen e konfliktit, për regjistrimin real të popullsisë, për ndryshimin e kushtetutës që shqiptarët të jenë element konstituitiv i shtetit të Republikës së Maqedonisë , që të hiqej diskriminimi në fushën e kukturës, shkencës, edukimit, institucioneve shtetërore etj.

Fakti që ky konflikt përfundoi me ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar , me firmosjen e Marrëveshjes së Ohrit, me ndryshimet kushtetuese, tregoi për luftën e drejtë të popullsisë shqiptare në Maqedoni për të drejtat e tyre.

Edhe Gjykata Ndërkombëtare e Hagës , pas deponimeve të Z. Ostreni dhe të luftëtarëve të tjerë shqiptarë vërtetoi se shqiptarët e Maqedonisë zhvilluan një luftë të drejtë për të fituar të drejtat e tyre.

Pas 13 vjetësh të përfundimit të konfliktit në Maqedoni, pas 15 vjetësh të përfundimit të konfliktit në Kosovë dhe të shpalljes së Kosovës shtet i pavarur dhe të njohjes ndërkombëtarisht nga mëse 110 shtete, sllavët serbë dhe ata maqedonas shfaqen dhe rishfaqen herë pas here me histeritë e tyre antishqiptare.

Mjaftoi një ndeshje futbolli në Beograd në tetorin e vitit 2014, midis Serbisë dhe Shqipërisë që një stadium prej 30 mijë spektatorësh serbë të sundohej nga thirrjet histerike:"Vritni shqiptarët" dhe të sulmoheshin fizikisht lojtarët shqiptarë. Cfarë tregon kjo?

Pas 100 vjetëve të padrejtësive do të shfaqen padrejtësi të reja? Nuk mjafton kjo, por edhe një institucion sportiv nga më të mëdhatë dhe më prestigjiozët në Europë si UEFA nuk dënon këto thirrje raciste dhe luftënxitëse , por bën sikur nuk i sheh dhe nuk i dëgjon dhe mban anën e luftënxitësit.

Vendimi i UEFA-s ndonëse jo përfundimtar ishte jo sportiv, por politik, jo juridik, por favorizues për Serbinë. Federata Shqiptare e Futbollit njofton se ka apeluar vendimin dhe se do të vazhdojë të kërkojë që të vihet në vend drejtësia e munguar.

Shembulli i Gjeneral Ostrenit është domethënës dhe frymëzues. Në krye të ushtrisë dhe të luftës për të drejtat e shqiptarëvë në Kosovë dhe në Maqedoni, në Gjykatën e Hagës për të dëshmuar dhe për të vërtetuar se shqiptarët nuk janë terroristë por paqësorë, vitalë dhe të kulturuar.

Dëshmia e tij është historike, është pjesë e historisë së popullit tonë që kurrë nuk u tremb dhe nuk u nënshtrua ndaj padrejtësive.

Gazeta "Rruga e Arbërit" kërkon korrespondent për Dibrën dhe Komunën e Dibrës së Madhe

GAZETA DO TË JETË NË SHËRBIM TË TË GJITHË TË RINJVE QË DUAN TË PROMOVOHEN NË FUSHËN E GAZETARISË

Të interesuarit të shkruajnë në email: < rrugaearberit@gmail.com >
ose të kontaktojnë në numrin e telefonit: 069 20 68 603

Rruga e Arbërit nr. 104

sport



Pamje nga ndeshja Korabi - Erzeni. Foto: © Edmond Hasani

FLET PRESIDENTI I EKPIT TË FUTBOLLIT, FEMI MËZIU:

"Arritja e Korabit, tani s'e njohin vetëm nga mali, dhurata ime 4 lojtarë"

Nga **HASAN PASHA**

Qarku i Dibrës, tashmë nuk po bëhet i njohur vetëm nga Mali i Korabit apo dhe nga Minierat e Kromit. Korabi i futbollit, duket se po bënë jehonë, madje si një surprizë e bukur, është një ekip rekordesh, që ndoshta rrallë skuadra e arrijnë. Asnjë humbje në një fazë kampionat dhe e mbyll si "Kampion Dimri" në vend të parë dhe me katër pikë diferencë nga Erzeni i vendit të dytë. Por, ajo që duhet përmendur është fakti se nuk është më një Korab agresiv, por tashmë ka harruar edhe kartonët, falë disiplinës dhe kërkesës së presidentit. Natyrisht që meritë të madhe për këtë ka edhe presidenti i skuadrës së Korabit, një djalë nga Dibra, i cili ka kontribuar për dekada në futboll, madje edhe kur ndodhej jashtë vendit me bazë materiale për skuadrën e zemrës, Korabin. Dikur e kishte ëndërr që këtë ekip ta shihet në të Parën, ndërsa tashmë, javë pas jave, ëndrra po kthehet në realitet. Korabi duket në rrugë të mbarë, ndërsa merita kryesore i takon presidentit Femi Meziu, i cili verën e shkuar arriti që të ndërtojë një ekip simpatik, me djem të kulturuar dibranë, por edhe një pjesë prej tyre jabanxhinj, por që shumë shpejt fituan zemrat e gjithë krahinës, falë kontributit të tyre për Korabin. Në një prononcim enkas për "Sport Ekspres", presidenti i skuadrës së Korabit, Femi Meziu, është i lumtur për këtë sukses madhor që po përjeton skuadra që ai financon, ndërsa meritat kërkon t'i ndajë me të gjithë ata që po japin kontributin e tyre qoftë edhe minimal që futbolli të rritet në nivel. "Gjithmonë, kam dashur që të kontribuoj për skuadrën e qytetit tim të Lindjes, Korabin, qysh kur isha fare i ri në moshë. Vite më partë, e kam ndihmuar me bazë materiale, por edhe me financa, ndërsa qysh prej verës së shkuar, jam afruar dhe po bëjë të pamundurën për të realizuar ëndrrën time, por edhe të gjithë Qarkut të Dibrës, për ta parë Korabin në të Parën, aty ku ka luajtur edhe dekada më parë. Natyrisht që unë dua të vlerësoj punën e trajnerit Erblin Laçi dhe ndihmësit të tij, Shpëtim Toska, por pa harruar edhe një nga specialistët e spikatur dibranë, Telman Përlekën, një trajner me eksperiencën i cili bën një punë të pa lodhur me lojtarët kryeqytetas që stërviten në Tiranë, por edhe drejtorin Sokol Muho, i cili i rri pranë skuadrës dhe lojtarëve në mënyrë që të mos i mungojë asgjë, qoftë në ndeshjet brenda por edhe në ato jashtë. Puna jonë do

> "Nga tifozët dua vetëm "Fair-Play" dhe korrektesë, për të treguar mikpritjen dibrane, u premtoj se në fazën e dytë skuadra do të jetë më e fortë si dhe do të ketë përforcime me lojtarë cilësorë për të shkruar historinë edhe në futboll".

të vazhdojë me synime madhore dhe synimi i të gjithëve do të jetë që ta ngjisim patjetër Korabin në të Parën", u shpreh fillimisht presidenti Meziu.

MBËSHTETJA – "Natyrisht që dua të përgëzoj edhe Bashkinë me kryetarin e saj, Ilir Krosi si dhe zv.kryetarin që kujdeset për sportet, Sabri Laçi, të cilët kanë dhënë maksimumin me kontributin e tyre për Korabin. Natyrisht, që dua të përgëzojë të gjithë deputetet e Qarkut Dibër, të cilët na janë gjendur afër dhe e kanë mbështetur skuadrën edhe moralisht, madje dhe duke përgëzuar ekipin për sukseset, e duke ndjekur sfidat në stadium. Nuk mund të lë pa përmendur edhe biznesmenët vendas, që me ndihmat e tyre modeste, kanë treguar se e duan futbollin dhe Korabin. Kam besim se 2015-ta, do të na gjejë të gjithëve më të "shëndoshë" financiarisht për të çuar Korabin aty ku e meriton", shtoi presidenti Meziu, natyrisht duke bërë edhe batutë.

MERKATO DHE AMBICIET – Duke qenë se jemi në prag të festave, Femi Meziu, në karakterin e vet si një njeri human, natyrisht që premton dhurata edhe për tifozët dibranë. "Natyrisht, ne kemi filluar nga puna dhe unë premtoj se janë jo pak, por katër futbollistë, të cilët kanë qenë edhe pjesë e skuadrave të Kategorisë së Parë, apo dhe Superligës që do të veshin fanellën e Korabit. Në merkato, do të përzgjedhim lojtarë cilësorë, që kanë qenë titullarë në skuadrat e tyre fazën e parë, në mënyrë që të mos na ndalë askush në fazën e dytë. Natyrisht që kemi mbyllur një fazë të parë të shkëlqyer dhe unë besoj se do e ruajmë këtë ritëm. Duhet një mobilizim i të gjithë faktorëve, për të ruajtur këtë ritëm dhe për të realizuar ëndrrën madhore, që të gjithë mezi e presin. Korabi është i gjithë Dibrës, ndaj të gjithë duhet që të rrugëtojmë drejt suksesit, por gjithmonë duke parë punën tonë, me lojë korrekte dhe ndershmëri e mbi të gjitha "Fair-Play", ka pohuar presidenti Femi Meziu.

LIVANI, PORTIERI REKORDMEN QË DO T'I NGJAJË ALBAN HOXHËS

MANI LIVANI është portieri i Korabit. Tenton t'i ngjajë portierit të Partizanit, Alban Hoxha. Aktualisht ai në 720 minuta lojë nuk ka pësuar gol dhe ka ambicie që të vijojë të jetë i pathyeshëm dhe në ndeshje të tjera. Nuk është mësuar të intervistohet, por shprehet se lojën e bukur të futbollit e ka nisur me pasion që në moshën 8 vjeç. "Verën e këtij viti u ftova nga zyrtarët e klubit Korabi për t'u testuar. Kisha emocione dhe nuk njihja lojtarët e grumbulluar. Shumë shpejt fitova besimin e stafit teknik dhe vesha fanellën e Korabit. Drejtuesit e skuadrës kanë vendosur që unë të jem në formacionin bazë të ekipit dhe shpresoj të kem bërë më të mirën e mundshme", shprehet Livani i Peshkopisë. Ai është optimist se Korabi pas ngjitjes në Kategorinë e Parë do të pretendojë për t'u ngjitur dhe në elitën e futbollit shqiptar. I pyetur se cila ka qenë ndeshja më e vështirë për Korabin gjatë këtij sezoni gardiani i portës dibrane thotë se Luzi 2008 kishte sulmues "vrastar", të shpejtë, luftarak, madje dhe agresiv. Jo e lehtë për Korabin sipas Livanit ka qenë dhe përballja me Partizanin B. Ai veçon mbrojtjen solide të kësaj skuadre. Duke folur për planet e afërta të Korabit portieri Livani thotë se donatori Meziu dhe stafi drejtues duhet të ndalin largimet e lojtarëve. "Ky kontigjent lojtarësh janë në gjendja ta ngjisin Korabin një kategori më lart. Ai duhet konsoliduar dhe promovuar", theksoi lojtari i Korabit. Kampionati në gjykimin e Livanit është i gjatë dhe i vështirë. Pankina duhet forcuar për të rritur konkurrencën mes lojtarëve. "Deri tani, thotë Livani, skuadra e Korabit ka dy sponsorë, Bashkinë Peshkopi dhe Femi Meziun. Në fund të këtij viti jemi ftuar në një festë në Dibër dhe në dijeninë time do të ketë dhe të ftuar që kanë potencial ekonomik dhe që do të shprehin dëshirën e tyre për të financuar për futbollin. Me siguri ata do të tregojnë bujarinë e tyre për ato tifozë të zjarrtë të Korabit, pasi kështu skuadra arrin rezultate më të mira". Portieri Mani Livani nuk harron të falenderojë ultrasit e Korabit, presidentin Femi Meziu dhe shefin e klubit, Sokol Muho.

Marrë nga gazeta "Sport Ekspres"

PAK HISTORI

Në se shfletojmë historikun e futbollit dibranë kuptojmë se në vitin 1935 Bashkimi Dibranë ngriti skuadrën e parë të futbollit në këtë krahinë, ndërkohë që në vitin 1944 ky sport u shpërbë për shkak të luftës. Një vit më vonë janë përsëri dashamirësit e futbollit që ri ngrenë ekipin e tyre. Asokohe kishte 60 anëtarë në këtë sport. Për herë të parë dibranët luajtën në elitën e futbollit në vitin 1963. Për shumë vite kjo skuadër ka debutuar në Kategorinë e Dytë.

"KORABI ME TIFO-GRUP, BINJAKËZIM ME "SOKOLAT" E DIBRËS SË MADHE"

Presidenti Meziu, ndër të tjera nuk harron që të falënderoj edhe tifozerinë, madje ai u bën apel që të jenë "Fair-Play" si dhe të sillen korrekt, në mënyrë që të jenë shembull dhe të demonstrojnë kulturën dhe mikpritjen dibrane. "Natyrisht që tifozët kanë qenë lojtari i 12-të i Korabit dhe unë i kam falënderuar dhe me anë të gazetës suaj, dua që t'u shpreh mirënjohje. Unë kërkoj prej tyre vetëm që të bëjnë sjellje "Fair-Play", të jenë korrekte dhe gjithmonë të bëjnë tifozeri, duke mbështetur ekipin dhe duke kërkuar më shumë tek skuadra, por kurrsesi të ketë fjalë fyese për miqtë në tribuna apo në shkallët e stadiumit. Futbolli, ndryshe quhet edhe "Ambasadori i paqes" dhe unë këtë sport e shoh si bashkim mes krahinave. Ndërsa nga tifo-grupi dua të falënderoj djemtë që e mbështesin skuadrën si: Ledi Cenga, Mario Makishti, Arbër Zeneli, Pajtim Vraniqi, Flamur Vraniqi. Të gjithë si udhëheqës të tifo-grupit, kanë krijuar dekore fantastik, sidomos në ndeshjen me Erzenin, ku në stadium ishin 5000-6000 tifozë, ndërsa binjakëzimi me "Sokolat" e Dibrës së madhe, natyrisht që tregon se në Dibër e duan sportin e futbollit".

DIBRA KRENOHET EDHE ME BULQIZËN E FUTBOLLIT!

Korabi më shumë se çdo ekip tjetër është mbështetur fuqishëm nga tifozët e zjarrtë të zjarrtë nga të dyjat anët e kufirit. "Shqipet e Korabit" dhe "Sokolat" e Dibrës së Madhe i kanë dhënë një mbështetje të fortë skuadrës dibrane. Në ndeshjen e fundit me rivalin e drejtpërdrejtë, Erzenin, mijëra tifozë nga dy Dibrat rrethuan fushën e futbollit, madje brohoritën fuqishëm deri në fitoren e skuadrës së Korabit. Ultrasit e kësaj skuadre kishin menduar dhe për dekorin e ndeshjes. Parullat, fishekzjarret dhe brohoritjet e tyre u dhënë më shumë zemër futbollistëve në fushën e lojës, ndërkohë Merdini, një futbollist me të ardhme, shënoi golin që do të mbahet mend, duke bërë që Erzeni të mbetet katër pikë prapa Korabit. Qarku i Dibrës me performancën e Korabit dhe Bulqizës kërkon të bëjë histori në futbollin shqiptar. Jo vetëm tifozët janë rikthyer për të ndjekur këtë sport të bukur, por edhe sponsorët po e mbështesin fort atë. Femi Meziu në Peshkopi dhe Andi Topi e Hakik Çekiçi në Bulqizë po investojnë për futbollin. Sakaq matjanët megjithëse janë në vendin e pestë në grupin A tentojnë të jenë përsëri dikush në këtë sport burrëror.



Festa e golit me Erzenin.
Foto: © Edmond Hasani

- Peshkopia, 52 vjet pritje për një sukses në futboll. Dibranët mbushin stadiumin dhe shpallen kampion të dimrit në grupin A të kategorisë së dytë. Qindra tifozë festuan të shtunën e fundit të muajit titullin "Kampion i Dimrit" në Pallatin e Kulturës në Peshkopi.
- Këta djem meritojnë me shumë kujdes, më shumë para, më shumë kushte, që të shkojnë atje ku duam në të gjithë, në kategorinë e parë.

Korabi i rekordeve!

Nga **DEFRIM METHASANI**

Kisha kohë që prisja, jo vetëm unë, por mijëra dibranë, ta shihnin skuadrën e tyre dinjitoze dhe të suksesshme. Tashmë një realitet i ri ka lindur dhe Korabi për herë të parë është shpallur kampion i dimrit në grupin e tij në kategorinë e dytë. Vërtet e pabesueshme, por një rezultat që shërben edhe si rekord. Në 12 javë, kurrë s'kishte ndodhur që futbollistët e një skuadre me emrin e bukur Korabi, të arrijnë 11 fitore dhe vetëm një barazim, dhe ky në Tiranë kundër Partizanit B, që prishi vargun e fitoreve të njëpasnjëshme, brenda dhe jashtë. Tashmë tema e ditës për secilin dibran është futbolli dhe skuadra e tyre.

Përballë Erzenit, pasditen e 21 dhjetorit, ekipi i drejtuar me maturi nga trajnerët Erblin Laçi një djalë i ri, por me ide dhe vizion të qartë për futbollin dhe i mirënjohuri Shpëtim Toska, ia dolën mbanë duke fituar 1-0, me golin e të voglit dhe të madhit Oli Mërdini, gol që erdhi në pjesën e parë dhe ngriti peshë mbi 5 mijë të pranishëm në stadiumin e bukur të qytetit të Peshkopisë.

Një lojë e luftuar deri në minutën e fundit dhe një angazhim total, bëri të mundur që djemtë tanë të dilnin kokëlartw nga fusha dhe të festonin si kampionë, porta e gjysmës së rrugës në një kampionat jo të lehtë.

Tashmë Korabi është kampion dimri, duke grumbulluar 34 pikë dhe duke lënë pas rivalin direkt, Erzenin e Shijakut, me 4 pikë më pak, por pa harruar edhe Partizanin B, apo edhe ekipe të tjera që e lakmojnë shumë një vend në kategorinë e parë. Në një fazë rekordesh, skuadra e një presidenti modest, por që bën gjithçka, si Femi Mziu, bëri më të mirën e mundshme, falë edhe përkujdesjes së bashkisë, veçmas kryebashkiakut Ilir Krosi dhe nënkryetarit, një ish futbollist, si Sabri Laçi, që si duket kontributin e ka rezervuar familjarisht në këtë arritje, meqë dy djemtë e tij janë pjesë e skuadrës, njëri trajner dhe tjetri futbollist.

Gjatë gjithë kësaj faze e kam përcjell me emocion çdo ndeshje dhe kam parë besimin që fitoi Korabi, duke luftuar deri në fund për një fitore. Që nga Sukthi e më pas në Luz, Skrapar, Tiranë, Patos e kudo luajti, motoja e këtyre djemve ishte vetëm fitorja dhe asnjë rezultat tjetër. Nga java në javë, interesimi edhe i sportdashësve dibranë erdhi në rritje, madje me Erzenin u shënua një rekord, që s'ishte parë që pas vitit 1990. Vërtet për t'u admiruar, një admirim që gjeti vend edhe në ekranin e TVSh, ku në emisionin "E hëna Sportive", s'mund të mungonte Korabi, një risi kjo për një media publike, ndërsa bashkë me mua në këtë promovim, u bënë edhe gazetat sportive, që tashme s'mund të ishin të heshtur përballë fenomenit Korab.

Gjithsesi, të tilla shifra kurrë s'i kam parë në ecurinë e skuadrës sonë të zemrës, në gjithë këto vite të ekzistencës së saj. Natyrisht që para viteve 90-të, veçmas pas viteve 80-të, ne kemi parë një Korab që arriti të ishte deri në finale dhe të bënte ndeshje dinjitoze në kupat e Shqipërisë, si me Labinotin, Vllazninë, Tiranën, Skënderbeun, etj, por shifrat e kësaj faze, janë vërtet fenomenale. Të fitosh 11 ndeshje në 12 javë dhe të shënosh 17 gola e të pësosh vetëm 3, kjo nuk është e lehtë të arrihet. Kjo është meritë e padiskutueshme e të gjithë djemve futbollistë, që dua t'i përmend me emër, Levani, Torba, Lleshi, vëllezerit Doçi, Xhafa, Bardhi, Kacnia, Karaj, Adili, Lahi, Toska, Xhonpalaj, Karameti, Brahasani, Mëziu, Merdini, Laçi, Ibra, Jashari dhe Selami dhe dy trajnerëve, Erblin Laçi e Shpëtim Toska.

Një kontribut jo të vogël në këtë drejtim ka dhënë edhe Telman Përleka, që është marrë me grupin e futbollistëve që vinin nga Tirana dhe stërviteshin gjatë javës pikërisht në kryeqytet. Ndihma e pakursyer e djalit të Dibrës, Femi Mëziu që dha gjithçka për këtë ekip, ka vendin e vet dhe meriton shumë lavdërime, ashtu si pjesa e klubit me drejtor zotin Sokol Muho, ish futbollist i Korabit dhe bashkinë e qytetit Peshkopi, nga ku varet ekipi dhe klubi.

Sportdashësi ka notën 10-të, sepse përveçse mbështeti fuqishëm edhe tregoi qytetari dhe kulturë sportive, duke u kthyer në një model në të gjitha stadiumet tona të futbollit.

Gjithsesi, është vetëm gjysma e rrugës. Për të hyrë në kategorinë e parë dhe për të shuar atë ankthin e pritjes së gjatë prej 52 vitesh, duhet edhe një fazë tjetër, duhet një përkushtim maksimal dhe mbështetje po e tillë. Këta djem meritojnë me shumë kujdes, më shumë para, më shumë kushte, që të shkojnë atje ku duam në të gjithë, në kategorinë e parë.

Korabi është i të gjithëve dhe ne jemi po të tijtë. E pafshim në elitë, atje ku i ka takuar prej shumë kohësh futbollit dibran….

NDESHJET E KORABIT

Sukthi – Korabi	1-2
Korabi – Shenkolli	2-0
Luzi 2008 – Korabi	0-1
Korabi – Tirana B	4-2
Olimpik – Korabi	0-1
Korabi – Domosdova	2-0
Skrapari – Korabi	0-1
Korabi – Teuta B	1-0
Partizani B – Korabi	0-0
Korabi – Vora	1-0
Albpetrol – Korabi	0-1
Korabi – Erzeni	1-0

RENDITJA:

Korabi	34
Erzeni	30
Partizani B	27
Luzi 2008	22
...	
Domosdova	5
Skrapari	5

Dibra feston për futbollin përmes një spektakli artistiko-sportiv

Korabi nderohet si kampion dimri

Vlerësohen me mirënjohje nga bashkia, stafi i skuadrës së futbollit dhe disa nga protagonistët e këtij suksesi



Mbrëmjen e 27 dhjetorit, dibranët festuan bukur titullin kampion dimri në futboll përmes një spektakli artistiko-sportiv, gërshetuar me art dhe sport. Protagonist kanë qenë futbollistët dhe stafi i skuadrës, të cilët janë ngjitur në skenën e pallatit të kulturës dhe kanë marrë duartrokitjet e qindra njerëzve që ishin të pranishëm, mes të cilëve edhe kampioni i europes në boks, Gjetan Keta i ftuar nderi në këtë takim spektakël.

Moderatorët, babë e bijë, Defrim dhe Lunada Methasani kanë dhuruar mjaft emocion me prezantimin edhe të disa prej materialeve të transmetuara nga TVSH, madje duke iu rikthyer edhe arkivit për Korabin.

Kryebashkiaku Ilir Krosi është ngjitur dy herë në skenë, sepse fillimisht ka vlerësuar stafin e ekipit, trajnerët Erblin Laçi, Shpëtim Toska por edhe drejtuesin e klubit Sokol Muho dhe presidentin që e ka mbështetur këtë ekip prej vitesh, Fehmi Meziu. Një vlerësim ka patur edhe për trajnerin Telman Perleka dhe ekipin e Korabit si skuadër që vendosi një rekord në futbollin dibran.

Në këtë mbrëmje, bashkia e qytetit ka dekoruar edhe gazetarin sportiv Defrim Methasani, për promovimin që i ka bërë sportit në këtë qytet prej vitesh. Një vlerësim të posaçëm bashkia kishte vendosur të bënte edhe për tre grupet e tifozërisë së zjarrtë dibrane: Shqiponjat, Ultrasit e Dobrovës dhe Sokolat e Dibrës së Madhe.

Më pas salla ka shpërthyer në ovacione, kur kampioni europës është ftuar të ngjitet në skenë dhe aty ka marrë shumë respekt nga bashkëqytetarët e tij. Fillimisht kryetari i bashkisë e ka dekoruar me Mirënjohjen e qytetit zotin Keta dhe me pas presidenti Meziu i ka dhuruar uniformën e Korabit me numrin 12, duke e vlerësuar kampionin si pjesë e ekipit dhe anëtar nderi.

Këngët dhe humori kanë zbukuruar këtë spektakël, ndërsa kulmin e shënoi mbyllja e tij, kur ikona e futbollit dibran, Shpëtim Toska, është lauruar nga Media&Sport me çmimin e karrierës në futboll, duke përlotur këtë futbollist të madh, që dha gjithçka për Korabin ne vite.

Edhe pse një natë dimri, ky takim spektakël dhuroi shumë ngrohtësi dhe emocion, duke dhënë më shumë shprese tek dibranet që ta vazhdojnë këtë rrugëtim të bukur drejt kategroisë së parë në futboll, një ëndërr e kahershme që i mungon kësaj treve prej 52 vitesh.

Korresp. Rr.A.

Aqif Xhemal Balla u lind në lagjen e Manazdrenit
të fshatit të Qafëmurrës së Dibrës më 7 qershor 1948

portret

Udhët e jetës të **Aqif Ballës** së Manazdrenit

Nga **MEVLUD BUCI**

Jeta njerëzore është sa e bukur aq edhe e vështirë, sa e shtrenjtë aq edhe e stërmunduar, sa rrezatuese, aq edhe gjurmëlënëse. Njeriu i ngjan një mali të lartë me plot bukuri e rrezatime, por i ngjan herë-herë edhe një pusi shumë të thellë me plot minerale të çmuara me plot enigma, të cilat i zbulon koha, jeta. Të lënë mbresa e të japin dëlirësi shpirtërore udhët e jetës të Aqif Ballës së Manazdrenit të Qafëmurrës së Dibrës. Një rritje në dallgë jete, nëpër shkulma djerse e fisnikërie nëpër fronte diturie e punë në ballë të vështirësive. Intelektual që u farkëtua me dashuri për dije, për sondat e gjeologji-minierave, me respektin e thellë për shokët, për Manazdrenin e traditat popullore e bëmat e klasës punëtore. Kur njeh kronikën e jetës të Aqif Ballës të kujtohet thënia e urtësisë së pleqve të Katër-Grykëve:

Kjo dynja res res...
Kujt i mbet që do t'i jes (?)
Kur nuk i mbet Krishtit e Hazretit Aliut,
S'do t'i jes birit të njeriut...

Pra kjo do të thotë lum kush ka gjurmë mirësie e djerse, gjurmë të nderimit njerëzor, që kur kthen kokën pas krenohet me të kaluarën e vet. Aqif Balla ka rrezatimin e shpirtit të fisnikëruar, dritësimin e shpirtit të fisnikëruar, dritësimin e udhëve nëpër dallgët e jetës, krenarinë për Manazdrenin, për lëkurën e vendlindjes, për udhët e shtigjeve të punës e të atdheut. Çdo publicist apo dashamir i bëmave të njerëzve të thjeshtë e të shquar do të emocionohej e do të meditonte nëse do të njihte udhët e jetës së Aqif Ballës së Manazdrenit të Dibrës. Udhë në të cilat shpërfaqet dritë atdhetarie, dritë djerse e përkushtimi, udhë që tregojnë sesi bleron tradita, puna, dituria, vëllazërimi e fisnikëria, uniteti i fisit, vlerat e shoqërisë e të miqësisë.

* * *

Manazrreni, lagjja më në kufi me Qafëmurrën, me Matin, me fshatin Vinjol. Një vend me bukuri të rrallë i rrethuar me pyje e gjelbërim, me plot burime, ara e livadhe ku në rrethina lartësohen lisat e pishat shekullore. Në unitet e vëllazëri prej shekujsh, në Manazdre, kanë banuar e jetuar fiset e nderuara si Balla, Hasmeta, Miha, Lala, Ndregjoni, Laçi e Hysenlika. Këtu janë domethënëse toponimet si Kepi i Vogël, Kepi i Dervishit, Kepi i Tivarit, mali i Plakërrisë që ndan Manzdrenin e Qafëmurrës me Vinjollin e Matit, mali i Balgjajt (mali i Allamanit), Fusha e Lathit, Qafa e Gjelase, Fusha e Thatë etj.

Në Fushë të Thatë janë edhe sot e kësaj dite llogoret e Serbit, kufi me Manazdrenin ku në pranverë të vitit 1915 u vra në mejdan të trimërisë Liman Jakup Balla. Në këtë vend, në majë të Mllezës (Në Shqut), pasi vrau 3-4 serbë, ndonëse ishte i armatosur u vra në rrethim nga serbët. Plagosi edhe një oficer serb, i cili më vonë vdiq. Eposi popullor gdhend trimërinë, ai shkruan kronikën e vërtetësisë, kronikën e qëndresës ndaj vepra e trimit sikur bleron në vite e kohëra:

... N'at' pranverë t'vitit '15-të
N'at' Fushë t'Thatë shqipja me fletë,
Lëshon zanin n'log t'burrnisë
Përballë krajlit të Serbisë
Plumbi i hasmit jo se tuti



Aqif Xhemal Balla i Manasdrenit

Lufton n'kambët Liman Jakupi
Drit'e Za i dha tanë venit
Liman Balla i Manazdrenit...

Heroizmi e vepra trimërore rrezatojnë pas plot 100 viteve, sepse Liman Balla ka veprën e qëndresës, ka muranën në Fushë të Thatë, ka gjurmët e jetës e të trimërisë në kujtimet e brezave të Manazdrenit shekullor, ku luftoi e ra në shqut, në majë të Mllezës historike të Qafë Murrës së Dibrës.

* * *

Historia ndrit dhe rrezaton nëpërmjet veprës së brezave, nëpërmjet trimërisë e bujarisë, vëllazërimet e qëndresës së fiseve. Ajo që të emocionon për gjurmët e Aqif Ballës së Manazdrenit është kronika e fisit, kultura e kullës së lashtë, thjeshtësia, bujaria dhe uniteti vëllazëror e miqësor i fisit të nderuar Balla.

Fisi Balla i Manazdrenit të Qafëmurrës së Dibrës vjen nga fshati Cudhi i Krujës (treva e Bendës) rreth viteve 1630 ku vendos fillimisht në fshatin Shëlli të Matit. Sipas gojëdhënave e dëshmive historike i pari që u vendos në Shëlli të Matit ishte katragjyshi i Aqifit, Zenel Balla. Zeneli kishte dy djem: Hasanin dhe Limanin. Këta ishin shumë të zotët, bile thuhet që ishin edhe të shkolluar në mejtepet e regjimit otoman, sepse kishin shëtitur edhe në Turqi e Lindjen e Mesme në Egjypt, Siri, Jordani e gjetkë. Kur u kthyen kishin sjellë edhe shuma të konsiderueshme lirash turke dhe filluan një jetë prej të pasurish. Nga kjo, siç mësohet për atë kohë, vijnë edhe xhelozia e disa shtëpive në zë (të Matit të asaj kohe) dhe në pabesi Hasani vritet, më vonë dhe Limani (i parë), por të dy lanë fëmijë, ndërkohë që edhe babai i tyre Zeneli jetonte. Ishte në moshë shumë të thyer, kur një ditë po rrinte në hije të manit i vjen një hoxhë nga Sopoti i Dibrës dhe i thirr nga larg: Hajde, hajde or Zenel Balla. E lake (po e le) manin me dy çatalla...

Zeneli plak i përgjigjet:
Hajde bujrum, or Hoxhë Sopoti
Ku din t'i sa ban Zoti
O bjen shi apo del moti?!

Kur ishin gjallë dy vëllezërit Hasani dhe Limani, (djemtë e Zenelit) ndihmuan edhe Oxhakun e Allamanit në luftë me semtin e Çelës së Matit dhe për rrjedhojë Allamani i

Për Aqif Ballën flet Manazdreni e Qafëmurra e Katër-Grykëve, flet fisi e rrethi vëllazëror e miqësor. Sigurisht edhe inxhinier Sami Bruçi sot drejtor i gjeologji- -minierave në Bulqizë, po kështu edhe pedagogu dhe mjeshtri i drejtimit arsimor, Adem Selman Kasmi, kanë shumë për të thënë për Aqif Ballën, sepse janë gjurmët e djersës në udhët e jetës...

fal Ballës tokën e semtit të tij në Manazdre të Qafëmurrës. Pjesa e pasardhësit të Limanit vijnë nga Shlliu i Matit në tokën e dhuruar nga Allamani rreth çerekut të parë të viteve 1700. Limani kishte lënë Bajramin dhe Jakupin, të cilët ndërtuan jetën në Manazdre. Pas vrasjes së Limanit kundër serbëve në Fushë të Thatë, Jakupi, gjyshi i Aqifit, mbeti i vetëm me motrën Vashën e cila u martua po në Manazdre me Ali Lalën, e cila ka lënë 3 djem e 2 vajza. Xhemati, djali i Jakupit (babai i Aqifit) martohet me Hane Hysenlikën nga fshati Shëlli i Matit dhe punonin tokën edhe atje për të plotësuar më mirë nevojat e familjes. Xhemat Balla, babai i Aqifit, ka dhënë ndihmesë humane në tharjen e kënetës së Maliqit, në hapjen e tunelit në malin e Dajtit, në sjelljen e ujit të Sehtës së Malit, në minierën e Kurbneshit etj. Ky bir i Manazdrenit, që u shqua në udhët e djersës, la tre djem: Ademin, Limanin e Aqifin dhe një vajzë Nafien. Ademi, djali i madh u shkollua dhe punoi në punë me rëndësi, tani nuk jeton, ka lënë vetëm një vajzë, Adelina Ballën, Limani ka punuar në punë të ndryshme në gjeologji të Bulqizës, ka 3 djem e 2 vajza, është në pension dhe banon në Kamëz të Tiranës. Nafia, motra e Aqifit u martua në Murrë (të Qafëmurrës) me Qazim Tokën e cila ka katër djem e tri vajza, të cilët banojnë në Tiranë e Durrës me familjet e tyre. kudo ata ruajnë gjurmët e traditat e kullës e të fisit, shpirtin bujar e virtytet e urtësisë e të thjeshtësisë njerëzore. Në udhët e jetës, përmes punës e fisnikërisë u rritën brezat e fisit Balla. Ata shkruan nëpër vite gjurmët e përkushtimit, gjurmët e dritës e të djersës, të cilat flasin e rrezatojnë nëpër breza.

* * *

Aqif Xhemal Balla, më i vogli i brezit të pestë të vazhdimit të familjes së Zenel Ballës, u lind në lagjen e Manazdrenit të fshatit të Qafëmurrës së Dibrës më 7 qershor 1948. Në vitin 1955 vazhdon me sakrifica shkollën fillore në fshatin Vinjoll të Matit. U dallua në kryerjen e shërbimit ushtarak në brezin kufitar në Korçë në vitet 1966-1969. Pas shërbimit ushtarak përfundon me rezultate të larta arsimin 8-vjeçar në Vinjoll të Matit (pa shkëputje nga puna) me drejtor të paharruarin, intelektualin e shquar Sadik Zeneli. Jeta kërkonte më shumë dije e djersë, të cilat Aqifi nuk i kurseu. Ndërsa punonte në Cërujë si kryesondist në gjeologji përfundon gjimnazin e Klosit më 1976 dhe ngjiti shkallët e karrierën si intelektual i talentuar, si mjeshtër i drejtimit të punëve në frontin e vështirë të gjeologji-minierave. Në vitin 1977 Aqifi përfundon edhe specializimin pranë shkollës së bashkuar në Tiranë ku u titullua oficer. Me rezultate të larta përfundon edhe shkollën e Bashkimeve Profesionale në Durrës më 1974. Për gati 20 vite u shqua si oficer, komandant i kompanisë së parë ushtarake dhe si zëvendës komandant i batalionit të Selishtës së Katër-Grykëve si dhe 30 vite djersë e përkushtim si kryesondist, brigadier shpimi, sondist, përgjegjës e organizator i talentuar në frontin e gjeologji-minierave Mat deri në vitin 1991. Në vitin 1993 doli në pension, sipas ligjit në fuqi më 60%. Me hyrjen e demokracisë Aqifi, si mjeshtër i palodhur i punës hapi të parin biznes me mobilje në fshatin e lindjes. Në vitin 1996 vjen me banim familjarisht në Kamëz të Tiranës. Ka 6 fëmijë secilin më të mirë e me të zotin se tjetri, të kulturuar e të përkushtuar.

Përparimi, Flora, Shpëtimi, Leonardi, Ariani dhe Hania. Së bashku me bashkëshortën Alien, bijë e Bruçit të fisnikërisë rrëzë Runjes kanë pasuritë më të çmuara: fëmijët e edukuar e të mbarë në udhët e jetës. Aqif Balla krenohet me gjurmët e brezave, nuk i harron rrënojat e kullës mbi 200 vjeçare të Manazdrenit. Ai kujton me nderim genin e dajave të shquar, Hysenliket si oficerin e lartë e atdhetar nënprefektin e Gjakovës Jakup Hysenlikën, intelektualët e talentuar të Manazdrenit si inxhinieri Bashkim Ndregjoni, nënkolonelin, ish-drejtorin e policisë ushtarake në Tiranë z. Skënder Ramadan Hasmeta, Rustem Laçin, Osman Lalën, Adem Ballën, Afrim Isuf Laçin, Kujtim Lalën, Nuredin Riza Hasmetën etj. Para se të mbyll shkrimin m'u kujtuan vargjet e Fran Bardhit të lashtësisë i cili shkruante: *Ku janë ata pleq bujarë?*

Dhe Aqif Balla i kujton të paharruarit pleqtë e urtësisë Rexhep Hasan Miha, Sali Rrahman Ndregjoni, Sali Lala, Shaqir, Ramadan e Hamit Hasmeta, veteranët e LANÇ, Sefer Sala, Shaban Ndregjoni, i paharruari, organizatori, ish kryetari i lagjes "Partizani" të Matit e prijësit të talentuar me policinë e shtetit Shaqir Hasmeta e plot të tjerë. Për Aqif Ballën flet Manazdreni e Qafëmurra e Katër-Grykëve, flet fisi e rrethi vëllazëror e miqësor. Sigurisht edhe inxhinier Sami Bruçi sot drejtor i gjeologji- -minierave në Bulqizë, po kështu edhe pedagogu dhe mjeshtri i drejtimit arsimor, Adem Selman Kasmi, kanë shumë për të thënë për Aqif Ballën, sepse janë gjurmët e djersës në udhët e jetës. Aqif Balla kujton edhe shokët e nderuar të fronteve të punës e të drejtimit si heroin Ismail Losha, inxhinier Bashkim Duvën (ish drejtor) inxhinierët: Rustem Çollaku, Elmaz Leka, Çezar Thanasi. Ekspeditat në zonën e Martaneshit, Bulqizës, Batrës, Theknit e Manazdrenit, këto fronte si dhe llogoret e atdheut, urtësia pranë shkollave si prind shembullor e shpirtbujar, si intelektual i mençurisë dhe i përkushtimit nëpër vite janë udhët e jetës së Aqif Ballës së Manazdrenit. Urime biri i Dibrës, intelektuali model i punës dhe i thjeshtësi, rrezatimi i udhëve të dritës e të djersës; Aqif Xhemal Balla!

...është koha për t'u pajtuar...
KONTRIBUO PER GAZETEN
merr kopjen tende
email: rrugaearberit@gmail.com
vetëm 600 lekë në vit

kujtesë

Përkujtohet 1 vjetori i ndarjes nga jeta të Prof. Dr. Agim Dobit

Agim Dobi, gjeologu që zëvendësoi sovjetikët **në minierën e Bulqizës**



Me ndarjen nga jeta të Profesor Agim Dobit, familja humbi njeriun e tyre më të shtrenjtë, ndësa ne, kolegët e gjeologjisë. një nga bashkëpunëtorët më të mirë si dhe një nga shkencëtarët më të shquar të kësaj fushe...

Nga **BASHKIM LLESHI**

Më 14 dhjetor 2014 në një nga sallat e Hotel Tiranës u përkujtua 1 vjetori i ndarjes nga jeta të Profesorit të shquar të gjeologjisë, Agim Dobi. Në drekën e shtruar më këtë rast nga familja, muarën pjesë miq e të afërm të familjes Dobi, si dhe disa nga kolegët me të cilët ka punuar Agimi, në Gjeologjinë e Bulqizës, Institutin e Studimeve dhe Projektimeve të Gjeologjisë dhe Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave në Tiranë.

Nën kujdesin e bashkëshortes së tij, mësueses së vjetër Popovina Dobi dhe nipit të tij, Doktor Drini Dobi ishte përgatitur një dokumentar i shkurtër kushtuar jetës dhe veprës së Agim Dobit, i cili u ndoq me shumë interes nga të pranishmit. Edhe kolegët e punës që muarën pjesë në këtë drekë familjare, Isuf Latifi, Bashkim Lleshi, Enver Qoku, Kristina Gjeci e Ilir Alliu sollën kujtimet e tyre në Gjeologjinë e Bulqizës, Institutin e Gjeologjisë e Fakultetin Gjeologji-Miniera në Tiranë, me Agimi Dobin.

Agim Dobi ka lindur më 07.02. 1938 nga një familje e shquar e me tradita patriotike të qytetit të Gjirokastrës. Arsimin 7 vjeçar e të mesëm i kreu me rezultate të shkëlqyera në vendlindje, ndërsa arsimin e lartë në fushën e gjeologjisë(dega petrografi) e kreu në Universitetin e Bratislavës në Çekosllovaki.

Në vitin 1963 menjëherë pas mbarimit të shkollës së lartë filloi punën në Ndërmarjen gjeologjike të Kukësit, ndërsa dy vite më vonë u transferua në në Gjeologjisë së Bulqizës. Agimi ishte ndër gjeologët e parë shqiptarë që filloi punën në Bulqizë, menjëherë pas largimit të specialistëve sovjetikë dhe së bashku me gjeologët e tjerë me punë e përkushtim arritën të marrin drejtimin e punimeve të gjeologjisë në këtë sektor të vështirë e të rëndësishëm.

Në fillim punoi në zonën e Martaneshit, pastaj në grupin e përgjithësimit të ndërmarjes dhe më vonë drejtoi grupin e rilevimit gjeologjik në shkallë 1:10 000 në zonën e Patin - Cërrujës të masivit të Bulqizës dhe grupin e rilevimit gjeologjik në shkallë 1:10 000 në masivin e Lurës.

Në vitet e fundit që ka punuar në Bulqizë ka drejtuar Ekipin e kërkim revizionimit të kromit në objktete përball vendburimit të Bulqizës. Ai së bashku me gjeologët e tjerë të kësaj ndërmarje kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në gjetjen e shfaqjeve të reja të mineralit të kromit e shtimin e rezervave të këtij minerali në vendburimet e objektet e kromit të masivit të Bulqizës në zonat e Bulqizës, Martaneshit, Cërrujë-Shkallë-Maja e Kunorës, Balgjaj-Kacni-Qaf Murrës e në masivin e Lurës.

Me hapjen e shkollës së mesme të gjeologjisë e minierave në Bulqizë, Agimi ka dhënë mësim në lëndët e specialitetit të gjeologjisë(Mineralogiji e Petrografi). Në Bulqizë, ai krijoi familje. U martua me mësuesen nga Berati Popovina Alikaj (Dobi) me të cilën lindën rritën dhe edukuan dy djem të mbrekullueshëm, Bledarin e Edvinin. Të dy djemtë e Agimit kanë lindur në Bulqizë. Ai ishte modeli i një njeriu e familjari shumë të mirë.

Në vitin 1974 transferohet nga Bulqiza në Institutin e Kërkimeve Gjeologjike në Tiranë, në fillim si specialist në Grupin e Kromit dhe më vonë si Përgjegjës i këtij grupi dhe Drejtues i projekteve të rëndësishme të perspektivës dhe prognozës së mineralit të kromit në masivët e Bulqizës, Lurës e Shebenikut. Si në gjeologjinë e Bulqizës ashtu edhe në Institut ai ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në sqarimin e ligjësive të përhapjes së mineralizimit të kromit në këto masivë.

Krahas punës në Institutit, ai ka punuar edhe si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Gjeologjisë e të Minierave ku ka dhënë mësim në lëndët e Petrografisë e Petrolologjisë së shkëmbinjve, magmatikë, sedimentarë e metamorfikë. Në vitin 1983 ai mori gradën shkencore Kandidat i Shkencave(Doktor) dhe më vonë, titullin shkencor Asistent Profesor dhe Profesor.

Ka marrë pjesë në shumë aktivitete shkencore brenda e jashtë shtetit ku ka drejtuar grupe studimi dhe ka referuar për petrologjinë e shkëmbinjve magmatikë dhe për ligjësitë e përhapjes së mineralizimit të kromit dhe mineraleve të tjerë të dobishëm në masivët ultrabazikë të vendit tonë. Me njohuritë që kishte në fushën e petrografisë e petrologjisë së shkëmbinjve magmatikë ai ka dhënë një kontribut të rëndësishën në studimin e metalogjenisë së ofioliteve të vendit tonë.

Në sajë të kualifikimit të lartë të tij si shkencëtar në fushën e gjeologjisë ai ka udhëhequr mjaft diplomantë në shkollën e lartë e disertantë në kualifikimin shkencor pas universitar si dhe ka marrë pjesë në komisionet e dhënjes së këtyre diplomave dhe gradave e titujve shkencorë. Me ndarjen nga jeta të Profesor Agim Dobit, familja humbi njeriun e tyre më të shtrenjtë, ndësa ne kolegët e gjeologjisë një nga bashkëpunëtorët më të mirë si dhe një nga shkencëtarët më të shquar të kësaj fushe.

Tiranë 20 dhjetor 2014

Sistemi i ndëshkimeve në Shqipëri gjatë regjimit komunist

(Vijon nga faqja 17)

dyshime dhe paragjykime të paargumentuara dhe të paprovuara.

Kreu i katërt analizon sistemin e ndëshkimeve pas periudhës 1976, që lidhet me miratimin e Kushtetutës së re deri më 1990. Në këtë periudhë është avancuar më tej në politizimin e sistemit të drejtësisë. Kodi Penal i vitit 1977, i hartuar në frymën e kushtetutës, ka devijuar nga parimet kryesore të politikës penale klasike, ka rritur më tej numrin e veprave penale që dënohen me vdekje, ka politizuar parimet kryesore dhe qëllimin e ndëshkimit, duke e kthyer atë në një instrument në shërbim të partisë në pushtet. Në fund të viteve '80, sistemi i drejtësisë u gjet para një krize, që lidhej jo vetëm me inefiçencën e tij në luftën kundër kriminalitetit, por mbi të gjitha me nevojën e ngutshme për hartimin e një kuadri ligjor të plotë, mbështetur në standardet ndërkombëtare për procedimin penal dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe për ngritjen e një infrastrukture të re për sigurimin dhe trajtimin e të dënuarve të cilët ishin mbajtur në kushte të mjerueshme, larg zonave urbane, pranë minierave dhe fronteve më të vështira të punës.

Tema është trajtuar në mënyrë kronologjike, duke i parë zhvillimet në sistemin e ndëshkimeve brenda kuadrit të përgjithshëm të zhvillimeve të sistemit të diktaturës komuniste. Problemet e trajtuara janë të karakterit historiko-juridik, kështu që janë përdorur metoda ndërdisiplinare, historike, juridike dhe të analizave statistikore.

Burimet kryesore të përdorura janë: Dokumentet zyrtare të Kuvendit Popullor, të Qeverisë dhe institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë penale. Të tilla janë: Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata e Lartë, Ministria e Brendshme. Dokumentet e mësipërme janë ruajtur në AQSH në fondet përkatëse. Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, fondi Dega e Kampeve e Burgjeve, Arkivi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Gjatë studimit kemi shfrytëzuar një numër të konsiderueshëm të botimeve të historiografisë shqiptare, si tekstet e Historisë së Shqipërisë, botim të Akademisë së Shkencave, tekstin e Profesor doktor V. Duka, "Histori e Shqipërisë nga viti 1912-2000", tekstin e studiueses së mirënjohur Smirnova, të E. Zhak etj. Një burim shumë i mirë që kemi përdorur kanë qenë studimet e Profesor doktor D. Dyrmishi, si "Lufta politike në gjirin e PPSh", si dhe shumë artikuj të tjerë të tij dhe të historianëve të tjerë të publikuar në revistën historike dhe shtypin e ditës.

Një burim i rëndësishëm kanë qenë raportet e AI (Amnesty International) mbi burgosjen politike në Shqipëri. Këto burime kanë shumë mangësi dhe pasaktësi, sepse janë hartuar kryesisht mbi bazën e deklarimeve të ish të burgosurve politikë të arratisur, megjithatë kanë vlerë të rëndësishme si i vetmi zë nga institucione ndërkombëtare, i profilizuar në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe me eksperiencë në këtë fushë.

Dokumente private, si letra të të dënuarve drejtuar institucioneve dhe drejtuesve të shtetit, kanë vlerë shumë të madhe, pasi futen në grupin e dokumenteve bashkëkohore, pra, janë krijuar nga dëshmitarë okularë të ngjarjeve.

Burim tjetër janë akte ligjore, ligje, kode, rregullore, udhëzime, mbi dënimet penale dhe trajtimin e të dënuarve.

Botimet, kujtime, ditare, monografi mbi persekutimin komunist dhe dënimet në Shqipëri, përbëjnë gjithashtu një informacion të domosdoshëm për t'u shfrytëzuar, me gjithë të metat që konstatohen. Do të përmendim disa prej autorëve si At Zef Pllumbi, Profesor Sami Repishtin, studiuesin Agim Musta, publicistin Fatos Lubonja etj. Burim i rëndësishëm ka qenë edhe zyra gjyqësore pranë Ministrisë së Drejtësisë.

(Marrë nga hyrja e librit)

Rruga e Arbërit

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT

Të nderuar bashkëpunëtorë,

Për të pasur një bashkëpunim të suksesshëm, ju lutemi të kini parasysh disa kritere për materialet që sillni pranë redaksisë.

- **Shkrimet duhet të jenë të daktilografuara, jo më shumë se 1500 fjalë (10000 karaktere, përfshirë hapsirat). Shkrimet duhet të përmbajnë shkronjat "ë" dhe "ç". Shkrimet me më shumë fjalë, do ti nënshtrohen procesit të redaktimit.**
- **Fotografitë për shkrimin duhet të jenë me diçiture dhe më emrin e fotografit.**
- **Materialet me karakter aktual dhe problematikën e ditës kanë përparësi botimi.**
- **Materialet historike, recensat apo portretet, nuk do pranohen për botim, n.q.s. ato konstatohen se janë botuar në ndonjë media tjetër apo rrjete sociale.**
- **Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të respektojnë të drejtat e autorit.**
- **Shkrimet duhet të sillen nëpër nëpërmjet Postës Shqiptare në adresën e gazetës, postës elektronike në e-mail <rrugaearberit@gmail.com>, ose mund tu dorëzohen personave të autorizuar nga redaksia.**
- **Shkrimet që janë jashtë platformës së gazetës, nuk botohen dhe redaksia nuk është e detyruar të japë shpjegime për çdo rast.**

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira për bashkëpunimin e deritanishëm.

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <rrugaearberit@gmail.com>

Redaksia

Pajtohu në gazetë - 1 vit vetëm 600 lekë





Pajtohu në gazetën *RRUGA E ARBËRIT*

***Merr versionin* PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj**

Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë.

ÇMIME TË ARSYESHME për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.

Për individët, njoftimet deri në 50 fjalë (1/16 e faqes) ofrohen falas!

Për informacion:
E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603